



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

**ALSAI**

**EUROSAI**



*Experientia mutua*

*Omnibus prodest*

**INTOSAI**



<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
	Hyrje: Fjala e Kryetarit të KLSH.....	2-10
	<b>I.</b> Përmbledhje e Performancës.....	11-17
	<b>II.</b> Gjetjet Kryesore në Auditime.....	17-24
	<b>III.</b> Rekomandimet dhe Zbatimi i tyre .....	24-32
	<b>IV.</b> Cilësia në Auditim.....	32-42
	<b>V.</b> Burimet Njerëzore dhe Trajnimet.....	42-53
	<b>VI.</b> Partneriteti për ndryshim.....	53-57
	<b>VII.</b> Buxheti Vjetor i KLSH.....	57-62
	<b>VIII.</b> Vlerësim për KLSH.....	62-70
	<b>IX.</b> Perspektiva 2013.....	70-75
<b>Shtojca 1</b>	Rezoluta e Kombeve të Bashkuara Nr. A/66/209 datë 22 Dhjetor 2011 “Promovimin i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, duke forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit“	
<b>Shtojca 2</b>	Rezoluta e Kuvendit “Mbi Veprimtarinë e KLSH për vitin 2011” datë 26 Prill 2012	
<b>Shtojca 3</b>	Bilanci i KLSH i vitit 2012	
<b>Shtojca 4</b>	Lista emërore e njësive publike të audituara-gjatë vitit 2012	
<b>Shtojca 5</b>	Evidenca e shkeljeve financiare me pasojë dëm ekonomik, sipas njësive publike dhe llojit të shkeljeve	
<b>Shtojca 6</b>	Evidenca e Kallzimeve Penale 2012	
<b>Shtojca 7</b>	Evidenca e kërkesë-ankesave nga shtetasit	
<b>Shtojca 8</b>	Dobia ekonomike e auditimeve të KLSH	
	Fjalori i shkurtimeve	



**Fjala e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit**

E nderuara zj. Kryetare,  
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Duke Ju falenderuar për mbështetjen që i keni dhënë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) gjatë vitit 2012, të materializuar në Rezolutën e Kuvendit “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së KLSH për vitin 2011”, datë 26 prill 2012 dhe në përcaktimin e buxhetit të KLSH për vitin 2013, Ju bëj me dije se jemi përpjekur, duke punuar me intensitet, për të realizuar detyrimin kushtetues, ligjor dhe moral për sigurimin e miradministrimit të fondeve publike dhe kontributit për mirëqeverisje në vend.

Si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm publik, pra si SAI (“Supreme Audit Institution”-Institucioni Suprem i Auditimit) kemi shumë palë të interesuara në realizimin e misionit tonë: qytetarët, Kuvendin, njësitë e audituara, qeverinë dhe organizatat e shoqërisë civile. Besimi i palëve të interesuara tek ne si SAI do të thotë besim i Kuvendit dhe qytetarëve, në përgjithësi, për rezultatet tona në drejtim të auditimit të financave publike. Është e rëndësishme që puna e KLSH të mbetet profesionale, e besueshme dhe e dobishme për palët e interesuara, në rradhë të parë për Kuvendin si organi suprem ligjvënës i vendit.

Raporti Vjetor i Performancës i KLSH për vitin 2012 është një përgjigje e rëndësishme drejtuar Kuvendit, një llogaridhënie e plotë dhe e përgjegjshme ndaj pritshmërive të palëve të interesit. Ky raport përqendrohet në veçanti në mënyrën se si unë si Kryetar i kam shfrytëzuar gjatë vitit të kaluar burimet njerëzore dhe financiare që më keni besuar. Ai përmbledh rezultatet që KLSH ka arritur gjatë 2012-ës, duke i krahasuar me ato të një viti të mëparshëm buxhetor.

Drejtimit strategjike të thelluara krijojnë mundësi të reja për ne si KLSH dhe palët tona kryesore të interesit, legjislativin dhe ekzekutivin. Ndryshimet e miratuara vitet e fundit në kornizën ligjore për menaxhimin financiar reflektojnë zotimin për të zhvilluar ekonomicitetin, efektivitetin dhe eficiencën në përdorimin e resurseve dhe ofrimin e shërbimeve tek qytetarët. Zbatimi dhe auditimi i kësaj kornize të re ligjore në një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme është sfida për të gjithë ne në KLSH.

Pavarësia është një parakusht që një auditim i jashtëm publik të funksionojë mirë. Një kornizë e re ligjore për KLSH është dorëzuar tashmë në Kuvendin e Shqipërisë. Një nga përparësitë e mija për vitet në vijim është të garantoj që kjo kornizë, e cila është në pajtim me standardet INTOSAI të pranuar ndërkombëtarisht, do të zbatohet si duhet, kur të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Kjo reflektohet në punën tonë, si dhe në marrëveshjet e arritura me partnerët aktualë dhe ata të rinj, të cilët do të na ndihmojnë për këtë në të

ardhmen, mbi bazën e motos së INTOSAI “*Experientia mutua Omnibus prodest*” (Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë)

Sipas mendimit tim, mund të them se i kemi përdorur mirë mjetet që Kuvendi na i ka vënë në dispozicion në formën e burimeve financiare. Cilësia dhe mbulimi i auditimit, ashtu si dhe ndikimi i punës sonë po përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Shpresojmë që ky Raport të kontribuojë jo vetëm në forcimin e llogaridhënies tonë, por edhe në rritjen e ndërgjegjësimit të Kuvendit për dobinë e auditimeve të KLSH dhe rolin e pazëvendësueshëm parandalues ndaj korrupsionit dhe mashtrimit financiar që institucioni luan, duke shtuar mirëkuptimin dhe mbështetjen Tuaj për të përballuar sfidat tona.

Gjatë vitit të kaluar kemi punuar të zbatojmë rekomandimin Tuaj, të shprehur në Rezolutën e Kuvendit datë 26 prill 2012 për “*Kryerjen e kontroleve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë*”.

Gjykojmë se e kemi zbatuar atë, duke **realizuar gjatë 2012-ës 177 auditime nga 153 të planifikuara dhe duke përfunduar plotësisht 158 auditime.**

Këto auditime janë zhvilluar në 40 institucione qendrore, në 64 njësi vendore, 12 drejtori dhe degë tatimesh e doganash, 12 shoqëri anonime dhe me kapital të përbashkët, 11 njësi dhe projekte me financim të huaj, 11 njësi të administrimit dhe rregjistrimit të pronës dhe 8 institucione të mbrojtjes së mjedisit.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik dhe përgjegjësia jonë si SAI, është që të kontribuojmë në transparencën dhe llogaridhënien e menaxhimit të fondeve publike. Këtë kontribut e kemi pasur në fokus të çdo auditimi të kryer. Qështja më e rëndësishme për ne ka qenë të sigurojmë dhe mbajmë një profesionalizëm dhe cilësi të lartë në aktivitetet e auditimit dhe ta ruajmë këtë cilësi, në mënyrë që të drejtohem nga shembujt e mirë. Si institucion i auditimit të jashtëm, jemi përpjekur t’u përmbahemi standardeve të cilësisë dhe në të njëjtën kohë audituesit tanë janë treguar të pavarur, objektivë, të paanshëm, me skepticizëm profesional dhe ndjenjë llogaridhënie ndaj publikut.

Gjatë auditimeve të kryera në vitin 2012 (me periudhë 2-3 vjeçare aktiviteti të njësisë që auditohet), **kemi vërejtur parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat e mbledhura dhe në shpenzimet e kryera nga njësitë publike të audituara, institucione të Pushtetit Qendror dhe Vendor, me dëm ndaj Buxhetit të Shtetit në shumën 13,522,392,000 lekë, ose 97.3 milionë euro. KLSH ka rekomanduar që kjo shumë të zhdëmtohet në masën 100 përqind.**

Në totalin e dëmit ekonomik të konstatuar, subjekti AlbPetrol Sh.a. ka 68 përqind të tij, ndërsa KESH Sh.a. 18 përqind.

**Gjithashtu, kemi zbuluar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1,842,998,000 lekë, ose 13.2 milionë euro.**

Në totalin e shkeljeve të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancë, shkeljet në koncesionet e dhëna nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës përbëjnë 60.4 përqind.

Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht në prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore, në urbanistikë, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj.

Në zbatim të rekomandimin Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për *“Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit”*, kemi sjellë në vitin 2012 gjithsej **58 propozime për përmirësim të legjislacionit**, përfshi dhe kërkesën për një ndryshim në Kushtetutë, nga të cilat **25** janë zbatuar tashmë, ndërsa **16** janë në proces zbatimi. Kemi rekomanduar **2,194 masa organizative**, nga të cilat janë zbatuar **1,659 ose 76 përqind** e tyre dhe kemi rekomanduar **1,221 masa disiplinore dhe administrative**, nga të cilat **860 ose 70 përqind** janë realizuar që gjatë vitit 2012. Duhet të pohojmë se ndërsa në përmbushjen e rekomandimeve tona për përmirësim ligjore, masat organizative, ato disiplinore dhe administrative kemi nivel të mirë zbatueshmërie, masat për largime nga puna të punonjësve të gjetur me shkelje, veçanërisht të drejtuesve të rangut të lartë, janë në nivel mjaft të ulët (kemi propozuar 120 largime nga puna dhe vetëm 53 janë kryer). Ky nivel i ulët ka ardhur nga serioziteti i pakët i njësive të audituara në ndëshkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për shkelës të nivelit të lartë. Na del një detyrë e rëndësishme për vitin 2013 që të ngremë në një nivel të pranueshëm këtë tregues shumë të rëndësishëm për formimin e kulturës së ndëshkueshmërisë në administratën publike.

Lidhur me rekomandimin Tuaj për përmirësimin e ligjit për KLSH-në (të cituar në fragmentin e mësipërm) dhe në zbatim të rekomandimit të Progres Raportit 2012 të BE-së për Shqipërinë, i cili ka nënvizuar se: *“Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI... Pas disa viteve në ngecje, projekt-ndryshimet në Ligjin për KLSH për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) janë përgatitur dhe janë dorëzuar në procedurë të miratimit”*, gjatë vitit 2012 plotësuam përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të KLSH, në bashkëpunim intensiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE (DG-Budget), me SIGMA-n dhe me ambientet akademike e shoqërinë civile të vendit. Nga tryezat e punës të organizuara rezultuan sugjerime të vlefshme që u reflektuan në draftin përfundimtar të Projekt-Ligjit me Amendimet, i dorëzuar Kuvendit të Shqipërisë më 30 nëntor 2012 me

shkresen nr. 945/4, datë 26.11.2012 dhe sipas vlerësimit të DG-Budget, *“tërësisht në përputhje me standardet INTOSAI”*. Amendimet sjellin një konceptim bashkëkohor si simotrat tona evropiane, të të drejtave dhe detyrave të KLSH. Ato do të ndihmojnë në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, në rritjen e kapaciteteve administrative, në saktësimin e së drejtës së KLSH të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe në saktësimin e së drejtës të çertifikojë llogaritë financiare të njësive të audituara. Amendimet forcojnë pavarësinë funksionale dhe vepruese të institucionit, duke e shndërruar KLSH-në një strukturë tërësisht të integruar dhe në përputhje me standardet e funksionimit të SAI-ve të vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe mundësojnë që të kemi Auditues Publikë (të jashtëm) të çertifikuar. Ne besojmë se Kuvendi do të na mbështesë, si gjithmonë.

Për më tepër, vetë Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e 22 Dhjetorit 2011 *“Për nxitjen e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit”* i inkurajon Shtetet Anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre të *“mbështesin SAI-t të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, duke qenë të pavarura nga subjekti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtëm”*. Ne mendonim që këtë draft-ligj Ju do ta vendosnit në axhendën e fillimvitit të Kuvendit. Tani jemi muaji i tretë i vitit dhe ju drejtohem të gjithë Juve deputetë të Kuvendit, që t'i shqyrtoni amendimet e ligjit të KLSH në një kohë sa më të afërt, pse nëpërmjet zbatimit të tyre përmirësohet qeverisja dhe rritet ndjenja e përgjegjësisë e llogaridhënia në administratën publike, si dhe mbi të gjitha, kornizohet më tej puna e institucionit drejt standardeve INTOSAI të fushës.

Duke zbatuar rekomandimin Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për *“Rritjen e eficiencës së veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë drejt auditimit të performancës”*, gjatë vitit 2012 rritëm numrin e auditimeve financiare të mirëfillta dhe shtuam ndjeshëm numrin e auditimeve të performancës, në krahasim me një vit më parë (duke u nisur nga një bazë shumë e dobët). Në shtator 2012, institucioni ngriti Departamentin e Auditimit të Performancës, me në krye një studiues të doktoruar në menaxhimin e riskut, si dhe me 16 auditues ndër ata më me përvojë në KLSH dhe auditues të rinj me perspektivë të qartë për ngritje profesionale. Tendenca sot në botë është shtimi i auditimeve të performancës (p.sh. në Slloveni rreth një e pesta e auditimeve i takon këtij lloji, ndërsa në Hollandë 25 përqind), pse duke matur ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficiencën e burimeve të harxhuara, gjetjet e këtyre auditimeve ndikojnë në planifikimin e politikave dhe programeve qeveritare për shërbimet ndaj qytetarëve. Gjithashtu, këto lloj auditimesh i japin një fizionomi tejet qytetare dhe profesionale Institucioneve Supreme të Auditimit.

Në zbatim të rekomandimit Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për *“Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet*

<sup>1</sup> Letër me Nr. Prot. 1354284 (2012) e z. Robert Gielisse, Drejtor i Njesisë së VAT dhe PIFC në DG-Budget, drejtuar KLSH më datën 16 nëntor 2012.



*ndërkombëtare e praktikat më të mira të vendeve të tjera*”, në bazë të standardit ISSAI 20, i cili orienton se “...përgjegjshmëria për SAI-n qëndron në përgjegjësinë e treguar për planifikimin dhe kryerjen e punës së tij audituese, duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për të siguruar llogaridhënien dhe transparencën mbi aktivitetet publike, duke përmbushur përgjegjësitë e tij në mënyrë të plotë dhe objektive” (ISSAI 20, botim i vitit 2010, fq. 3), kemi përditësuar Manualin e Auditimit të Performancës, të ndërtuar tërësisht mbi rezultatet dhe udhëzimet e Grupit të Punës së INTOSAI. Me qëllim përmirësimit të metodologjisë së auditimit dhe raportimeve tona, ngritëm në shkurt 2012 Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Gjatë vitit 2012 institucioni aplikoi dhe fitoi një projekt binjakëzimi për zhvillimin e metodologjisë dhe kapaciteteve të tij audituese, në kuadër të financimeve IPA 2012, me vlerë 2.11 milionë euro, i cili do të bëhet veprues në fillim të vitit 2014. Ky projekt fitohet pas gjashtë vitesh që institucioni nuk kishte marrë asistencë teknike. Ndihmë në fitimin e këtij projekti na dha dhe Qeveria shqiptare, veçanërisht Kryeministri dhe Ministria e Integritimit, Delegacioni i BE në Shqipëri dhe SIGMA, partneri ynë permanent.

Ekziston një perceptim negativ i publikut në lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike. Ky perceptim vjen nga moszbulimi dhe mosndëshkimi i korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta luftuar këtë dukuri. Në këtë këndvështrim, mirëqeverisja dhe kontributi konkret për mirëqeverisje janë antidoti më i mirë ndaj korrupsionit. Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur se “*të promovosh mirëqeverisjen në të gjitha aspektet e saj, duke siguruar sundimin e ligjit, duke përmirësuar eficiencën dhe përgjegjësinë e sektorit publik dhe duke luftuar korrupsionin, janë elementë thelbësorë të një kuadri ku ekonomitë mund të prosperojnë*” (Udhëzues, “Qasja e FMN-së në promovimin e mirëqeverisjes dhe në luftën ndaj korrupsionit”, ribotim i vitit 2011, faqe 18). Detyrat për institucionet publike shqiptare janë të jenë institucione të forta dhe të pavarura dhe të thellojnë luftën kundër korrupsionit. Kjo për KLSH si institucion suprem auditimi merr kuptim krejt të veçantë.

Si KLSH, gjatë vitit 2012 kemi kryer **40 kallëzime penale për 125 punonjës** të administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose 34 kallëzime më shumë, pothuajse 2 herë më tepër se sa 3 vitet 2009 (9 kallëzime)-2010 (5 kallëzime) dhe 2011 (6 kallëzime) të marra së bashku. Në këto kallëzime ka Drejtues të Lartë si Drejtor Kabineti në Ministri, Drejtor të Përgjithshëm në Ministri, Kryetar të Komisionit të Prokurimeve Publike, Kryetarë apo ish-Kryetarë Bashkish, drejtues të lartë në institucionet në rrethe, etj, por jemi të ndërgjegjshëm që kemi shumë për të bërë për të luftuar aktet abuzive dhe korruptive të çdo niveli.

Puna jonë shkon në sinkron me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara. Urdhëri nr. 70, datë 18.04.2006 i Kryeministrit për Zbatimin nga ekzekutivi të masave të propozuara nga Institucionet e Pavarura na ka

ndihmuar së tepërmi, megjithëse ai duhet të zbatohet më saktë dhe i plotë nga institucionet e audituara. Është vërejtur botërisht se rritja e përgjegjësive së menaxherëve publikë ndikon menjëherë në uljen e korrupsionit. Gjatë vitit 2012 jemi përpjekur të krijojmë sinergji institucionale për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në mars 2012, nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të funksionarëve të lartë të shtetit dhe një me Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, me synimin e zhbirimit të çdo rasti pasurimi të shpejtë të ndonjë funksionari publik, si dhe të rasteve të prishjes së konkurrencës në tenderat dhe ankandet shtetërore. Në qershor 2012 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria ka nisur hetimet për të gjitha kallëzimet tona. Pas hetimit paraprak, ajo ka thelluar hetimet në 36 kallzime, duke pushuar vetëm 4 prej tyre. Serioziteti që Prokuroria ka treguar ndaj denoncimeve tona mendojmë se është parësor në ndërgjegjësimin e strukturave dhe njësive publike për përgjegjësitë që ato kanë në administrimin e pronës shtetërore. Bashkëpunimi eficient i institucioneve si KLSH dhe Prokuroria e Shtetit në zbulimin dhe hetimin e abuzimeve me pronën shtetërore prodhon përgjegjshmëri dhe një shkallë më të lartë përgjegjësie ndaj disiplinës së rreptë financiare që duhet zbatuar dhe detyrave të tjera publike ul korrupsionin. Sikurse e ka theksuar Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani në adresimin e Tij në Analizën Vjetore 2012 të KLSH: *“Ky bashkëpunim, ky përkushtim, kjo dëshirë dhe ky vizion i shprehur tashmë në sy të opinionit publik për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucionit tuaj dhe Prokurorisë së Përgjithshme, do të sjellë shembuj konkretë në sytë e opinionit publik.”*

Në zbatim të rekomandimit Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për *“Harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”*, kemi iniciuar në maj 2012 marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, sidomos me strukturat e saj të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje është në veprim dhe do të realizohet e plotë gjatë këtij viti në objektivat e saj kryesore, në bazë të standardeve ISSAI 9150 dhe 1240. Një funksionim i konsoliduar i Auditimit të Brendshëm do të lehtësojë shumë realizimin e misionit të KLSH. Institucioni bashkëpunon me Auditimin e Brendshëm nëpërmjet këshillimeve të vazhdueshme, shkëmbimit të planeve të punës, zhvillimit të metodologjive, trajnimeve dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta e deri në përdorimin e punës së Auditimit të Brendshëm, kur kjo punë cilësohet se është kryer në përputhje me standartet profesionale. Si Auditimi i Brendshëm ashtu edhe KLSH, përmes një Sekretariati të Përgjithshëm, janë të angazhuar të mbështesin rekomandimet respektive të dhëna prej tyre ndaj subjekteve dhe t'i asistojnë ato në zbatim. Ndajmë mendimin që forcimi i kapaciteteve të auditimit, si atij të brendshëm dhe të jashtëm publik, është rruga e duhur për të mbështetur maksimalisht rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje.

Nga ana tjetër, sfida jonë kryesore, modernizimi i institucionit, realizohet duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera, publike dhe jo-publike të

fushës. Në përmbushje të objektivit të platformës strategjike të caktuar në dhjetor 2011 për institucionin, kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, me të cilët kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, për të na ndihmuar në kryerjen e analizës së riskut në planifikimin e auditimeve, në rritjen e cilësisë gjatë procesit auditues dhe në raportimin cilësor të gjetjeve të auditimit. Pse jo, në të ardhmen, nëse Ju si Kuvend nuk do të keni mundësi, këto institucione të pavarura ekspertësh do të auditojnë fondet tona si institucion, pra fondet e KLSH.

Në zbatim të rekomandimin Tuaj për *“Zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese”*, gjatë vitit 2012 kemi rekrutuar sipas të gjitha rregullave të punësimit në administratën publike rreth 30 punonjës të rinj, ndër të cilët pesë me gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe tetë me nivel pasuniversitar të Programit Master, në vazhdim të doktoraturës. Kemi lidhur, duke filluar nga muaji shkurt 2012 e në vijim, marrëveshje bashkëpunimi me institucionet simotra të zhvilluara të auditimit më të lartë publik. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, gjatë vitit 2012 u trajnuan jashtë shtetit një numër audituesish të KLSH i barabartë me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtatë viteve 2004-2011 të marra së bashku. Duke realizuar edhe trajnime me ekspertë të SIGMA në Tiranë për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe auditimin e teknologjisë së informacionit dhe trajnime me burime të brendshme, vitin 2012 e mbyllëm me **19.4 ditë trajnimi** për auditues në KLSH (nga vetëm 2.1 ditë trajnimi në vit për auditues, që kishim trashëguar nga viti 2011), tregues në nivel me treguesit e ditëve të trajnimit në vit për auditues të SAI-ve më të zhvilluara në kontinent.

Në zbatim të rekomandimin Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për *“Rritjen e transparencës ndaj medias dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e bashkëpunimit me botën akademike”*, kemi trajtuar **358 letra dhe ankesa nga qytetarët** për probleme të ndryshme, nga të cilat **111 i kemi konstatuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit të KLSH**, kurse nga **247 kërkesa dhe ankime** në kompetencë të institucionit, **171** prej tyre i kemi verifikuar dhe u kemi dhënë përgjigjen përkatëse, ndërsa **76** janë në vijim të verifikimit. Ndërsa për vitin 2011 institucioni ka rregjistruar, të dhëna tejet të ulta në shifra për letrat dhe ankesat e ardhura nga qytetarët. Si rezultat i këtyre ankesave të marra dhe të trajtuara gjatë vitit 2012, KLSH ka larguar katër auditues të tij, dy nga të cilët i ka paditur në Prokurori për shpërdorim detyre.

Institucioni ka qenë tërësisht i hapur ndaj mediave dhe ka bashkëpunuar me to, duke dyfishuar numrin e editorialeve, njoftimeve për shtyp dhe artikujve dhe rritur me 3.5 herë numrin e sekuencave filmike televizive, në krahasim me vitin 2011.

KLSH gjatë 2012-ës ka bashkëpunuar intensivisht me botën akademike, sidomos me profesoratin e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tiranës në tryeza pune, takime konsultative, etj, bashkëpunim i cili

është i mirë, por ende nuk po institucionalizohet për arsye procedurale burokratike.

Për rritjen e transparencës dhe eficiencës në auditim, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa nga OJF-të më të spikatura në promovimin e transparencës në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit, dhe konkretisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me Lëvizjen Evropiane Shqipëri dhe me Institutin “G&G Group”. Nga OJF-të kërkojmë jo vetëm bashkëpunim për transparencë, por edhe të marrin pjesë aktive në auditimet tona dhe ato të na auditojnë ne.

Në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv e profesional të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2012 institucioni përgatiti dhe publikoi 10 botime informative dhe profesionale, si: “KLSH-Analiza Vjetore 2011”, “KLSH në Kuvend”, “KLSH-Analiza 6-mujore 2012”, “EUROSAI dhe SAI-t Evropiane”, “Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200”, “Historiku i KLSH 2925-2012”, tre numra të revistës shkencore “Auditimi Publik” dhe Manualin e përditësuar të Auditimit të Performancës.

Më datën 28 dhjetor 2012, KLSH zhvilloi Konferencën e tij të parë Shkencore, duke ju referuar historikut të institucionit dhe punës shumëvjeçare të të gjithë personave që kanë kontribuar për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme, me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë. Konferenca dha mesazhin e ruajtjes së identitetit dhe vlerave të institucioneve kryesore të Shtetit, si bazë për formësimin e kulturës së konsoliduar shtetërore. Ky aktivitet për vitin 2013 dhe vitet në vijim synon të kthehet në një traditë dhe një forum profesional përfaqësues eksperiencash auditimi, si për auditimin e jashtëm dhe atë të brendshëm publik, duke sjellë edhe përvojën audituese të institucioneve homologe të zhvilluara në rajon dhe më gjerë.

Si përfundim, theksoj se jemi përpjekur gjatë vitit 2012 të realizojmë të gjitha rekomandimet Tuaja, thellësisht të bindur në dobishmërinë e tyre dhe përputhjen me objektivat tona strategjike. Natyrisht, jemi të vetëdijshëm se duhet të punojmë më shumë.

Në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH për vitet 2013-2016, i cili përmban objektivat kryesorë, si përmirësimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH, në përputhje me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira evropiane, përmirësimi i metodologjisë dhe rritja e cilësisë në auditim, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës, krahas konsolidimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe atyre financiarë, sigurimi i mirëqeverisjes, si dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për një menaxhim të shëndoshë financiar. Këto objektiva shkojnë në një linjë me katër drejtimit kryesorë të Strategjisë së Zhvillimit të EUROSAI, të cilat janë ndërtimi i kapaciteteve, zhvillimi i standardeve profesionale, shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave dhe

menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe komunikimit efektiv. Bashkëpunimi i gjerë dhe i thellë me Kuvendin e Shqipërisë, me qytetarët dhe shoqërinë civile, me Qeverinë dhe me të gjithë partnerët tanë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është për ne garancia më e plotë në suksesin e objektivave dhe përpjekjeve tona edhe gjatë vitit 2013.

### Shkurtimisht rreth KLSH

**Misioni ynë** është informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të njësisve të tjera publike për përdorimin e burimeve publike sipas ligjit, me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë dhe nxitja e kësaj përgjegjshmërie në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së, me standardet ndërkombëtare të INTOSAI dhe me ndjeshmërinë popullore për shtimin e luftës kundër korrupsionit.

**Vizioni ynë** është që KLSH të jetë një trupë profesionale që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre, duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë dhe njësisve të tjera publike me anë të auditimit dhe duke fituar besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.

**Si veprimet** ne rrisim aftësitë profesionale dhe etikën e punës së audituesve tanë, në një qasje pozitive të orientuar nga të mësuarit, duke përmirësuar në vijimësi marrëdhëniet tona të ngushta me palët e interesit: Kuvendin, qytetarët, partnerët e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë

**Jemi të përkushtuar** që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë institucionet e audituara prej nesh që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar, duke i shtuar vlerë të ndjeshme shërbimeve që ofrojnë.

**Jemi të angazhuar** që të ndihmojmë në fuqizimin e qeverisjes së mirë në administratën publike të vendit dhe t'i përgjigjemi me seriozitetin maksimal pritshmërive të Kuvendit dhe të qytetarëve.

**Amendimet e ligjit tonë organik** do të sjellin përmirësime të ndjeshme në punën tonë audituese, do të rrisin gamën e auditimeve që kryejmë dhe do të na mundësojnë t'ju shërbejmë më mirë qytetarëve, Kuvendit dhe palëve të tjera të interesit, përmes një stafi audituesish tejet profesionist, duke zbatuar më thellë dhe më me dobishmëri detyrimin tonë kushtetues të sigurimit të miradministrimit të fondeve dhe burimeve publike.

**Strategjia e zhvillimit KLSH 2012-2013** përfaqëson rrugët për modernizimin e veprimtarisë sonë audituese, në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe për thellimin e kontributit tonë për mirëqeverisjen publike dhe përdorimit me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë të burimeve publike.

**Bujar LESKAJ**

## I. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

### Auditime profesionale, me cilësi dhe në kohë

*Gjatë sezonit të auditimit janar-dhjetor 2012, nga 153 auditime të planifikuara, KLSH ka kryer 177, duke përfunduar plotësisht 158 auditime, ndërsa 19 janë në proces final evadimi. Në krahasim me një vit më parë, numri i auditimeve të përfunduara gjatë vitit 2012, është tejkaluar me 6 auditime, ose në masën rreth 4%. Veprimtaria audituese, e cila përbën aktivitetin kryesor të institucionit është realizuar në numër subjektësh objekt auditimi plotësisht. Njëkohësisht, janë bërë hapa të rëndësishëm përpara në përsosjen e kësaj veprimtarie, në raport me një vit më parë. Rezultatet e veprimtarisë së këtij viti janë dukshëm më të larta si nga ana sasimore dhe cilësore, në krahasim me një vit më parë.*

Më konkretisht, në 158 auditime të evaduara:


- 81 auditime kanë qenë auditime për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë ku në krahasim me 58 auditimet e kryera një vit më parë kemi një rritje prej 23 auditimesh ose në masën rreth 40%. Këto janë auditime pothuajse financiare dhe nevoja për to paraqitet në rritje.
- 50 auditime kanë qenë auditime të kombinuara. Duke qenë se ky lloj auditimi në të shkuarën nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara, ka një ulje në vitin 2012 me 24 auditime, ose në masën rreth 32%.
- 17 auditime kanë qenë të mirëfillta financiare ku në krahasim me 10 auditime të kryera një vit më parë kemi një rritje prej 7 auditimesh ose në masën 70% më shumë.
- 4 auditime kanë qenë auditime performace ku në krahasim me 1 auditim të kryer një vit më parë kemi një rritje prej 3 auditimesh, ose 4 herë.
- 2 auditime kanë qenë vlerësuese ku në krahasim me 4 auditime të kryera një vit më parë kemi një ulje prej 2 auditimesh, dhe
- 4 auditime tematike, nga 5 një vit më parë, pra me një ulje prej 1 auditim.

Auditimet e përfunduara janë ushtruar në:

Ministritë dhe institucionet qendrore	40
• Institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	64
• Drejtoritë dhe degët e tatimeve dhe të doganave	12
• Institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror	12
• Njësitë dhe projektet me financime të huaja	11
• Subjekte të mbrojtjes së mjedisit	8
• Subjekte të administrimit dhe regjistrimit të pronës	11

## Grafiku Nr. 1:

## Struktura e auditimeve për vitin 2012 (në përqindje)



## Arritjet kryesore në performancën e KLSH 2012:

- **Ndryshimi dhe përmirësimi i bazës rregullatore të institucionit**, duke filluar nga Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së, e cila u ripunua plotësisht, duke justifikuar me produkte konkrete qëllimin e ribërjes së saj; rishikimin dhe rihartimin e dokumenteve standarde të auditimit; përkthimin dhe botimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit të përditësuara të INTOSAI, duke filluar nga ISSAI 1 Deklarata e Limës, Deklarata e Meksikës, Kodi Etik dhe deri tek Standardet e Raportimit. Përkthimi dhe botimi EUROSAI (Institucionet Supreme Evropiane të Auditimit), ku jepet informacion mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimin të institucioneve supreme të auditimit të vendeve të Evropës dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve (organi më i lartë auditues i BE).
- **Rritja e shkallës së zbatimit të kërkesave të metodologjisë së auditimit dhe përmirësimin e saj**, bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe në përvojën e mirë të institucioneve të auditimit në vende të tjera, veçanërisht të Gjykatës së Auditimit Slloveni, NIK Poloni dhe Gjykatës së Llogarive Turqi.
- **Përfshirja në auditim nga KLSH e një numri më të madh të subjekteve të konsideruar me risk** apo problematike, përfshirë ata që menaxhojnë fonde në vlera të mëdha buxhetore.
- **Përmirësimi cilësor i punës audituese dhe i cilësisë së materialeve të auditimit**, në funksion të përmbushjes së detyrimit kushtetues dhe ligjor për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011 dhe miradministrimin e fondeve dhe pronës publike.  
Në përmirësimin e evidentuar, ndër të tjera impakt ka pasur dhe zbatimi i detyrës për ristrukturimin e Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, duke krijuar brenda tij *Drejtorinë e Auditimit Financiar dhe Sistemit të*

*Auditimit të Brendshëm.* Ky ristrukturim dha frytet e para në auditimin e Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2011, në përgatitjen e Raportit për zbatimin e këtij buxheti, si në paraqitje dhe në përmbajtje të Raportit, dhe mbi të gjitha në cilësinë e përmbajtjes së masave të rekomanduara.

Në drejtim të auditimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2011, kemi gjetur mirëkuptim me Ministrinë e Financave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me Raportin Përfundimtar të Auditimit të Buxhetit të vitit 2011.

*(Shkresa nr. 4637/19, datë 16 janar 2013 e Ministrit të Financave, z. Ridvan Bode).*

o **Rritja e kontributit të KLSH-së në fushën e ndryshimit apo përmirësimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.** Gjatë vitit 2012, janë bërë 58 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, nga 45 propozime të bëra në vitin 2011, pra 13 propozime më shumë ose në masën rreth 29% më shumë. Gjithashtu për herë të parë KLSH bën 1 (një) propozim për ndryshime Kushtetuese.

o **Kryerja për herë të parë e auditimit mbi vlerësimin e funksionimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit** në subjektet e audituara. Për këtë, nëpërmjet një akti të brendshëm kemi përfshirë në programet e auditimit një pike të veçantë për auditim *“Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe auditimit”*.

Qëllimi ynë është që të bashkërendojmë përpjekjet tona me ato të qeverisë për implementimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

o **Koordinimi i veprimtarisë auditim i jashtëm - auditim i brendshëm.** Është institucionalizuar ky koordinim dhe bashkëpunimi e mirëkuptimi reciprok mes KLSH dhe Ministrisë së Financave mbështetet mbi raporte të reja pune, të cilat janë finalizuar me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në datën 8 maj 2012, ndërmjet dy institucioneve tona, mbi bazën e standardit ISSAI 9150 “Për qeverisjen e mirë”. Në zbatim të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje është ngritur Sekretariati i përbërë nga një prej Drejtorëve të Përgjithshëm të KLSH, nga Drejtori i Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, i cili ka filluar nga funksionimi dhe deri në fund të vitit 2012 ka zhvilluar 2 takime. Në këto takime, krahas analizimit të nivelit aktual të marrëdhënieve, janë përcaktuar drejtimet konkrete të këtij bashkëpunimi.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, vlen të përmendet takimi i organizuar në lidhje me strategjinë e planifikimit të auditimeve të vitit 2013, me qëllim shmangien e dublimit të auditimit të jashtëm me atë të brendshëm. Për këtë qëllim dhe në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, Ministri i Financave me shkresën nr. 16467/1, datë 31 tetor 2012, dërgoi në KLSH një kopje të programeve vjetore të miratuara të njësive të auditimit të brendshëm në ministritë e linjës dhe të Njësive të Auditimit të Brendshëm në DPT, DPD, ISSH dhe ISKSH, programe të cilat u studiuan dhe u morën parasysh gjatë planifikimit të auditimeve tona për vitin 2013.



o **Referuar standardit profesional te 15 ditëve të trajnimit për punonjës në vit,** KLSH vendosi si objektiv ne fillim te vitit 2012 realizimin dhe tejkalimin e këtij standarti të trajnimeve : për çdo punonjës auditues dhe në detyra ndihmëse minimumi 10 ditë trajnime në vit dhe për çdo punonjës të ri 25 ditë trajnime në vit. Për stafin ekzistues, nga 10 ditë të parashikuara, janë realizuar 16.6 ditë trajnime në vit për person, ndërsa për stafin e rekrutuar rishtazi, nga 25 ditë, janë realizuar 24.8 ditë trajnime në vit për person. Mesatarisht në nivel institucional janë realizuar **19.4 ditë trajnime** për person, nga 2.1 ditë që ka qenë një vit më parë, ose mbi 9 herë më shumë, duke realizuar standartet e Institucioneve simotra evropiane.

Punonjësit e instituionit kanë përfituar gjatë vitit 2012 shumë trajnime jashtë vendit mbështetur nga SAI-t partnere. Numri i audituesve të KLSH-së të cilët kanë përfituar nga trajnimet e kryera jashtë shtetit këtë vit ka qenë 69 auditues, i barabartë me numrin e audituesve të trajnuar në 7 vitet e mëparshme të marra së bashku (2004-2011).

Ky objektiv, i thjeshte në dukje, por plot përmbajtje e vlera profesionale ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore të KLSH gjatë vitit 2013.

o Ndonëse produkti i përfutur dhe vënë në përdorim nga audituesit në fushën e teknologjisë së informacionit është ende i pamjaftueshëm, nuk mund të lihen pa pasqyruar përpjekjet e bëra nga stafi i KLSH-së për përfitim njohurish dhe përdorimin më gjerësisht të mjeteve të kësaj teknologjie. Faqja në internet e KLSH është riformatuar me një konceptim bashkëkohor dhe paraqitje më miqësore për lexuesin dhe përmban informacione të detajuara për auditimet dhe aktivitetet e institucionit.

o Duhet pasqyruar përdorimi dhe shfrytëzimi më racional i burimeve njerëzore dhe përdorimi me ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve buxhetore akorduar institucionit tonë për vitin 2012, fonde me të cilat arritëm të përballonim me sukses veprimtarinë audituese të programuar, në mënyrë të veçantë trajnimin intensiv dhe me të gjitha format, pothuajse të gjithë punonjësve të institucionit brenda dhe jashtë vendit, si dhe botimin e 10 librave, duke filluar nga historiku i KLSH-së, standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe deri në manualin e auditimit të performancës. Fondet buxhetor të akorduar KLSH-së për 2012 kanë qenë afërsisht të njëjta me ato të akorduar në vitin 2011 apo dhe 2010.



o Përsa i përket transparencës me qytetarin gjatë vitit 2012, KLSH ka trajtuar **358 letra dhe ankesa** nga qytetarët, për probleme të ndryshme, në krahasim me një numër të papërfillshëm të letrave dhe ankesave të trajtuara në vitin 2011. Nga 358 letra 111 prej tyre kanë rezultuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit të KLSH.

Nga **247 kërkesat dhe ankimet në kompetencë të KLSH**, 171 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse ankimesve, ndërsa 76 janë në vazhdim të verifikimit.

Nga analizimi i problematikës të trajtuar në këto kërkesa dhe ankesa rezulton se, rreth 34% e tyre i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; rreth 50% privatizimit dhe kthimit të pronës; rreth 2% tatimeve dhe taksave dhe 14% të tjera. Në numër, për administrimin financiar dhe fushën e prokurimit publik kanë ardhur 121 kërkesa dhe ankimime, për privatizimin dhe kthimin e pronës 181; për tatimet dhe taksat 6; dhe të tjera 50.

Për administrimin e letrave dhe ankesave të publikut, është miratuar për përdorim udhëzimi i Kryetarit të KLSH me nr. 2, datë 5/3/2012, ku përcaktohen gjithë veprimet që duhen ndërmarre nga departamentet, drejtoritë dhe personat e ngarkuar për protokollimin, shpërndarjen, verifikimin dhe deri në kthimin e përgjigjes letërshkruesve apo ankimuesve.

Bazuar në ankesat e qytetarëve për punën audituese të disa prej prej nëpunësve të KLSH-së, institucioni ynë ka marrë masa administrative dhe disiplinore deri në largimin nga detyra të dy audituesve.

o Në lidhje me transparencën me mediat përmirësimet kanë qenë të dukshme. Kemi patur një bashkëpunim dhe komunikim efikas me median e shkruar dhe atë elektronike. Gjatë vitit 2012, institucioni mundësoi 496 editoriale, shkrime, raportime dhe njoftime në median e shkruar, nga 280 të tilla në vitin 2011 dhe mbi 345 sekuenca filmike televizive, nga 100 në vitin 2011. Për herë të parë, në janar 2012 u zhvilluan analizat vjetore në nivel departamenti si dhe analiza e përgjithshme e KLSH-së me praninë e medias dhe të përfaqësuesve nga shoqëria civile. Në këtë drejtim kemi më shumë për të përmirësuar duke e konsideruar median si aleat të vyer dhe të përhershëm.

KLSH zhvilloi Analizën 6 mujore në korrik-gusht 2012, mbi bazën e eksperiencës së Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës z. Lars Lage Olofsson, ku evidentoi ç'ka ishte bërë mirë, ç'ka ishte bërë më pak mirë dhe ç'mund të bëjmë më mirë dhe në grupe pune u nxorën detyrat për gjashtëmujorin e dytë.



Analiza 6-mujore e KLSH-së, Vlorë, Korrik 2012

Në analizën 1 vjeçare të punës së vitit 2012, KLSH mori mesazhe domethënëse mbështetjeje dhe bashkëpunimi nga Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Bujar Nishani, nga Prokurori i Përgjithshëm z. Adriatik Llalla, nga Presidenti i SAI-t Polak z. Jacek Jezierski, nga Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës z. Lars Lage Olofsson dhe nga z. Joop Vrolijk, Konsulent i Lartë i SIGMA, të cilat plotësojnë mesazhet dhe mbështetjen e dhënë nga të gjithë deputetët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, si dhe mbështetjen institucionale permanente të dhënë nga Kryeministri i vendit, Prof. Dr. Sali Berisha.

*Për ndihmesën bujare që na kanë dhënë në realizimin e performancës së KLSH gjatë vitit 2012, falenderojmë në mënyrë të veçantë z. Jacek Jezierski, President i Zyrës Kombëtare të Auditimit Suprem të Polonisë (NIK), Prof. Asoc. Dr. Rejai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Dr. Igor Soltes, President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë dhe z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës, z. Robert Gielisse nga DG Budget BE dhe z. Joop Vrolijk nga SIGMA.*


## II. GJETJET KRYESORE NË AUDITIME

Në përfundim të auditimeve të ushtruar gjatë vitit 2012, për auditimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ushtruar në periudhën 3/vjeçare (2008-2011) në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, audituesit e KLSH-së kanë **konstatuar dhe evidentuar parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me pasojë dëm ekonomik në shumën totale prej 13,522,392 mijë lekë.** Nga kjo vlerë dëmi e evidentuar, **KLSH ka rekomanduar shpërblimin e tij në masën 100%.**

Krahasuar me një vit më parë, ku janë raportuar **7,027,566 mijë lekë zbulime me pasojë dëm ekonomik, këtë vit janë zbuluar 6,494,826 mijë lekë më shumë ose mbi 92% më shumë.**

Vlera e dëmit ekonomik të zbuluar për periudhën 5/vjeçare (2008-2012), paraqitet si më poshtë:


### Grafiku Nr. 2:



Cilësojmë se, tendenca në rritje e këtij treguesi në vitet 2011 dhe 2012, reflekton dhe moslikujdimin e detyrimeve kontraktore ndaj 2 (dy) shoqërive publike Albpetrol sh.a. dhe KESH sh.a., respektivisht në vitin 2011 në vlerën 3,936,800 mijë lekë ndaj Albpetrol sh.a. dhe në vitin 2012 në vlerën 9,195,395 mijë lekë ndaj Albpetrol sh.a. dhe 2,451,092 mijë lekë ndaj KESH sh.a, vlera të cilat zënë rreth 86% të shumës totale të dëmit ekonomik të evidentuar gjatë këtij viti.

Dëmi ekonomik përfshirë moslikujdimin e detyrimeve kontraktore ndaj Albpetrol dhe KESH sh.a. për vitin 2012, paraqitet si vijon:

Grafiku Nr. 3:



Krahas zbulimeve me dëm ekonomik, gjatë vitit 2012, janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e njësive të audituara, **në shumën e përgjithshme 1,842,998 mijë lekë.**

**II.1 Sipas fushave dhe sektorëve** ku janë konstatuar dhe evidentuar dëmet ekonomike, rezulton:

**1. Në fushën e shitjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, në vlerën 673,997 mijë lekë:** konstatuar në 3 ministri, 13 bashki dhe 4 komuna. Për t'u përmendur zbulimet:

- Në METE, në vlerën 606,927 mijë lekë, e cila zë rreth 90% të vlerës gjithsej të zbulimeve në këtë fushë, *shkaktuar si pasojë e mosushtrimit të penalteteve për shkeljet e kushteve të kontratave koncesionare nga 24 koncesionarë dhe mosndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e dëmit të tyre ekonomik në vlerën prej 595,146 mijë lekë, si edhe për mosllogaritje e mosarkëtim në favor të METE-s të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura për "Fee koncesionare", ku vetëm nga 5 shoqëri koncesionare që dispononin dokumente (nga 13 të tilla) është shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 11,781 mijë lekë (vetëm për dy vjet aktivitet prodhimi dhe shitje të energjisë elektrike).*

- Në MPPT, Tiranë, në vlerën 15,333 mijë lekë, *si fitim neto i buxhetit të shtetit, kaluar padrejtësisht në favor të një konkensionari me vendim të Këshillit Drejtues të DPSHTRR dhe miratim të Drejtorisë së Politikave të Planifikimit Financiar dhe Statistikave.*

- Në Bashkinë Laç, në vlerën 28,121 mijë lekë, *shkaktuar nga mosarkëtimi i qirave për ambientet e dhëna me qira të tretëve dhe në Komunën Zharëz, Qarku Fier, në vlerën 5,853 mijë lekë, nga mosarkëtimi i qirave për shfrytëzim truall dhe tokë bujqësore, si dhe mosushtrim të kamat vonesave.*

**2. Në fushën e prokurimeve publike, në vlerën 444,573 mijë lekë;** konstatuar në 7 ministri, 9 institucione të tjera qendrore dhe drejtori të përgjithshme, 29 bashki, 15 komuna, 1 shoqëri anonime, 1 Drejtori Rajonale dhe 1 Universitet. Peshën kryesore e zë Ministria e Brendshme, Tiranë me 225,679 mijë lekë, ose në masën rreth 51% të vlerës gjithsej të zbuluar në këtë fushë, që përfaqëson veprime nga Komisioni i Prokurimit Publik në kundërshtim me rregullat e tenderimit, duke s'kualifikuar Operatorë Ekonomik të cilët kanë paraqitur oferta me vlera më të ulëta; KESH sh.a. Tiranë 54,761 mijë lekë ose mbi 12% që përfaqëson sanksione për moszbatim të grafikëve të punimeve; Bashkia Pogradec 20,738 mijë lekë ose 4.7%, Komuna Qukës, Librazhd 18,283 mijë lekë ose 4.1% dhe Bashkia Korçë 17,672 mijë lekë ose rreth 4%.

**3. Në fushën e urbanistikës, në vlerën 125,159 mijë lekë;** konstatuar në 15 bashki, 1 këshill qarku, 4 komuna dhe 1 Drejtori Rajonale ALUIZNI. Për t'u përmendur zbulimet:

- Në Bashkinë Sarandë, në vlerën 55,438 mijë lekë ose në masën mbi 44% të vlerës gjithsej të zbuluar në këtë fushë dhe në Bashkitë: Pogradec, Peshkopi, Himarë dhe Përmet, në vlerat respektive, 13,323 mijë lekë, 7,134 mijë lekë, 6,522 mijë lekë dhe 4,745 mijë lekë, *shkaktuar nga mospagesa e taksës së infrastrukturës në masën 1% të vlerës së investimit;* si dhe në Bashkinë Rrëshen në vlerën 11,629 mijë lekë, *pagesa të pakryera (të llogaritura më pak) të taksës të ndikimit në infrastrukturë.*

**4. Në fushën e shpenzimeve operative, në vlerën 104,033 mijë lekë;** konstatuar në 3 ministri, 10 institucione të tjera qendrore dhe drejtori të përgjithshme, 17 bashki, 10 komuna, 3 shoqëri anonime, 2 projekte, 1 degë doganore, 1 Universitet, 1 Drejtori Rajonale dhe 1 Drejtori Rajonale ALUIZNI. Peshën kryesore e zenë zbulimet:

- Në Autoritetin e Aviacionit Civil, Tiranë në vlerën 56,971 mijë lekë ose në masën rreth 55% të vlerës gjithsej të zbuluar në këtë fushë; në Bashkitë: Pogradec 12,176 mijë lekë ose 11.7%; Himarë 10,459 mijë lekë ose 10%; dhe Komunën Milot 2,627 mijë lekë ose 2.5%.

**5. Në fushën e sistemit të pagave, në vlerën 72,028 mijë lekë;** konstatuar në 5 institucione qendrore dhe drejtori të përgjithshme, 1 këshill qarku, 19 bashki, 6 komuna, 3 shoqëri anonime, 1 projekt, 1 degë doganore, 1 Universitet, 1 Drejtori Rajonale dhe 1 Drejtori Rajonale ALUIZNI. Peshën kryesore e zenë zbulimet:

- Në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, në vlerën 31,588 mijë lekë ose në masën rreth 44% të vlerës gjithsej të zbuluar në këtë fushë; *si përfitim pagesash*



*të padrejta për titull shkencor të pa akorduar dhe të pa regjistruar në Regjistrin Shtetëror të diplomave në MASH dhe për orë pune jashtë kohës normale të punës për funksione administrative, në kundërshtim me VKM nr. 748, datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”.*

- Në Bashkinë Lezhë, në vlerën 5,937 mijë lekë ose 8.2%; Këshillin e Qarkut Kukës 5,411 mijë lekë ose 7.5%; Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave 5,346 mijë lekë ose 7.4%; Agjencinë Telegrafike Shqiptare 2,456 mijë lekë ose 3.4%; dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve 1,991 mijë lekë ose 2.8%; *pagesa të dhëna tepër në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe tabelën e pagave dhe jashtë kohës normale të punës (të pajustificuara ligjërisht).*

**6. Në sektorin doganor, në vlerën 62,006 mijë lekë;** konstatuar në 7 degë doganore, ndër të cilat paraqesim zbulimet:

- Në Degët e Doganave: Fier dhe Tiranë, në vlerat respektive 19,794 mijë lekë dhe 12,824 mijë lekë, *detyrime doganore të papaguara në zhdoganimet e disa artikujve të ndryshëm dhe penalitete të pa vendosura ndaj subjekteve që nuk kanë paguar t.v.sh., si dhe për subjekte që operojnë me regjimin e përpunimit aktiv.*

- Në Degën e Doganës Vlorë, në vlerën 11,311 mijë lekë, *detyrime doganore të llogaritura më pak dhe penalitete të pa vendosura ndaj subjekteve.*

- Në Degën e Doganës Sarandë, Qafë-Botë, në vlerën 9,508 mijë lekë, *detyrime doganore të pa llogaritura ose të llogaritura më pak; shmangie të detyrimeve doganore financiare nga futja e mallrave kontrabandë; moskryerje e konfiskimit të mallrave si akt administrativ dhe të ardhura të munguara nga klasifikimi i gabuar i kodit tarifor.*

**7. Në sektorin e tatimtaksave, në vlerën 38,078 mijë lekë;** konstatuar në 1 ministri, 1 shoqëri anonime, 3 projekte, 11 bashki, 1 komunë, 1 Drejtori Rajonale dhe 1 ZVRPP. Për t'u pasqyruar zbulimet:

- Në Projektin “Spitali Universitar Nënë Tereza”, Tiranë, në vlerën 9,397 mijë lekë ose në masën rreth 25% të vlerës gjithsej të zbuluar në këtë sektor, *për mosderdhje të tatimit mbi të ardhurat e përfituara në Shqipëri nga një shoqëri konsulente..*

- Në Projektin “Ndërtimi i TEC-it Vlorë” dhe Autoritetin e Aviacionit Civil, sh.a., Tiranë, në vlerat respektive 9,646 mijë lekë dhe 4,200 mijë lekë, *si pasojë e mosderdhjes së t.v.sh.-së.*

- Në Bashkitë: Përmet, Sarandë, Korçë dhe Peshkopi, në vlerat respektive 3,731 mijë lekë, 1,920 mijë lekë, 1,892 mijë lekë dhe 1,881 mijë lekë, *detyrime të papaguara të taksave vendore.*

**8. Në fushën e shpërblimeve, në vlerën 4,641 mijë lekë;** konstatuar në 3 institucione qendrore, 1 shoqëri anonime, 1 Drejtori Rajonale, 5 bashki dhe 1 komunë. Për t'u përmendur zbulimet:

- Në Bashkitë: Delvinë dhe Gramsh, në vlerat respektive 1,030 mijë lekë dhe 855 mijë lekë, *shpërblime të përfutur padrejtësisht nga punonjësit.*

- Në KQZ, Tiranë, në vlerën 792 mijë lekë, *përfitime shpërblimi në kundërshtim me VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve*

*buxhetore” dhe VKM nr. 472, datë 02.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore të vitit 2011”.*

- Në Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, Qyteti Shkodër, në vlerën 790 mijë lekë.

**9. Në mungesë materiale në shumën 3,928 mijë lekë:** konstatuar në 5 njësi publike, ndër të cilat paraqesim zbulimet në Ujësjellës Kanalizime, sh.a. Mat në vlerën 2,045 mijë lekë dhe në Projektin “Rehabilitimi i Spitalit të Shkodrës faza-III” 1,464 mijë lekë, *mungesë inventari ekonomik.*

**10. Në zërin “Të tjera”, shkelje të disiplinës financiare në shumën e përgjithshme 11,993,941 mijë lekë,** konstatuar në 2 ministri, 4 institucione të tjera qendrore dhe drejtori të përgjithshme, 5 bashki, 1 komunë, 7 shoqëri anonime, 8 projekte, 1 degë doganore, 1 Drejtori Rajonale, në Zyrën Qendrore të ALUIZNI dhe 3 drejtori rajonale ALUIZNI. Ndër këto njësi publike, veçojmë:

- Albpetrol Sh.a. Fier, në vlerën 9,195,395 mijë lekë, *për mos shlyerjen e detyrimeve kontraktore nga një operator ekonomik privat në vlerën 5,375,445 mijë lekë dhe të kamat-vonesave për prodhim të patërhequr në vlerën 3,819,950 mijë lekë nga kompanitë që operojnë në bazë të marrëveshjeve të hidrokarbureve, vlerë e cila zë rreth 77% të dëmit total të zbuluar në këtë zë.*

- KESH, Sh.a., Tiranë në vlerën 2,451,092 mijë lekë, ose në masën mbi 20% të vlerës totale të zbuluar në këtë zë, si pasojë e mosarkëtimit të vlerës së energjisë elektrike të furnizuar dhe të faturave nga CEZ sh.a. për periudhën nga 31.12.2010 deri në 31.12.2011 dhe nga mosaplikimi i normës së interesit për faturat e palikuiduara. Për këtë problem, VKM nr. 154, datë 29.02.2012 “Për miratimin e marrëveshjes tip për fillimin e procedurave për shuarjen me kompensim, të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti dhe CEZ Shpërndarje sh.a.”, ka përcaktuar “Fillimin e procedurave për shuarjen me kompensim të detyrimeve të ndërsjella midis institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti dhe CEZ Shpërndarje Sh.a”.

- Në Zyrën Qendrore të ALUIZNI-t dhe Drejtoritë Rajonale Durrës dhe Tiranë, në vlerat respektive 51,900 mijë lekë, 31,529 mijë lekë dhe 8,777 lekë, *nga moslllogaritja e saktë e vlerave të parcelave ndërtimore, të penalteteve dhe të taksave vendore për 94 objekte të legalizuara; si dhe në ALUIZNI Vlorë në vlerën 35,000 mijë lekë, si diferencë e sipërfaqes së truallit që disponohet në fakt, me atë të përcaktuar në VKM-të përkatëse.*

- Në DRSSH, Tiranë, në vlerën 59,216 mijë lekë, *si pasojë e mosnxjerrjes së urdhërave të pezullimit, për pagesat e përfitimeve afatgjata të pensioneve, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”; përfitime të padrejta për pensione të parakohëshme dhe suplementare për ushatarakët dhe përfitime nëpërmjet falsifikimit të dokumentacionit.*

- Në MTKRS, në vlerën 11,473 mijë lekë, *përfitime të padrejta nga 26 subjekte, për aktivitete artistike të porealizuara, në kundërshtim me kontratat e lidhura dhe me dokumentacion të pajustificuar (kopje të fotokopjuara, të palexueshme, të pa noteruara, etj.) dhe përfitime të padrejta nga dy subjekte private*



*konkretisht nga mosmbajtja e tatimit mbi të ardhurat në burim në veprimtaritë artistiko-kulturore të organizuara nga kjo ministri dhe mostransmetimin e 12 spoteve publicitare.*

- Në MPÇSSHB, në vlerën 9,419 mijë lekë, *përfitim i padrejtë dhe i pajustificuar nga një subjekt privat, në shumën 9,238 mijë lekë, në kushtet kur nuk janë plotësuar detyrimet kontraktore për realizimin, prodhimin e transmetimin e një spoti publicitar e dokumentar dhe përfitim i padrejtë nga një shoqatë në shumën 181 mijë lekë, si pasojë e gabimeve aritmetike të konstatuara në ofertën e një operatori ekonomik me të cilin është lidhur kontrata për aktivitetin “Minoritetet në Shqipëri”, etj.*

**II.2 Përsa i përket *shkeljeve të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituar, vlera përlllogaritët në 1,842,998 mijë lekë, e konstatuar në:***

- METE, Tiranë, në shumën 1,113,730 mijë lekë, *si pasojë e moszbatimit të akteve nënligjore në fuqi në fushën e dhënies me koncesion në industrinë e bakrit, kromit dhe energjetikës.*

- Autoritetin Rrugor Shqiptar, Tiranë, në vlerën 304,788 mijë lekë, *si pasojë e llogaritjes së gabuar të analizave teknike të çmimeve dhe rritja artificiale e fondit limit për disa raste, si dhe evazion fiskal për shkak të mospagesës në kohë të t.v.sh.-së.*

- MMPAU, Tiranë, në vlerën 132,877 mijë lekë, *si pasojë e menaxhimit të dobët të punës për llogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave, duke krijuar debitorë.*

- Qendrën e Publikimeve Zyrtare, Tiranë, në shumën 22,553 mijë lekë, *nga shpërndarja falas të fletoreve zyrtare dhe botimeve të tjera, si dhe shitja e disa botimeve nën koston e prodhimit.*

- Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizime, sh.a., Tiranë, në shumën 13,756 mijë lekë, *si pasojë e parashikimit më tepër të vlerës së kontratës në punimet e ndërtimit dhe rehabilitimit të 4 ujësjiellësave.*

- Shërbimin Social Shtetëror, Tiranë, në vlerën 21,754 mijë lekë, *si përfitime në mënyrë abuzive nga skema e ndihmës ekonomike të 4141 familjeve dhe pagesa të paligjshme për 441 raste si persona me aftësi të kufizuar.*

- DPSHTRR, Tiranë, në vlerën 28,173 mijë lekë, *si pagesa të dyfishta për të njëjtin vendpune nga largimi padrejtësisht nga puna të 15 punonjësve për periudhën 01.10.2009-31.12.2011 dhe pa nxjerrë përgjegjësinë e shkaktarëve në vlerën 15,543 mijë lekë, si edhe mosarkëtimi i gjobave të kundërvajtjeve rrugore në shumën 12,630 mijë lekë.*

- Drejtorinë Arsimore Rajonale, Shkodër, në vlerën 10,336 mijë lekë, *si pagesa të dyfishta për të njëjtin vend pune nga largimi padrejtësisht nga puna të 19 punonjësve, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

- Inspektoriatin Shtetëror të Punës, Tiranë, *si pasojë e mosarkëtitimit të gjobave të vendosura e të pa kontabliuara në vlerën 94,500 mijë lekë,*

- Qendrën Kombëtare të Kulturës për Femijë, Tiranë, *si pasojë e përdorimit pa efektivitet dhe jashtë destinacionit të shumës prej 765 mijë lekë.*

- DRSSH, Tiranë, në vlerën 26,624 mijë lekë, *si pasojë e mosnxjerrjes së urdhërit të pezullimit për përfituesit abuziv dhe mos kontabilizim të tyre si debitorë.*

- MTKRS, Tiranë, në vlerën 8,031 mijë leke, *si pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna dhe përfitime financiare për projekte pa dokumentacionin e duhur justifikues.*
- Ministrinë e Brendshme, Tiranë, *si pagesa të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për largim të padrejtë nga puna në vlerën 37,841 mijë lekë.*
- MBUMK, Tiranë, në vlerën 21,640 mijë lekë, *si evazion fiskal nga shitjet e prodhimeve në subjekte private të pa regjistruara, mosarkëtim të vlerës së skrapit të shitur, mosarkëtim të vlerës së mjeteve bujqësore të dhëna në përdorim ose rikthimin e tyre, si dhe pagesë të padrejtë CEZ Shperndarje Lezhë nga llogaritje të gabuara, etj.*

**II.3 Sipas Departamenteve të Auditimit**, vlera e shkeljeve financiare me dëm ekonomik, paraqitet si më poshtë:

1. Departamenti Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes Mjedisit.....**11,913,731 mijë lekë;**
2. Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.....**996,457 mijë lekë;**
3. Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës.....**540,489 mijë lekë;**
4. Departamenti Auditimit të Ardhurave të Buxhetit .....**71,715 mijë lekë.**

Referuar këtyre të dhënave, rezulton se, Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka zbuluar 88.1% të vlerës së përgjithshme të dëmit të evidentuar; Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm 7.4%; Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës rreth 4% dhe Departamenti i Auditimit të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit mbi 0.5%.

Nga krahasimi i të dhënave të zbulimeve të një viti më parë, me ato të vitit 2012, rezulton se:

1. Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, gjatë vitit 2012 ka zbuluar 5,819,144 mijë lekë më shumë ose në masën mbi 95% më tepër (11,913,731/6,094,587)
2. Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qëndror, ka zbuluar 575,979 mijë lekë më shumë ose në masën mbi 2 herë më tepër (996,457/420,478)
3. Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, ka zbuluar 213,262 mijë lekë më shumë ose në masën 65% më tepër (540,489/327,227)
4. Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, ka zbuluar 113,559 mijë lekë më pak se një vit më parë ose në masën rreth 61% më pak (71715/185,274).

*Ky i fundit paraqitet dhe Departamenti me performancën më të dobët në KLSH, veprimtaria e të cilit është bërë objekt debati dhe diskutimi për përmirësim, në fund të vitit 2012 dhe në muajt e parë të këtij viti. Ndër masat e parashikuara për përmirësim është edhe kapërcimi i gjendjes aktuale të perealizuar mirë profesionalisht në auditimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe njësisive vartëse të saj, konform standardeve ndërkombëtare të auditimit,*

*specifikisht në Deklaratën e Limës, Kapitulli VII, neni 20 “Kontrolli Tatimor”, pika 1 “Institucionet Supreme të Auditimit kanë të drejtë të auditojnë mbledhjen e taksave dhe të shqyrtojnë dosjet individuale tatimore”.*

### **III. REKOMANDIMET DHE ZBATIMI I TYRE.**

Bazuar në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH, për të gjitha të metat, parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të ligjshmërisë dhe ato financiare me pasojë dëm ekonomik, të konstatuara gjatë vitit 2012 dhe të pasqyruara në raportet respektive të auditimeve të këtij viti; u ka dërguar zyrtarisht subjekteve të audituar raportet përfundimtarë të kontroleve së bashku me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Njëkohësisht me to, janë njoftuar edhe institucionet qendrore eprorë, në disa raste edhe organet më të larta shtetërore.

Cilësoj se, rekomandimet e bëra për përmirësimin e gjendjes dhe ndjekja e realizimit të tyre përbëjnë një ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së KLSH-së. *Përgatitja dhe dërgimi i rekomandimeve nga KLSH, mbështetet në nenet 9 dhe 16 të Ligjit Organik të KLSH.*

Masat e rekomanduara nga ana e jonë janë të karakterit organizativ, të propozimeve për ndryshime apo përmirësim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të zhdëmtimit, administrative dhe disiplinore.

Krahas detyrimit ligjor, për kthimin e përgjigjeve nga subjektet e audituar për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve (neni 16 i ligjit të KLSH) nga marrja e tyre, KLSH, në programet e auditimit ka parashikuar pikë të veçantë *“kontrollin e detyrave të lëna”*, ndërkohë që në fund të vitit 2012 dhe në ditët e para të vitit 2013, departamentet e auditimit me programe pune të veçanta kanë ushtruar kontrole në subjektet e audituar gjatë vitit 2012 për zbatimin e rekomandimeve.

Vlen të përmendet se, krahas përpjekjeve tona dhe përgjegjshmërisë së subjekteve të audituar në drejtim të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve, impakt në rritjen e nivelit të zbatimit të masave përmirësuese të rekomanduara nga ana e jonë, ka dhënë dhe Urdhëri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrive”. Megjithatë, duhet të theksoj që jo nga të gjithë drejtuesit e njësive të audituar, ky detyrim ligjor dhe Urdhër i Kryeministrit, është kuptuar dhe zbatuar drejt. Në të ardhmen, ne do të informojmë Kryeministrin dhe opinionin publik, për ata drejtues të lartë që me pa të drejtë nuk zbatojnë rekomandimet tona, sidomos ato për “largim nga puna” të vartësve të tyre të paafte apo për më keq të korruptuarve, duke kontribuar me mosveprimin e tyre në rritjen e antikulturës së pandëshkueshmërisë.

#### **III.1 Masat me karakter organizativ:**


Nga 2194 masa të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 1659 prej tyre, pjesërisht 13, në proces 273 dhe nuk janë zbatuar 130 masa, ndërkohë që nuk janë verifikuar nga ana e jonë 119 masa, pra përqindja e realizimit rezulton në masën 75.6%.

Në krahasim me një vit më parë (2011), kemi rritje të konsiderueshme në numrin e masave të rekomanduara, ku nga 1605 masa të rekomanduara në vitin 2011, në vitin 2012 janë rekomanduar 2194 masa, pra 589 rekomandime më shumë (2194-1605); po kështu dhe në nivelin e realizimit të tyre, si në përqindje dhe në numër, më konkretisht në vitin 2012, niveli i realizimit rezultoi 75.6% nga 69% një vit më parë, ose 6.6 pikë përqindje më shumë; ndërsa në numër nga 1093 masa të zbatuara plotësisht në vitin 2011, në vitin 2012 janë zbatuar 1659 rekomandime, ose 566 rekomandime më shumë.

Tendenca e masave organizative të rekomanduara dhe të zbatuara për periudhën 2008-2012, paraqitet përsa vijon:

#### Grafiku Nr. 4:

**Masat organizative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre në vitet 2008-2012**



### **III.2 Masat për shpërblimin e dëmit ekonomik:**

Nga vlera e përgjithshme e dëmit ekonomik prej 13 miliardë e 522 milionë lekë rekomanduar për shpërblimin e dëmit të evidentuar në vitin 2012, *deri në fund të vitit 2012 janë nxjerrë urdhërat përkatës për shpërblimin e dëmit dhe janë në proces arkëtimi rreth 694 milionë lekë, ndërkohë që është në proces arkëtimi i vlerës së dëmit (moslikujdim të detyrimeve kontraktore) prej 9 miliardë e 197 milionë lekë e zbuluar në Albepetrol sh.a., e cila zë rreth 68% të vlerës totale të dëmit.*

*Peshë të konsiderueshme në mosarkëtimin e vlerës së dëmit të shkaktuar ze KESH sh.a me 2 miliardë e 505 milionë lekë, ose në masën 18.5% të totalit të dëmit.*

*Ndërsa METE, nga 607 milionë lekë dëme të zbuluar në fushën e koncesioneve, ka njoftuar se ka përfunduar punën për arkëtimin e shumës prej 218 milionë lekë, ose në masën 36%.*


### **III.3 Masat administrative dhe disiplinore:**

Bazuar në përcaktimet në Ligjin Organik të KLSH, i ndryshuar, në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në “Kodin e punës”, në ligjin për prokurimin publik, për urbanistikën, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, për kontabilitetin etj., për parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të

konstatuara me apo pa dëm ekonomik, KLSH, u ka rekomanduar subjekteve të audituar dhe organeve respektive të emërtesës, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative dhe disiplinore ndaj punonjësve shkaktarë përgjegjës. Krahas këtyre masave, KLSH ka bërë publike rezultatet e auditimeve në mediane dhe shkruar ato elektronike.

Struktura e masave disiplinore dhe administrative të rekomanduara për vitin 2012, sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

Grafiku Nr. 5:



Nga 1221 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 860 prej tyre, ose në masën 70.4%.


Lloji i masave të rekomanduara dhe zbatimi i tyre, sipas njoftimeve zyrtare me shkrim nga organet përkatëse dhe rikontrollit të zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, paraqitet përsa vijon:

Nr.	Lloji i masës	Propozuar gjithsej	Gjendja aktuale e zbatimit		
			Të zbatuara	Pa përgjigje	Përqindja e realizimit
1.	"Vërejtje me shkrim"	354	261	93	73.7
2.	"Vërejtje me paralajmërim"	267	238	29	89.1
3.	"Pezullim ngritje në detyrë"	13	13	-	100
4.	"Kalim në një nivel më të ulët"	74	51	23	68.9
5.	"Largim nga shërbimi civil"	27	5	22	18.5
6.	"Largim nga detyra"	27	16	11	59.2
7.	"Largim nga puna"	121	53	68	43.8
8.	Masa administrative (gjoja)	146	82	64	56.2
9.	Në kompetencë të APP-së	192	141	51	73.4
	<b>Shuma:</b>	<b>1,221</b>	<b>860</b>	<b>361</b>	<b>70.4</b>

Lloji i masave të rekomanduara dhe zbatimi i tyre, paraqitet si më poshtë:

Grafiku Nr. 6:

**Lloji i masave të rekomanduara dhe zbatimi i tyre**



Në bazë të ligjit për KLSH-në dhe marrëveshjes së bashkëpunimit me Departamentin e Administratës Publike për masat e kërkuara dhe llojin e tyre është njoftuar dhe Departamenti i Administratës Publike, Tiranë.

Në krahasim me një vit më parë, numri i masave të rekomanduara është rritur me 501 masa rekomanduese (1221-720). Niveli i realizimit të masave të rekomanduara si nivel përqindjeje ndonëse ka rënie në masën 4% (70.4-74.4), në shumë absolute rezultojn me rritje, përkatësisht 324 masa të realizuara më tepër (860-536).

Nga krahasimi i strukturës së masave disiplinore të rekomanduara gjatë vitit 2012, me ato të vitit 2011, rezultojn se masat e rekomanduara në vitin 2012 janë më të rënduara, natyrisht me të drejtë. Kështu, nga 33 masa “kalim në një nivel më të ulët”, 13 “largim nga shërbimi civil”, 1 “largim nga detyra” dhe 59 “largim nga puna”, të rekomanduara në vitin 2011, gjatë vitit 2012 janë rekomanduar respektivisht: 74 masa “kalim në një nivel më të ulët”, 27 “largim nga shërbimi civil”, 27 “largim nga detyra” dhe 121 “largim nga puna”, pra një rritje me herë. Theksoj përsëri se, ne do të kërkojmë në vijimësi dhe në rrugë ligjore, zbatimin maksimalisht të rekomandimeve tona, veçanërisht zbatimin e rekomandimeve për largimin nga detyra, nga puna dhe nga shërbimi civil, të drejtuesve të mesëm apo të lartë të paafte apo të korrumpuar të njësive publike të audituar.

**III.4 Propozimet për ndryshime apo përmirësime ligjore**

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese në vitin 2012, *KLSH ka përgatitur dhe dërguar në strukturat respektive 58 propozime për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi*, nga 45 propozime raportuar një vit më parë. Nga totali i propozimeve të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 25 prej tyre, pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 14, të pazbatuara 16, kurse 1 propozim nuk është verifikuar.

Ndër propozimet e rekomanduara dhe të zbatuara apo në proces paraqesim:

1. Në **MASH**, propozimin në lidhje me ligjshmërinë e shpërndarjes së fondeve të planifikuara për kompensimin e çmimit të teksteve të arsimit parauniversitar

dhe arsimit universitar në formën e “transfertës tek individët” në disa Drejtori dhe Zyra Arsimore Rajonale (DAR/ZA), ku u rekomanduan përmirësime në udhëzimin e përbashkët të MF dhe MASH, dalë në zbatim të VKM nr. 107 datë 10.02.2010.

**2. Në Qendrën e Publikimeve Zyrtare**, ndërmarrja e iniciativës ligjore nga ana e QPZ dhe MD për rishikimin dhe ndryshimin e VKM nr. 447, datë 17.06.2001 “Për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare” si dhe të urdhërit të përbashkët të MD nr. 8089/1, datë 22.11.2006 me MF nr. 9534/5, datë 26.12.2006 “Për caktimin e çmimeve të botimeve dhe shpërndarjes së konfirmimeve dhe kopjeve të akteve të Qendrës së Publikimeve Zyrtare”.

**3. Në MPÇSSHB dhe në MTKRS**, ndryshimi i VKM nr. 1195, datë 5.08.2008 dhe VKM nr. 1173, datë 6.11.2009.

**4. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve**, janë rekomanduar 3 ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”.

**5. Në Administratën e Presidentit të Republikës**, ndryshimi i VKM nr 158, datë 25.04.2002 “Për një ndryshim në VKM nr. 404, datë 24.10.1991 “Për Trajtimin e Personaliteteve të Larta Shtetërore”, në ndryshimet përkatëse, si dhe për caktimin e dietës ditore të ministrave, zëvendësministrave, dhe personave të tjerë, të barazuar me ta”.

**6. Në Bankën e Shqipërisë**, janë rekomanduar 3 përmirësime në lidhje me aktmarrëveshjen ekzistuese të datës 27.03.2003 midis MF dhe BSH, në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, nga të cilat 2 janë në proces zbatimi dhe 1 është zbatuar.

**7. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor**, rishikimi i VKM nr. 343, datë 21.07.1999 “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor”.

**8. Në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë**, përmirësimi i VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

**9. Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore Tiranë:**

o Ndryshimi i Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

o Ndryshimi i mësipërm në VKM nr. 252, datë 09.02.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 793, datë 24.09.2010.

- Ndryshimi i Ligjit nr. 7703, datë 19.01.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Përmirësimi i Rregullores së Përbashkët të MSH dhe ISSH nr. 494, datë 11.05.1993 “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë”, ndryshuar me Rregulloren nr. 3/1, datë 11.04.2006.
- Përmirësimi i Rregullores nr. 2, datë 02.12.2008 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore”, miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH.

10. Në **MTKRS**, ndryshimi i VKM nr. 315, datë 08.07.1999 “Për një ndryshim në VKM nr. 150, datë 03.04.1993, “Për financimin e projekteve kulturore, artistike të personave fizikë juridike, vendas dhe të huaj”; riformulimi i Udhëzimit të Përbashkët ndërmjet MTKRS dhe MF nr. 5, datë 18.05.2000.

11. Në **MF**, ndryshimi i Ligjit “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013” dhe rishikimin e nenit 58 “Kufijtë e borxhit publik” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2006.

12. Në **Prokurorinë e Përgjithshme**, janë rekomanduar dhe janë në proces zbatimi 5 rekomandime për ndryshim në Ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

13. Në **Ministrinë e Brendshme** është rekomanduar dhe janë në proces zbatimi ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, dhe në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008.

14. Në **Gjykatën e Lartë**, është rekomanduar dhe është në proces zbatimi plotësimi i Ligjit Nr. 8588, dt. 18.08.2000 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës së Lartë” dhe të dispozitave nënligjore në zbatim të tij, me qëllim që të sigurohet rregullueshmëria formale procedurale mbi marrëdhëniet e punës për rregullimin e procedurave të pranimit, emërimit dhe vazhdimësinë e punonjësve të administratës, si dhe mbi mënyrën e pagimit të ndihmësit ligjor, me qëllim që të përcaktohen në mënyrë të qartë se cilat janë kriteret e përcaktimit të fitimit të pagës sipas nivelit të gjykatës respektive. Gjithashtu si rezultat i këtij auditimi është rekomanduar që në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, të hartohet Udhëzimi i Përbashkët me MF, për klasifikimin, administrimin dhe kriteret e përdorimit të të ardhurave që krijohen në Gjykatën e Lartë.

15. Në **Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare**, është rekomanduar dhe është në proces zbatimi rishikimi i Urdhërit të Këshillit të Ministrave nr. 182, datë 25.07.2000 “Për dhënien Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përdorim përkohësisht falas 8 mjedise, zyra nga Pallati i Kongreseve”.

16. Në **Universitetin Gjirokastër**, është rekomanduar dhe është në proces zbatimi përmirësimi nga ana e MASH të Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”.



17. Gjithashtu, vlen të paraqesim rekomandimin “Mbi menaxhimin e borxhit publik”, referuar praktikave të disa vendeve të Eurozonës, paraqitur nga ana e jonë në Kuvend me Raportin “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, ku kemi propozuar që: “Brenda dy viteve në vijim, të ndërmerret nisma për hartimin e një plani veprimi për të *propozuar amendime kushtetuese*, ku të përcaktohet që: “Borxhi total publik nuk duhet të tejkalojë kufirin limit prej 60% të PBB-së”.”

### III.5 *Kallëzimet penale*

Gjatë vitit 2012, për personat përgjegjës (nëpunës të nivelit të lartë, të mesëm dhe ulët drejtues) për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike dhe shtetërore, KLSH ka bërë 40 *kallëzime penale*, dhe konkretisht për:

- 5 persona në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Tiranë, për koncensione), 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët njëri me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe një Drejtor Menaxhimi.
- 9 persona në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët njëri me detyrë Drejtor Drejtorie.
- 7 persona në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, nga të cilët njëri Drejtor Kabineti.
- 4 persona në Komisionin e Prokurimit Publik, Tiranë, përfshirë Kryetarin e këtij Komisioni.
- 4 persona në Zyrën Qendrore të ALUIZNI-it, Tiranë, nga të cilët njëri Drejtor Drejtorie.
- 12 persona në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-it, Durrës.
- 2 persona në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-it, Vlorë, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët njëri Drejtor i Drejtorisë Rajonale.
- 2 persona të Autoritetit të Aviacionit Civil, sh.a. Tiranë, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët njëri Drejtor Ekzekutiv dhe një Zv/Drejtor.
- 1 person në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, sh.a. Tiranë.
- 12 persona në Albpetrol sh.a. Fier, 2 (dy) kallëzime penale, dy drejtues të nivelit të lartë.
- 3 persona në Bashkinë Korçë, nga të cilët njëri Drejtor Drejtorie i Planifikimit të Territorit.
- 8 persona në Bashkinë Pogradec, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët Kryetari i Bashkisë, 2 (dy) Zv/Kryetar, 1 (një) ish Zv/Kryetar dhe Shefi i Kabinetit.
- 10 persona në Bashkinë Sarandë, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët 2 (dy) Drejtor Urbanistike dhe 1 (një) Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.
- 11 persona në Bashkinë Himarë, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët Kryetari i Bashkisë, 1 (një) Drejtor Urbanistike dhe 1 (një) Drejtor i Shërbimeve.
- 3 persona në Bashkinë Orikum, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Urbanistikës.
- 3 persona në Bashkinë Rrëshen, nga të cilët njëri Drejtor i Departamentit Ekonomik.
- 2 persona në Bashkinë Librazhd, nga të cilët njëri Kryetari i Bashkisë.
- 2 persona në Bashkinë Këlcyre, nga të cilët njëri Kryetari i Bashkisë.
- 1 person në Bashkinë Prrenjas, me detyrë ish Kryetari i Bashkisë.
- 3 persona në Komunën Petrelë, Tiranë.


- 3 persona në Komunën Kukur, Gramsh, nga të cilët njëri ish Kryetari i Komunës.
- 1 person në Komunën Qukës, Librazhd, nga të cilët njëri ish Kryetari i Komunës.
- 1 person në Komunën Lenie, Gramsh, nga të cilët njëri ish Kryetari i Komunës.
- 1 person në Portin Detar, sh.a. Vlorë, me detyrë Drejtor i Portit.
- 1 person në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Shkodër, me detyrë Drejtor.
- 5 persona në Ujësjellës Kanalizime, sh.a. Mat, nga të cilët njëri me detyrë Drejtor.
- 3 persona në Ndërmarrjen e Trajtimit të Studentëve nr. 1, sh.a., Tiranë, anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.
- 3 persona në Projektin “Rehabilitimi i Spitalit të Shkodrës faza-III”, MSH, 2 (dy) kallëzime penale, nga të cilët njëri me detyrë Drejtor Projekti.
- 2 persona në ZVRPP, Fier, nga të cilët njëri me detyrë Regjistrues.
- 1 person në ZVRPP, Lushnjë, me detyrë ish Regjistrues.

Nga ndjekja e ecurisë së kallëzimeve penale rezulton se, nga *40 kallëzime, 36 janë në proces hetimi.*

Krahasuar me një vit më parë ku janë bërë gjithsej 6 kallëzime për 13 persona dhe vlerë dëmi 367,657 mijë lekë, në vitin 2012 janë bërë 40 kallëzime për 125 persona dhe vlerë dëmi 1,366,689 mijë lekë.

Numri i kallëzimeve penale bërë në vitin 2012, është 2 herë më i madh se ai i 3 (tre) viteve të fundit (2009-2011) të marra së bashku.

Grafiku Nr. 7:



Kontrolli i Lartë i Shtetit, kallëzimet i ka kryer në zbatim të nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kryesisht kanë konsistuar në shkelje të neneve 248 dhe 258 të Kodit Penal dhe që kanë të bëjnë me rastet e shpërdorimit të detyrës dhe shkeljes së barazisë të pjesëmarrësve në tendera dhe ankande publike.

Në lidhje me këto kallëzime Kontrolli i Lartë i Shtetit referuar neneve 241 dhe 242 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar që deri në fazën e përfundimit të

hetimeve për këta persona të merret masa e pezullimit të ushtrimit të detyrës në funksionet publike, pasi në këto kushte hetimi i këtyre çështjeve nga ana e Prokurorisë do të ishte më i plotë dhe do shmangte mundësinë e fshehjes, prishjes, manipulimit apo zhdukjes së provave.

Ndëshkimi i shpejtë dhe pa kompromis i rasteve të tilla të abuzimit me detyrën, do të rriste forcën parandaluese në luftën kundër korrupsionit.

#### **IV. CILËSIA NË AUDITIM**

Gjatë vitit 2012, veprimtaria audituese është përqendruar në realizimin e auditimeve me tema të parashikuara në programin e veprimtarisë vjetore të institucionit, por krahas tyre, janë ushtruar auditime dhe në disa institucione, bazuar apo duke shfrytëzuar artikujt e botuar në shtypin e përditshëm ose problemet e ngritura dhe trajtuara në median elektronike, si dhe nga letrat apo kërkesat e shumta të adresuar KLSH-së nga shtetas të ndryshëm. Përgjithësisht ne ushtrojmë detyrën tonë si institucion auditimi dhe jo inspektimi.

Lidhur me tematikën e auditimeve, ato janë hartuar pas grumbullimit dhe shqyrtimit të të gjitha të dhënave dhe informacioneve për njësitë objekt auditimi, duke patur parasysh dhe kërkesat e përcaktuara në aktet e miratuara nga Kryetari i institucionit, dhe më konkretisht: - në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH, në standardet dhe dokumentet standarde të auditimit etj.

Përsa i përket programimit të detyrave të auditimit, si hapi i parë dhe i rëndësishëm në procesin e auditimit, ato janë hartuar dhe zhvilluar subjekt për subjekt, nga vetë audituesit e grupit të auditimit me përgjegjësin e grupit, dhe më pas i janë nënshtruar gjykimit të Kryeaudituesit dhe Drejtorit të Departamentit, si dhe Drejtorit të Përgjithshëm. I gjithë ky proces është karakterizuar nga kërkesa të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe në standardet e auditimit, si:

- Njohja paraprake e natyrës së subjektit që i nënshtrohet auditimit (mbledhja dhe analiza e fakteve dhe e të dhënave të mjaftueshme për të arritur konkluzione të besueshme dhe të vlefshme);
- Njohja me legjislacionin mbi të cilin operon dhe realizon veprimtarinë subjekti;
- Përcaktimi i saktë në program i drejtimeve dhe çështjeve kryesore që mbulon procesi i auditimit;
- Vlerësimi i riskut dhe materialitetit, etj.

#### ***• Sigurimi i cilësisë në procesin auditues 2012***

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese, që konfirmon faktin se institucioni në procesin auditues zbaton standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të auditimit. Pikërisht për këto arsye, sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi objektiv kryesor i veprimtarisë së KLSH.

Bazuar në standardet kombëtare e ndërkombëtare, sigurimi i cilësisë është konsideruar kërkesë e domosdoshme për të identifikuar dhe analizuar objektivisht mangësitë, si dhe përcaktuar masat efektive që duhen marrë për

përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese, e cila t'i shërbejë ligjvënësit, ekzekutivit dhe publikut për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të fondeve publike dhe pronës.

Sigurimit të cilësisë të auditimit, i ka shërbyer dhe përcaktimi i detyrës në Rregulloren e re të Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH, për kryerjen e takimeve të mirëkuptimit me nivelet drejtuese të njësive të auditimit, sidomos të takimit përmbyllës ballafaques dhe të mirëkuptimit në zyrat e KLSH, pas dërgimit të projektraportit të auditimit dhe marrjes së observacioneve nga njësitë e audituara. Veçanërisht i rëndësishëm ky ballafaqim është për ato auditime në të cilët ne konkludojmë që ka elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Për kryerjen e auditimeve të cilësisë më të lartë të mundshme, KLSH ka si qëllim të përgjithshëm pasjen e një sistemi të menaxhimit të plotë të cilësisë, i cili të mbulojë të gjithë sferën e veprimtarisë së tij.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, si koncept i përgjithshëm përfshin:

- A. Menaxhimin e Cilësisë në nivel institucional;
- B. Sistemin dhe procedurat e Kontrollit të Cilësisë (shqyrtime të “nxehta”);
- C. Procesin e Sigurimit të Cilësisë (shqyrtime të “ftohta”).

Niveli i ndjekjes dhe zbatimit nga hallkat përkatëse të institucionit të elementeve të mësipërm përbërës, ka patur një ndikim të rëndësishëm në nivelin e realizuar në fakt të cilësisë të punës audituese, në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të KLSH-së dhe standardeve përkatëse.

#### **IV.A Menaxhimi i Cilësisë në nivel institucional**

Duke patur parasysh elementët përbërës kryesorë të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional (politika dhe strategjia e cilësisë, përkushtimi i drejtuesve, metodologjia, mbështetja me IT, menaxhimi i burimeve njerëzore, marrëdhëniet jashtëinstitucionale, etj.), i kemi kushtuar vëmendje këtyre elementëve, duke i vlerësuar si një proces i rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së punës audituese. Sidoqoftë, ekziston vazhdimisht nevoja për përpjekje më të mëdha në këtë drejtim dhe përsosjen e politikave, objektivave dhe instrumentave zbatues. Më konkretisht:

##### ***IV.A.1 Krijimi i një mjedisi pune favorizues për profesionalizmin.***

Sigurimit të cilësisë së punës audituese i është paraprirë me masa efektive konkrete tekniko-organizative, të cilat janë në përputhje me një nga Standardet e Përgjithshme të INTOSAI-t, ku i kërkohet Institucioneve Supreme të Auditimit të përgatisin manuale dhe udhëzime, si dhe rregullore të tjera për drejtimin e auditimit. Pikërisht, në zbatim të këtyre kërkesave janë krijuar dhe vënë në punë politika, sisteme e instrumenta të përshtatshme, të reflektuara këto në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH e shoqëruar edhe me dokumentet e formularët standarde (miratuar me vendim të Kryetarit nr. 53, datë 16.04.2012), manualët e auditimit financiar e atij të performancës dhe në urdhëra e udhëzime të veçanta të nxjerra nga Kryetari i

institucionit, në të cilat pasqyrohen aspektet procedurale që ndiqen gjatë programimit, ushtrimit dhe raportimit të rezultateve të auditimit, në përputhje dhe në zbatim të të drejtave e detyrimeve Kushtetuese dhe Ligjit Organik të KLSH.

#### **IV.A.2 Menaxhimi i burimeve njerëzore**

Duke vlerësuar e konsideruar si faktor të rëndësishëm menaxhimin e drejtë dhe racional të burimeve njerëzore për sigurimin e cilësisë së punës audituese, si dhe duke patur parasysh faktin që politikat për burimet njerëzore, duhet të mbështesin mbajtjen dhe zhvillimin e një stafi të kualifikuar dhe kompetent, të aftë për të zbatuar planet e auditimit në mënyrë sa më të efektshme, nga ana e institucionit për vitin 2012 u ndoqën politika jo vetëm korrekte, por edhe efektive në drejtim të rekrutimit të personelit me kualifikim arsimor të duhur e në përgjithësi me eksperiencë, për kryerjen me cilësi e kompetencë të detyrës audituese. Mangësitë e vrejtura në vitet 2008-2011, ku rekrutimi i shumë punonjësve bëhej me kontrata të përkohëshme, të cilët nga testimi profesional rezultuan me vlerësime të dobëta, konfirmon faktin se rekrutimi jo mbi baza transparente dhe konkurrence ofron staf me cilësi të dobët, gjë e cila dëmton imazhin, besueshmërinë dhe efektivitetin e punës së institucionit. Ky fakt dhe mangësi të tjera në punën me stafin punonjës të institucionit, pasqyrohen dhe në Raportin Përfundimtar për Mbikëqyrjen e Menaxhimit të Shërbimit Civil në KLSH, të përgatitur nga Komisioni i Shërbimit Civil në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në KLSH për periudhën 2009-2011 (dërguar me shkresën e KSHC nr. 381/1, datë 13.07.2012)..

Duke reflektuar ndaj të metave e mangësive të trajtuara në raport, njëherazi me hartimin e programit të punës për përmirësimin e gjendjes, përcaktuam procedurat që duhen ndjekur për plotësimin e vendeve të lira, duke filluar me shpalljen rregullisht të tyre në media sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe vijuar me realizimin e rekrutimit nëpërmjet konkurimit me anë të testimit të njohurive dhe përzgjedhjes mbi kritere objektive.

Gjatë vitit 2012, janë rekrutuar gjithsej 36 punonjës prej të cilëve 25 nëpërmjet 11 konkurseve të zhvilluara sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”. Për t’u theksuar se, gjatë këtij viti është rekrutuar dhe staf me kualifikime të larta dhe grada shkencore, përkatësisht 5 punonjës me gradë shkencore, 1 prej të cilëve me titullin Profesor i Asociuar dhe 4 Doktor Shkencash që përbëjnë 3.2% të totalit të stafit.

Testimit i janë nënshtruar edhe të gjithë audituesit në KLSH.

Faktor i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së punës audituese është zhvillimi i pandërprerë i trajnimeve të stafit me përvojat e praktikat bashkëkohore të auditimit. Në krahasim me vitet e kaluara, ky faktor është vlerësuar maksimalisht si nevojë e domosdoshme dhe emergjente, për të cilën janë vënë objektiva të qarta për vitin 2012, duke arritur në 19.4 ditë trajnime në vit për punonjës, nga 2.1 të realizuar një vit më parë.

Për vitin 2012, për punonjësit e porsa rekrutuar në KLSH u vu detyra që secili prej tyre të kryejë mbi 25 ditë trajnimi në vit. Për këtë u realizuan trajnime të

veçanta me tema të ndryshme, që kishin të bënin me njohjen e veprimtarisë së institucionit dhe standardeve nderkombëtare; aktet administrative; rregullimin e marrëdhënieve të punës; komunikimin e brendshëm në KLSH; të drejtën kushtetuese; standardet e INTOSAI-t; njohjen me auditimin financiar dhe të performances; fazat e auditimit, analizën e riskut dhe materialitetit etj.

Kujdes është treguar për zhvillimin e karrierës brenda institucionit, duke e vlerësuar si faktor të rëndësishëm që i shërben drejtimit më të mirë dhe rritjes së cilësisë së punës audituese. Këtë vit, në krahasim me vitet e tjera, zhvillimi profesional dhe përparimi në karrierë u realizua nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimit të njohurive nga formimi profesional dhe konkurimit transparent (po aq i rëndësishëm sa procesi i rekrutimit) për pozicionet më të larta të punës që pretendohej. Nëpërmjet testeve të kryera gjatë vitit 2012, janë larguar 3 Kryauditues dhe janë zëvendësuar me të rinj, gjithashtu janë ngritur në kategori nga auditues të kategorisë së parë, në auditues të lartë 2 punonjës, ndërkohë që një numër ish audituesish të lartë kanë mbrojtur këtë kategorizim gjithmonë nëpërmjet testimit dhe vetëm testimit profesional.

#### **IV.A.3 *Menaxhimi i rrezikut institucional.***

Edhe KLSH në përmbushjen e veprimtarisë dhe objektivave të saj të vitit 2012, është përballur me disa rreziqe. Gjatë programimit vjetor të veprimtarisë audituese, jemi ndodhur në një situatë ku nevojat për auditime që duhet të kryejmë tejkalojnë mundësitë tona, më konkretisht: burimet njerëzore, materiale dhe financiare në dispozicion kanë qenë të pamjaftueshme. Duke marrë në konsideratë këtë fakt dhe për të arritur një nivel sa më të lartë të sigurimit të cilësisë, i është kushtuar rëndësi shfrytëzimit racional të burimeve në dispozicion, duke programuar dhe kryer auditime në subjekte të prioritetit më të lartë.

Në kontekstin e menaxhimit të riskut, në vitin 2012, Kryetari i KLSH me shkresën nr.102/1, datë 14.5.2012, ka formalizuar dhe dokumentuar procedurën për menaxhimin e riskut në KLSH, të konkretizuar në “Strategjinë e menaxhimit të riskut”, strategji e cila përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të institucionit, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Në këtë dokumentim, risku është matur dhe paraqitur sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Nga KLSH në drejtim të aktiviteteve të auditimit, të cilat përfaqësojnë politikën dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për të arritur objektivat e institucionit, ekzistojnë procedura të punës të shkruara, për proceset kryesore operacionale dhe financiare, përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme të vendosura.

#### **IV.A.4 *Komunikimi dhe marrëdhëniet me të tretët.***

Vëmendje e duhur i është kushtuar vendosjes, ruajtjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve efektive me të tretët, si element i rëndësishëm i sistemit të

menaxhimit të cilësisë. Në zbatim të Udhëzuesit mbi Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë dhe në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale, KLSH, ka vendosur dhe mbajtur marrëdhënie shumë të mira dhe korrekte me Kuvendin dhe Komisionet e tij.

- Për stafin drejtues dhe auditues të KLSH-së për vitin 2012, inkurajuese, por në të njëjtën kohë detyrim e përgjegjësi për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të punës kontrolluese, kanë qenë konkluzionet e shprehura në **Rezolutën e Kuvendit** datë 26.04.2012, për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011.

- Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për të rritur një shkallë më të lartë luftën kundër korrupsionit, të rëndësishme kanë qenë marrëveshjet e bashkëpunimit me: Institutin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (mars 2012), Autoritetin e Konkurrencës (mars 2012), Ministrinë e Financave (maj 2012), Agjensinë e Prokurimit Publik (dhjetor 2012), Departamentin e Administratës Publike (dhjetor 2012), Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA, dhjetor 2012), Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit (dhjetor 2012) dhe Institutit “G&G Group” (dhjetor 2012).

Duke qenë se KLSH është në proces reformimi, këto marrëveshje janë të rëndësishme për institucionin, sepse mundësojnë bashkëpunimin me partnerë profesional që do ta ndihmojnë për t'u orientuar më mirë në sfidat e ardhshme, siç janë modernizimi i institucionit, si dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij.

Duke vlerësuar nivelin jo të kënaqëshëm të marrëdhënieve me organin e akuzës, ku dhe numri i kallëzimeve penale nga KLSH në vitin 2011 kishte një rënie të dukshme (vetëm 6 kallëzime), me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në respektim të pavarësisë së institucioneve, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit (qershor 2012), e cila pati ndikim tepër pozitiv. Rivitalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit KLSH-Prokurori, vëmëndja dhe mbështetja e Prokurorit të ri, kanë bërë të mundur që krahas bashkëpunimit të afërt dhe sistematik dhe kallëzimet tona në vitin 2012 të vlerësohen maksimalisht nga ana e Prokurorisë.

- Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me të tretët kanë qenë edhe marrëveshjet e lidhura në muajin prill 2012 me shoqërinë civile, me organizata jo fitimprurëse më të spikatura në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës, siç janë: Lëvizja Alternative Civile, Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë, Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Transparency Internacional në Shqipëri dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri. Marrëveshjet u lidhën në zbatim të parimeve e orientimeve të përcaktuara në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t, se eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve dhe synojnë kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH-së dhe shoqatave, si vrojtme, prognoza dhe studime të përbashkëta, pjesmarrje reciproke në seminare, simpoziume, konferenca, në luftën kundër korrupsionit, mundësisht parandalimin e tij, luftë e cila mund të ketë sukses vetëm me punë të përbashkët në sistem, si dhe rritjen e transparencës së institucioneve publike.

- Në drejtim të përmirësimit të standardeve të auditimit me moton e INTOSAI-t “Experientia mutual omnibus prodest” - eksperiencia e përbashkët i shërben të

gjithëve, në krahasim me vitet e kaluara ju dha përparësi e veçantë intensifikimit të marrëdhënieve me INTOSAI-n, EUROSAI-n, Gjykatën Europiane të Audituesve, SIGMA-n, si dhe me institucionet homologe të auditimit të jashtëm me eksperiencë, për shkëmbimin e njohurive dhe përvojës rreth praktikave më të mira të auditimit, sidomos në auditimet financiare e të performancës. Marrëveshjet e lidhura me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, Gjykatën e Llogarive të Turqisë, SAI-t e Polonisë dhe Kroacisë, si dhe me Zyrën e Auditorit të Përgjithëshëm të Kosovës, shërbyen për shkëmbimin e eksperiencës dhe njëkohësisht edhe për trajnimin e një numri të konsiderueshëm të audituesve tanë, në veçanti për auditimet financiare dhe të performancës.

- Në një shkallë më të lartë u ngritën marrëdhëniet e bashkëpunimit të KLSH me median dhe publikun, gjë që reflektohet në paraqitjen transparente të raporteve e rekomandimeve, si dhe në ndjekjen e trajtimin korrekt të ankesave e kërkesave të publikut. Tregues i rëndësishëm që flet për transparencën është edhe fakti se analizat periodike të veprimtarisë së institucionit u bënë të hapura në prani të medias së shkruar e asaj vizive.

Një falenderim i veçantë për të gjithë mediat që na kanë inkurajuar, duke na mbështetur, pse jo dhe ato që na kanë kritikuar.

Gjatë vitit 2012, u përpoqëm të intensifikojmë marrëdhënien me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Në çdo analizë të institucionit apo për probleme të tjera, deputetëve anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave u është dërguar ftesë e veçantë për pjesëmarrje dhe për të dhënë orientimet e tyre, të cilat përbëjnë detyra për KLSH-në.

#### **IV.A.5 Planifikimi strategjik**

Duke vlerësuar planifikimin strategjik afatgjatë e afatmesëm, për të realizuar auditimet e duhura dhe në kohën e duhur, me objektiv sigurimin e një niveli sa më të lartë të cilësisë së punës audituese, u tregua kujdes në hartimin dhe zbatimin e programit të veprimtarisë për vitin 2012, ku u ndërthur eksperiencia audituese e arritur në vite me njohuritë e fituara nga trajnimi në kuadër të Projektit të Binjakzimit me NAO-n e Britanisë së Madhe dhe Gjykatën e Llogarisë të Mbretërisë së Hollandës. Kështu, në programin e veprimtarisë së vitit 2012, nga 153 auditime gjithsej të programuara, krahas auditimeve të ligjshmerisë e rregullshmerisë, vlerësues e tematik, u programuan 16 auditime financiare dhe 2 auditime pilot për certifikim të llogarive sipas praktikave të NAO-s së Britanisë së Madhe dhe 7 auditime të performancës sipas praktikave të Gjykatës së Llogarive të Mbretërisë së Holandës. Në programin e veprimtarisë të vitit 2012, në krahasim me vitin 2011, bazuar në objektivat e përcaktuara në platformën e paraqitur nga Kryetari i KLSH në Kuvend, ju kushtua vëmendje e veçantë forcimit të auditimeve financiare dhe kthimit të vëmendjes drejt auditimeve të performances. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe krijimi i 2 (dy) departamenteve të reja, Departamenti i Auditimit të Performancës dhe Departamenti i Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit.

#### **IV.A.6 Mësimi nga përvoja.**

Vëmendje e veçantë në drejtim të funksionimit më të mirë të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, i është kushtuar mësimi nga përvoja (arritjet e



dobësitë) e dalë kjo nga konkluzionet e shqyrtimeve të cilësisë dhe rekomandimeve të paraqitura.

Konkluzionet, konstatimet (mosrespektimi i afateve të auditimit, mangësitë në dorëzimin e aktverifikimeve dhe procesverbaleve, mangësitë në trajtimin dhe shqyrtimin e observacioneve të njëjësive të audituar etj.) dhe rekomandimet e paraqitura në raportin e sigurimit të cilësisë për vitin 2011, i cili u përgatit në muajin shkurt të këtij viti; u vlerësuan objektivisht, duke u bërë objekt i analizave të departamenteve të auditimit, në mënyrë që të reflektohet ndaj tyre dhe të merreshin masa efektive e të qëndrueshme për përmirësimin e punës në të ardhmen, në zbatim të rregullave të brendshme dhe manualeve të miratuara.

Për auditimet e vitit 2012, Grupi i kontrollit për sigurimin e cilësisë përfundoi punën në muajin shkurt 2013 dhe paraqiti për shqyrtim raportin përkatës.

#### **IV.A.7 Mbështetja me IT.**

Element i rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, është konsideruar mbështetja dhe shfrytëzimi i përparësive të kompjuterizimit në procesin auditues. Për këtë qëllim, krahas punës për mbajtjen në eficiencë të rrjetit kompjuterik, këtë vit u morrën masa konkrete për rinovimin e paisjeve kompjuterike me parametrat e teknologjisë bashkëkohore. Duke vlerësuar faktin se auditimi kërkon aftësi speciale, kur subjektet që do të auditohen veprojnë në një mjedis të kompjuterizuar, është kërkuar që audituesit të fitojnë vazhdimisht njohuri të reja mbi sistemet e përdorura nga subjektet e audituara dhe pikërisht për këtë qëllim janë programuar e realizuar trajnime të posaçme për të fituar e zhvilluar këto aftësi, siç janë trajnimet për njohjen me teknologjinë e informacionit (Office 2003 dhe 2007, përdorim i antivirusit, përdorim gjerësisht i Intranetit) dhe programi IDEA.

Megjithë sa sipër, përsëri nuk jemi të kënaqur, na mbetet shumë për të bërë.

#### **IV.A.8 Sigurimi i bazës ligjore.**

Në vijim të sistemit të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional, për arritjen e një niveli sa më të lartë të cilësisë së punës audituese, rëndësi i është kushtuar njohjes dhe përditësimit të vazhdueshëm të audituesve me dispozitat ligjore e nënligjore, si kusht i domosdoshëm për njohjen e vlerësimit e veprimtarisë së subjekteve të audituara, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësisë dhe rekomandimeve përkatëse. Për këtë qëllim, krahas sigurimit të legjislacionit nëpërmjet fletoreve zyrtare, shfrytëzimit të internetit, ndihmës juridike të dhënë dhe përditësimit të vazhdueshëm të paketës me dispozitat ligjore e nënligjore më kryesore nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, me kontrollin e zbatimit të të cilave ndeshen audituesit në veprimtarinë e përditëshme, këtë vit në rrjetin kompjuterik u instalua programi elektronik "ALBA-LEX" që ofron baza të dhënash të përditësuara të akteve ligjore e nënligjore.

#### **IV.B Sistemi dhe procedurat e Kontrollit të Cilësisë (shqyrtime të "nxehhta")**

Për arritjen e një niveli të lartë të cilësisë së punës audituese, KLSH ka vendosur politika, sisteme dhe procedura që inkurajojnë veprime, të cilat çojnë

në një cilësi të lartë auditimi dhe parandalojnë veprimet që mund të çenojnë cilësinë.

Vendosja dhe përsosja në vazhdimësi e **Sistemit të Kontrollit të Cilësisë (shqyrtimet e “nxehta”)** ka influencuar ndjeshëm në sigurimin e cilësisë së raporteve të auditimit, duke arritur përmirësime dhe siguruar praktika më të mira në punën audituese, dhënien e konkluzioneve profesionale e të argumentuara me provat e nevojshme dhe në përfundim me gjykime e vendime objektive. Kontrolli i cilësisë brenda këtij konteksti i referohet kërkesave të zbatuara në menaxhimin e përditshëm të detyrave individuale të caktuara gjatë auditimit, që lidhen me planifikimin, punën në terren, raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Këtij qëllimi i ka shërbyer përcaktimi në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së (miratuar në prill 2012), të detyrave e përgjegjësive të hallkave përkatëse, në të cilat kalojnë për shqyrtim, vlerësim e mendim materialet e auditimit, duke filluar nga audituesit, përgjegjësit e grupeve, kryeaudituesit, drejtorët e departamenteve të auditimit, Drejtoria Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtorët e Përgjithshëm, përpara se të merret vendimi përkatës nga Kryetari për miratimin e raportit dhe rekomandimeve përkatëse për subjektin e audituar.

E gjithë kjo procedurë është e dokumentuar në të gjitha fazat e auditimit dhe është pjesë përbërëse e dokumenteve të auditimit në dosjen përkatëse.

#### **IV.C Proçesi i Sigurimit të Cilësisë (shqyrtime të “ftohta”)**

Kjo procedurë e kryer nga struktura e veçantë brenda institucionit e ngritur për këtë qëllim, pas evadimit e arkivimit të dosjeve të auditimeve, që realizohet në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI, ISSAI 1220, rekomandimeve të SIGMA-s, urdhërave të brendshme, Rregullores së Brendshme të Organizimit e Funksionimit të KLSH-së, ka shqyrtuar realizimin e sigurimit të cilësisë të një numri të caktuar të auditimeve, për të verifikuar në se ato politika, strategji e rregulla të përcaktuara në rregulloren e brendshme e manualët e auditimit, janë zbatuar me rigorozitet në të gjitha fazat që kanë të bëjnë me programimin, zbatimin dhe raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të punës audituese.

Puna për shqyrtimin e auditimeve për sigurimin e cilësisë, është bërë sipas urdhërit të brendshëm të Kryetarit të KLSH nr. 112, datë 21/12/2012, bazuar në kërkesat e formularit tip të miratuar për këtë qëllim.

Për sigurimin e cilësisë për vitin 2012, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme 25 dosje auditimi rreth 16% e auditimeve të kryera gjatë këtij viti (të evaduara dhe të arkivuara) nga të gjithë departamentet e auditimit, nga 16 dosje auditimi të shqyrtuara në vitin 2011, ose 9 dosje auditimi më shumë.

Edhe këtë vit, sipas urdhërit të lartpërmendur u angazhuan grup audituesish nga çdo departament, nën mbikqyrjen e specialistëve përkatës të Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, ku sejcili nga specialistët e grupit shqyrtoi dosje që nuk i përkitnin departamentit të tyre, në mënyrë që të jepej një opinion sa më i pavarur dhe objektiv. E veçantë për këtë vit është së përzgjedhja e dosjeve për shqyrtim u bë nga vetë grupet e ngarkuara.

Referuar konstatimeve të dala nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit, të cilat paraprakisht janë diskutuar me përgjegjësit e grupeve dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, rezulton se krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura në drejtim të sigurimit të cilësisë, në procesin e programimit, zbatimit, raportimit të përfundimeve të auditimeve dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, u konstatuan edhe disa të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe manualët e auditimit, ndaj të cilave kërkohet të reflektohet me masa konkrete tekniko-administrative të qëndrueshme, pasi influencojnë në arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e KLSH-së.

• **Në mënyrë të përmbledhur paraqesim konstatime nga shqyrtimi në të ftohtë i dosjeve:**

1. Jo në të gjitha rastet është bërë mbledhja e informacionit paraprak nga grupi i auditimit për njësinë objekt auditimi, po kështu dhe analiza e fakteve ose e të dhënave të mjaftueshme, me qëllim arritjen e konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme rreth njësisë për hartimin e programit të auditimit, për rrjedhojë programet e auditimit janë të ngjashme dhe të pa thelluara në veprimtarinë dhe specifikat e njësisë, gjë që ka sjellë shpesh përfshirjen e pikave pa rrisht në programin e auditimit.

Në 15 nga 20 dosje të shqyrtuara, rezulton se kjo kërkesë nuk është zbatuar.

2. Menaxhimi racional kërkon që planifikimi i burimeve njerëzore të vlerësohet në mënyrë të atillë që në auditim krahas numrit të përshtatshëm të audituesve të caktohet edhe stafi me aftësitë dhe eksperiencën e duhur, në mënyrë që cilësia e aftësive të grupit t'i përgjigjet kompleksitetit të auditimit. Nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se planifikimi i burimeve nuk është bërë sipas faktoreve të përcaktuar, pasi jo të gjithë anëtarët e grupit të auditimit janë me eksperiencë në fushën që auditohet, si dhe ka raste të shtimit apo pakësimit të anëtarëve të grupit pas hartimit të programit të auditimit, ndryshime këto të pa argumentuara dhe të dokumentuara, kërkesë kjo e parashikuar në Rregulloren e Brendshme dhe dokumentet standarde.

Në 5 auditime nga 20 të shqyrtuara, këto kërkesa nuk janë vlerësuar me kujdesin e duhur.

3. Nuk është përfshirë në të gjitha programet e auditimit pika: “Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit”, drejtim kyç për vlerësimin e riskut dhe menaxhimit, kërkesë kjo e parashikuar në ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Gjithashtu, nuk rezulton të jetë bërë vlerësimi i punës së auditimit të brendshëm, në çfarë shkalle duhet dhe mund të përdoren rezultatet e tij në punën e grupit të auditimit, gjë që parashikohet si në standardet ndërkombëtare ashtu dhe në standardet e auditimit të KLSH.

Kjo mangësi u konstatua në 4 (katër) auditime.

4. Konstatohen raste të ndryshimeve të programit të auditimit, pa kërkesë dhe argumentim, gjë që ka ardhur si pasojë e mosnjohjes së mirë të subjektit që auditohet dhe mosnjohjen me problematikat e auditimeve të mëparshme. Kjo mangësi u konstatua në 3 (tre) auditime.

5. Mangësi në praktikën e punës lidhur me dorëzimin e procesverbaleve dhe aktverifikimeve në zyrat e protokollit të subjekteve. Mënyra e mbajtjes dhe e dorëzimit të aktverifikimeve dhe procesverbaleve në rrugë protokollare dhe jo t'i dorëzohen në dorë personave me të cilët mbahet, përfshirë ata të larguar. Për më keq, në disa raste nuk dokumentohet që personat e larguar nga puna janë njohur me shkeljet e konstatuara.

Si rezultat i kësaj praktike, në dosjet e auditimit në përgjithësi këto dokumente arkivohen vetëm me shënimet e numrave të protokollit dhe firmat e audituesve dhe pa firmat e personave të atakuar, të cilët jo të gjithë bëjnë observacione. Në disa raste nuk ka një konfirmim nga zyrat e protokollit për dorëzimin e këtyre dokumenteve ose vënien në dijeni të personave përkatës, për të shmangur ndonjë pretendim për mosmarrje dijeni për përmbajtjen e këtyre dokumenteve dhe shmangie ndaj përgjegjësisë të personave të atakuar.

Kjo mangësi u konstatua në 2 (dy) auditime.

6. Në disa raste në dosjet e shqyrtuara, në Raportet Përfundimtare të Auditimit nuk jepen sqarimet e plota për observacionet e bëra për Projektraportin, ku duhet të përshkruhet shkurt thelbi dhe përmbajtja e observacionit dhe argumentimi me dispozita ligjore kur nuk merret në konsideratë, e që për observacionet e pabazuara të mos përdoret thjesht shprehja “nuk qëndron observacioni...”. gjë që do të përforconte konkluzionin e audituesve për shkeljet e konstatuara dhe do të rriste sigurinë e besueshmerinë e konkluzioneve e rekomandimeve të auditimit.

Kjo mangësi kjo e konstatuar në 3 (tre) auditime.

7. Të meta dhe mangësi janë vërejtur në trajtimin më të plotë të pikave të programit të auditimit, ku mungojnë gjetjet dhe konkluzionet. Projektraportet e Auditimit dhe për më tepër Raportet Përfundimtare nuk janë në përputhje me Rregulloren e Brendshme. Raportet janë shumë të gjata dhe janë pasqyrim (kopje) thjesht i procesverbaleve dhe aktverifikimeve të mbajtura.

Kjo mangësi që u konstatua në 4 (katër) auditime.

8. Mosvlerësimi në shkallën e duhur në disa raste nga grupet e auditimit dhe drejtuesit e departamentit të kërkesave të përcaktuara në nenin 16, paragrafi 3 të ligjit organik të KLSH-s dhe Rregullores së Brendshme, për rastet e konstatimit të shkeljeve dhe përcaktimit të masës së zhdëmtimit dhe të përgjegjësisë të personave përkatës. Madje, në projektvendim, megjithëse shkeljet e konstatuara janë shkelje të rënda ligjore, për to nuk është propozuar masë disiplinore për të gjithë personat e ngarkuar me përgjegjësi, duke rekomanduar masa organizative të cilat janë detyra funksionale të subjektit. Mangësi këto të konstatuara në 4 (katër) auditime.

Për përmirësimin e punës në të ardhmen do të marrim këto masa:

1. Krahas analizimit të materialit në departamente auditimi dhe në nivel institucioni, kemi shtruar detyrën që kontrolli për sigurimin e cilësisë të mos përqëndrohet në një numër të kufizuar dosjesh auditimi dhe vetëm në fund të vitit, *por të jetë një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit për dosjet e evaduar dhe të arkivuara*, ku të shqyrtohen sa më shumë dosje, duke marrë në konsideratë edhe auditimet që kanë të bëjnë me zbatimin e rekomandimeve të auditimit, pasi nëpërmjet këtyre verifikohet drejtësia e konkluzioneve dhe rekomandimeve të auditimit, tregues këto të cilësisë dhe efektivitetit të punës audituese.

Një praktikë të tillë filluam ta aplikojmë gjatë vitit 2012, por këtë vit do të shtrihet në një numër më të madh auditimesh, proces të cilin e favorizon edhe miratimi i Rregullores së re. Për këtë qëllim, krahas fuqizimit të strukturës së kontrollit të sigurimit të cilësisë me specialistë të emëruar në këtë funksion apo duke aktivizuar rast pas rasti auditues nga departamentet e auditimit, *do të punohet edhe për hartimin e manualit përkatës për këtë qëllim*.

2. Me qëllim përmirësimin e paraqitjes sa më cilësore të materialeve të auditimit dhe evitimit të problematikave të hasura gjatë zbatimit të saj, *do të rishikohet të përmirësohet Rregullorja e Brendshme si dhe të plotësohen formularët standarde*. Gjithashtu, në zbatim të Rregullores së Brendshme dhe në funksion të grupeve të auditimit dhe përmirësimin të cilësisë, *do të vendosim dhe një jurist permanent në Departamentet e Auditimit*, i cili duhet të japë mendimin e tij paraprak në lidhje me auditimin krahas Kryeaudituesit dhe Drejtorit të Departamentit.

## **V. BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMET**

### **V.1 Burimet njerëzore**

Impakti i drejtpërdrejtë dhe rëndësia e madhe në cilësinë e veprimtarisë audituese, e ka shndërruar zhvillimin e burimeve njerëzore të institucionit, në një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH. Rëndësia e zhvillimit të Burimeve Njerëzore është vlerësuar shumë edhe nga INTOSAI dhe EUROSAI, të cilët në planin e tyre të zhvillimit strategjik, e kanë vendosur ndërtimin e kapaciteteve si pikën e parë të katër pikave kryesore të këtij plani dhe konkretisht :

*“ Ndërtimi i kapaciteteve të SAI-it nënkupton zhvillimin e aftësive, njohurive, strukturave dhe formave të organizimit të punës për të bërë një organizatë më efektive, duke u bazuar në pikat e forta ekzistuese dhe trajtimin e mangësive dhe dobësive. EUROSAI është i angazhuar për të lehtësuar zhvillimin e SAI, që të jenë të forta, të pavarura dhe shumë profesionale...”*

Për vitin 2012, me anë të Vendimit nr. 45, datë 30.03.2012 të Kryetarit të KLSH është miratuar struktura organike me një total prej 156 punonjësish, njëlloj si një vit më parë. Sipas organikës së miratuar, gjatë vitit 2012, KLSH ka ushtruar aktivitetin nëpërmjet 6 departamenteve prej të cilëve 5 auditimi si dhe 5 drejtorive mbështetëse. Në raport me vitin 2011, konstatohet përpjekja për të bërë një shpërndarje më të mirë të burimeve njerëzore, bazuar në objektin e punës audituese të institucionit teksa është shtuar një departament auditimi,


Departamenti i Auditimit të Performancës dhe një drejtori, drejtorja e Auditimit të Brendshëm dhe Mbikqyrjes; gjithashtu është shtuar një strukturë mbështetëse, Departamenti i Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe TI, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të auditimit në KLSH, monitorimin e zbatimit të standardeve të KLSH dhe standardeve ISSAI, duke përfshirë projektet e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të eksperiencave me partnerët e institucionit dhe donatorët, në kuadrin e integritimit evropian.

Së bashku me Kryetarin dhe dy Drejtorët e Përgjithshëm, numri i punonjësve të punësuar në fund të vitit 2012 rezultoi 156, prej të cilëve 131 zotërojnë statusin e nëpunësit civil, 8 janë të aktivizuar me kontratë të përkohshme, 8 punonjës janë të aktivizuar me akt emërimi dhe 9 punonjës trajtohen me kodin e punës.

Në zbatim të Vendimit nr. 45, datë 30.03.2012 të Kryetarit të KLSH-së dhe me qëllim plotësimin e vendeve vakante në institucion, gjatë vitit 2012 janë rekrutuar gjithsej 36 punonjës prej të cilëve 25 nëpërmjet 11 konkurseve të zhvilluara sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", 3 punonjës me akt emërimi dhe 8 të tjerë me kontratë të përkohshme, nga të cilët 6 punonjës janë në vijim të kontratës së vitit 2011 dhe dy të tjerë janë punësuar për shkak të specifikave të vendit të punës gjatë vitit 2012 (këta punonjës nuk janë auditues). Numra këto që shprehin qartë tendencën në ulje në raport me vitin 2011 të aktivizimeve me kontrata të përkohshme apo edhe më shumë akoma të përgjysmimit të aktivizimeve të personelit nëpërmjet akteve të emërimit. Duke realizuar kështu një pjesë të madhe të sfidës së rekrutimit të personelit të KLSH sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Grafiku Nr. 8:

### Struktura e rekrutimit të nëpunësve



Përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave të kryera ka qenë:

- 14 Personel drejtues gjithsej (ku përfshihen Kryetari, Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive) që përbën 9% të numrit total të punonjësve. Nga viti 2011 janë shtuar 1 Drejtor i Përgjithshëm, 2 Drejtorë Departamentesh (Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës dhe Drejtor i Departamentit të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë

së Informacionit) si dhe 1 Drejtor Drejtorie (Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Mbikëqyrjes) / nga 10 që ka qënë numri gjatë 2011.

- 5 Kryeauditues që përbën 3% të numrit total të punonjësve / nga 7 në 2011.

- 105 Auditues, përfshirë 2 audituesit e brendshëm që përbën 67% të numrit total të punonjësve / nga 106 në 2011.


- 23 Punonjës mbështetës (përgjegjës sektori, specialistë, juristë, zëdhënës) që përbën 15% të numrit total të punonjësve / nga 22 në 2011.

- 9 Punonjës shërbimi që përbën 6% të numrit total të punonjësve / nga 10 në 2011.

Në total numri i stafit Kryeauditues dhe atij Auditues është 110 punonjës që zë rreth 70% të numrit total të punonjësve.

### Grafiku Nr. 9:

#### Raporti sipas pozicioneve



Struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues me arsim të lartë, kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore.

Klasifikuar sipas arsimit, në strukturën organike për vitin 2012, punonjësit me arsim të lartë zenë 145 punonjës, ose në masën rreth 93% kundrejt numrit total të punonjësve / nga 141 apo 90% që rezultonin në vitin 2011.

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë është:

35 Financierë (23%)

18 Kontabilistë (11%)

44 Ekonomistë të ndryshëm (28%)

21 Juristë (14%)

17 Inxhinierë (11%)


9 Të ndryshëm (6%)

Gjithashtu, bazuar në praktikat më të mira, gjatë vitit 2012 konstatohet rekrutimi i stafit me kualifikime të larta si dhe grada shkencore. Kështu rezultojnë 5 punonjës me gradë shkencore, 1 prej të cilëve me titullin Profesor i Asociuar dhe 4 Doktor Shkencash që përbëjnë 3.2% të totalit të stafit. Me qëllimin e qartë të ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele apo uljes në kategori, të realizuar sipas parimit të meritokracisë, bazuar në vlerësimin e performancës, gjatë vitit 2012 janë zhvilluar 4 testime dhe janë realizuar 14 ndryshime në

kategori, nga auditues të parë në auditues të Lartë ose Kryeauditues, ose nga Auditues të II në Auditues të I, duke ju dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurimit.

Duhet përmendur fakti se në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH-së në nenin 8, pika 8.1 “Drejtori i Departamentit”, nënpika 8 thekson se Drejtori i Departamentit “Në auditime të veçanta të rëndësishme, gjykuar mbi nivelin e materialitetit dhe të riskut, merr pjesë drejtpërdrejtë në procesin e auditimit në terren, në intervale kohore të shkëputura, ose përgjatë gjithë periudhës së auditimit.

Grafiku Nr. 10:



Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2012 është 48 vjeç nga 50 që rezultonte në vitin 2011, vjetërsia në institucion është rreth 5.5 vjet për person nga 9.1 që ka qenë në vitin 2011, kurse raporti femra/meshkuj 32% me 68%. Nëpërmjet kriterëve, standardeve dhe praktikave më të mira, janë bërë përpjekje për uljen e moshës mesatare të stafit të KLSH-së dhe si rezultat, të punësuarit e vitit 2012 kanë një moshe mesatare 39 vjeç. Megjithatë, mosha mesatare mbetet ende e lartë, 48 punonjës nga 156 janë të moshës 57-65 vjeç. Zbatimi me rigorozitet i ligjit organik të KLSH-së, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit, Kodit Etik, si dhe Vendimeve, Udhëzimeve dhe Qarkoreve të Kryetarit, ka bërë që gjatë vitit 2012 ndaj punonjësve të institucionit të merren në total 29 masa disiplinore nga 3 të marra në vitin 2011. Në zbërthim të tyre rezulton se 20 masa kanë qenë të tipit “Vërejtje me shkrim”, 8 masa “Vërejtje me paralajmërim”, 1 masë “Kalim në një detyrë të një niveli më të ulët” dhe një masë “Për largim nga shërbimi civil”. Masa këto të marra në 6 raste ndaj drejtorëve, në 2 raste ndaj kryeaudituesve dhe në 21 raste e tjera ndaj stafit auditues.

Në përfundim të procesit të vlerësimit vjetor të performancës së stafit auditues për vitin 2012, janë promovuar në pozicionin e Kryeaudituesit tre auditues, një auditues është promovuar si Auditues i Lartë dhe një si Auditues i Parë, ndërsa 32 auditues janë vlerësuar jo mjaftueshëm.



- **Institucioni në politikat e ndjekura për burimeve njerëzore ka vepruar:**

- Në zbatim të ligjit organik të KLSH-së, të ISSAI 20 “Parimi 4”, ISSAI 30 “Kodi Etik”, si dhe ISSAI 100 “Parimet Themelore në Auditimin e Njësive Publike”, KLSH në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH, nr. 53, datë 16.04.2012, ka përfshirë në një kapitull të veçantë Kapitulli V neni 12 “Parandalimi i konfliktit të interesave”, me qëllim shmangien dhe parandalimin e konfliktit të interesave.

- Në zbatim të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH, nr. 53, datë 16.04.2012, mbështetur në ISSAI-1 “Deklarata e Limës”, neni 14 “Stafi i Auditimit”, si dhe ISSAI-200 “Standardet e përgjithshme të auditimit shtetëror”, Kontrolli i Lartë i Shtetit në rekrutimin e personelit ka adaptuar politika dhe procedura që kanë patur në vëmendje kryesore zotërimin e njohurive të përshtatshme mbi nivelin mesatar të njohurive dhe aftësive, përvojën e duhur profesionale, kualifikimet si dhe integritetin moral të nevojshëm të personave kandidatë për të qenë pjesë e institucionit.

- Është punuar për hartimin e “Raportit të Analizës Për Vlerësimin e Burimeve Njerëzore të KLSH-së”, mbi konkluzionet e të cilit po synohen ndryshime në mënyrën e shpërndarjes së burimeve, në kërkesat për kualifikimet dhe trajnimet etj.

- Është marrë në dispozicion një program kompjuterik “Listë Paguesa dhe Burimet Njerëzore” specifik për regjistrimin e të dhënave të punonjësve dhe ka nisur puna për kalimin në format elektronik të të gjithë informacionit që ndodhet në regjistrat dhe dosjet e personelit, me qëllim dixhitalizimin e të gjithë data-base-it të Burimeve Njerëzore.

- Janë ndjekur dhe zbatuar me përpikmëri kërkesat lidhur me hartimin, shpërndarjen, plotësimin dhe dorëzimin në afat, konform legjislacionit në fuqi, të formularëve për vlerësimin e arritjeve të punonjësve në punë.

- Janë ndjekur dhe zbatuar të gjitha detyrat për plotësimin dhe dorëzimin brenda afateve të caktuara në ligjin përkatës, të formularëve të deklarimit të pasurisë nga punonjësit e ngarkuar nga ligji.

## V.2 Ecuria e procesit të trajnimeve

Gjatë vitit 2012, kryerja dhe zhvillimi i trajnimeve është udhëhequr nga Standardi i Përgjithshëm i SAI-t 200, i cili përcakton se “KLSH duhet të *adoptojë politika dhe procedura për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tij për t’i aftësuar që të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive dhe për të përcaktuar bazat për avancimit profesional të audituesve dhe stafit tjetër*”<sup>2</sup>. Aktivitetet

<sup>2</sup>Standardet e Auditimit INTOSAI, botim I KLSH, 2012, ISSAI 200, Standardet e Përgjithshme të SAI, fq.106


trajnuese të KLSH kanë synuar të sigurojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të tij, duke përfshirë përgatitjen në institucion dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së kurseve të jashtme.

Viti 2012 u karakterizua nga riorganizimi i thellë i procesit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të audituesve të KLSH i cili ndikoi ndjeshëm jo vetëm në rritjen e trajnimeve nga pikëpamja sasiore por mbi të gjitha në rikonceptimin e tyre në përmbajtje. Treguesi kryesor i ndryshimit reflektohet në rritjen e madhe të numrit të trajnimeve që çdo auditues në KLSH ka kryer gjatë vitit, brenda dhe jashtë vendit, duke arritur një nivel të paparashikuar më parë prej 19.4 ditë trajnimi/person kundrejt 2.1 të arritura në vitin 2011 dhe 3.1 ditë trajnimi/person të kryera gjatë vitit 2010.

Ndryshimi lidhur me trajnimet u karakterizua dhe me ndryshime në përmbajtjen e Programeve të Trajnimit. Tematikat e trajnimeve të kryera trajtuan në një masë të konsiderueshme çështjet kryesore dhe më të rëndësishme për audituesit, duke u përpjekur të mbulonin dhe nevojat më imediate në përshtatje me ndryshimet strategjike të drejtimit që KLSH u përball gjatë vitit 2012.

Në mënyrë të veçantë, Hapja e Institucionit ndaj politikave të trajnimit, duke mos u kufizuar vetëm në ekspertë të brendshëm por gjithashtu dhe në eksperiencën të Institucioneve homologe apo ekspertë të huaj ishte një ndihmesë e madhe për stafin e KLSH. Pjesëmarrja në trajnime të ofruara nga ekspertë të huaj, të organizuara brenda dhe jashtë vendit, u siguroi audituesve të KLSH-së njohjen me praktika auditimi të zbatuara në vende të ndryshme, ambiente të ndryshme të cilat mund të përdoren si referencë nga audituesit në të ardhmen. Numri i audituesve dhe nëpunësve të KLSH-së të trajnuar jashtë vendit në vitin 2012 është i barabartë me numrin e stafit të KLSH-së të trajnuar jashtë vendit për 7 vitet (2005-2011). Një vlerësim i veçantë shkon në këtë rast për SAI-et, NIK të Polonisë, Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë dhe të Gjykata e Llogarive të Turqisë që na kanë mbështetur për realizimin e tyre.

#### Grafiku Nr. 11:



Përzgjedhja e grupeve të trajnimit është bërë kryesisht mbi bazën e interesave dhe nevojave aktuale individuale të audituesve po ashtu dhe në interes të politikave strukturore dhe organizative të Institucionit. Përmbajtja dhe cilësia e trajnimit është përmirësuar duke u përpjekur që sistemi i trajnimit të KLSH të kthehet në një sistem të qëndrueshëm të mbështetur në metoda bashkëkohore, të orientuar nga kërkesa dhe objektivat e audituesve por mbi të gjitha, të krijohet dhe zhvillohet për të shtuar vlerën e audituesve dhe vetë KLSH si Institucioni më i Lartë i Auditimit të fondeve publike në vend.

Procesi i trajnimit për zhvillimin profesional të audituesve u krye në zbatim të “Planit Vjetor të Trajnimit 2012”, i cili u hartua në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të nevojave për trajnime të stafit të KLSH. Në Programin e Trajnimit u përcaktuan tematikat kryesore, pjesëmarrësit dhe koha e zhvillimit të trajnimit. Por duhet theksuar se, gjatë implementimit si rezultat i rishikimit dhe vlerësimit të herëpashershëm të nevojave të stafit u organizuan dhe trajnime jashtë Programit, të cilat kishin si qëllim, mbajtjen e trajnimit në terma realiste dhe sa më afër nevojave aktuale për njohuri në fushat specifike profesionale ndër të cilat mund të përmendim trajnimet mbi sistemet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimin e mjeteve që kjo teknologji ofron për auditimin (Programi IDEA), si dhe trajnime me tematika specifike sipas Departamenteve të KLSH. Megjithatë në përgjithësi tematikat që u mbuluan me trajnime gjatë vitit 2012 përfshinë:

1. Auditimi Financiar
2. Auditimi i Performances
3. Legjislacioni, përditësimi i njohurive lidhur me ndryshimet e rëndësishme
4. Auditimi i Projekteve të Huaja
5. Njohja me mjetet që Sistemet e TI ofrojnë për audituesit
6. Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik etj.

- ***Metodologjia e Trajnimit***

Përsa i përket vendit dhe Trajnimet u organizuan u ofrua në dy forma kryesore:

**Brenda vendit:** Trajnime që janë organizuar duke u mbështetur nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm, nga organizata apo institucione kombëtare apo ndërkombëtare si më poshtë:

- Në KLSH: trajnime të cilat u organizuan mbi bazë ditore nga trajnues/auditues të lartë, Kryeauditues dhe Drejtues të lartë të KLSH;
- Brenda Departamenteve të KLSH, nga stafi i departamenteve përkatës;
- Nga Ekspertë të Jashtëm nga organizma ndërkombëtarë, kryesisht SIGMA
- Trajnime të ofruara nga ITAP


**Jashtë vendit :** Trajnime të organizuara në bashkëpunim me SAI homologe të vendeve të tjera apo institucione të tjera ndërkombëtare që ofrojnë trajnime të fushës së auditimit si dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të fushës.

Në pjesën më të madhe trajnimet u organizuan si trajnime në klasë. Ato u bazuan në literaturë bashkëkohore të përgatitur nga trajnuesit dhe forma

kryesore ishte prezantimi i mbështetur nga diskutime interaktive midis trajnuesit dhe pjesëmarrësve dhe raste studimore.

Më poshtë paraqesim shpërndarjen e trajnimeve sipas mënyrës së organizimit të tyre.

Grafiku Nr. 12:



### • *Performanca e Trajnimeve dhe Treguesit*


1. Arritjen dhe për më tepër tejkalimin e objektivit që KLSH kishte vendosur për trajnimin e çdo personi staf i KLSH, i cili në 2012 u realizua në nivelin 19.4 ditë trajnimi për person në tërësi, nga të cilët:

➤ Për stafin ekzistues 17 ditë trajnimi në vit për person kundrejt 10 ditët për person të vendosur si objektiv.

➤ Për stafin e rekrutuar rishtazi u arrit objektivi 25 ditë trajnimi/person (kundrejt 25 dt/p) gjatë vitit 2012, duke mos konsideruar këtu faktin që gjithë personat kanë më pak se një vit kalendarik pune pranë KLSH.

2. Arritja e 19.4 ditë trajnimi për person gjatë vitit 2012 përfaqëson një rritje prej 9 herë, krahasuar me vitin 2011, kur ky tregues ishte vetëm 2,1 ditë për person dhe 3,1 për vitin 2010.

3. Në total u realizuan përgjithësisht **2,814** ditë trajnimi për stafin e KLSH, trajnime të të gjitha llojeve, krahasuar me 227 ditë trajnimi për vitin 2011 dhe 434 ditë trajnimi për vitin 2010. Progresi i bërë paraqitet si më poshtë:


Grafiku Nr. 13:

4. Tematikat e trajtuara në trajnime treguan dhe njëherë përpjekjet e KLSH për të zhvilluar kapacitetet audituese në përputhje me objektivat strategjike që institucioni ka vendosur për të ardhmen. Duke iu referuar informacionit mbi trajnimet e zhvilluara sipas tematikave vihet re një shpërndarje thuajse e barabartë për trajnime sipas llojeve të auditimit. Gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit vërehet një rritje e konsiderueshme e trajnimeve “ Për Auditimin e Performancës” dhe “Mbi Auditimin Financiar” por duke mos lënë mënjanë dhe fushat e tjera sic janë ato “ Mbi Auditimin e Përputhshmërisë” apo “Njohuri të Standarteve të Përgjithshme të Auditimit për KLSH”.

Një zhvillim në fushën e përmbatjes së trajnimeve ishte organizimi i trajnimeve mbi Teknologjinë e Informacionit, të cilat përfshinë jo vetëm përdorimin e mjeteve që teknologjia e informacionit ofron për audituesit në kryerjen e misionit të tyre sikurse ishin trajnimet për “Përdorimin e Programit IDEA” apo dhe programe të tjera bazë, por dhe trajnime mbi “ Auditimin e Sistemeve të Informacionit” c’ka tregon dhe njëherë për përpjekjet që drejtimi i KLSH bën për të aftësuar stafin me kapacitetet e nevojshme për t’iu përgjigjur detyrave të reja që presin zgjidhje në të ardhmen. Pesha që trajnimet sipas llojeve të auditimit apo fusha të tjera zënë në kuadrin e trajnimeve ne tërësi paraqiten si vijon:

- a) 17% “ Mbi Auditimin Financiar”
- b) 19% “ Mbi Auditimin e Performacës”
- c) 22% “ Mbi Legjislacionin dhe Auditimin e Përputhshmërisë”
- d) 19% “Mbi Auditimin dhe Sistemet e TI”
- f) 23% ”Mbi KLSH dhe Standartet e Auditimit”

Grafiku Nr. 14:




5) Rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të trajnimeve të posaçme për stafin e ri. Këto trajnime zënë 28% të gjithë totalit të trajnimeve të KLSH, të cilat bënë të mundur që treguesi për 25 ditë trajnimi/ person për stafin e sapo rekrutuar të arrihet për një periudhë kohore më pak se një vit.

6) Në përgjithësi u kryen 19.4 ditë trajnimi për punonjës gjatë vitit 2012, stafi ekzistues ka përfituar gjate këtij viti 16.6 dite trajnimi stafi i ri 25 dite trajnimi.

7) Trajnerët e angazhuar përfshinë kryesisht staf me cilësi të larta profesionale dhe drejtuese brenda KLSH. Në trajnime u angazhuan 21 kryeauditues, auditues të parë dhe drejtues të Drejtorive apo Departamenteve dhe pjesa tjetër u ofrua nga ekspertë të jashtëm.

Grafiku Nr. 15:




8) Karakteristikë e veçantë e trajnimeve të vitit 2012 ishte jo vetëm rritja e ndjeshme në aktivitetet e trajnimit jashtë vendit por dhe në gjithë përfshirjen e stafit në këto trajnime, faktor ky që tregohet në numrin e personave pjesëmarrës në trajnime apo konferenca jashtë vendit të trajnuar jashtë vendit. Trajnimet jashtë vendit përfshinë trajtimin e 23 tematikave të cilat kategorizohen si më poshtë:

- a) Auditimi Financiar
- b) Auditimi performances
- c) Mashtrimi dhe korrupsioni
- d) Vizita studimore dhe pjesëmarrje ne Konferenca e simpoziume shkencore

*Gjatë vitit u trajnuan 69 persona jashtë vendit duke arritur një mesatare trajnimi 7, 5 ditë trajnimi/person, shifër kjo e barabartë me punonjësit e trajnuar në vitet 2004-2011, të marrë së bashku.*

Grafiku Nr. 16:

### Tematika e trajnimeve jashtë vendit



### ***Trajnime specifike***

9) Duke rivlerësuar nevojat për trajnim gjatë vitit, dhe në ndjekje të zbatimit të Programit Vjetor të trajnimeve, gjatë muajit Gusht 2012 u organizua një seksion i plotë një mujor trajnimesh brenda KLSH. Qëllimi i organizimit të kësaj veprimtarie trajnuese në këtë periudhë ishte intensifikimi i trajnimeve si dhe arritja e objektivit për t'u trajnuar minimalisht 10 ditë në vit për stafin me eksperiencë dhe 25 ditë për stafin e ri.


10) Duke monitoruar cilësinë e punës së audituesve, u vlerësua se kishte një nevojë të ngutshme për trajnime në fushën e teknologjisë së informacionit. Për këtë qëllim , gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor 2012 u organizuan dy seksione trajnimi:

a) *seksioni i parë* lidhur me përdorimin e programit IDEA, 10 dite trajnimi te ofruara për të gjithë stafin auditues ku morën pjesë rreth 90 auditues.

b) *seksioni i dytë* lidhur me thellimin e njohurive bazë në përdorimin e programeve të veçanta të kompjuterit, i cili u organizua në bazë të shprehjes së interesit nga vetë audituesit. Trajnimi u organizua për 7 ditë në vazhdim dhe morën pjesë 115 persona. Në tërësi gjatë vitit 2012 janë organizuar 461 ditë

persona trajnimi për sistemet e TI-së nga të cilat 67% u organizuan për Programin IDEA dhe 33 për Njohuri të Përgjithshme të TI:

Grafiku Nr. 17:



***Trajnime nga burime të tjera:***

11) Trajnimet nga ITAP përfshijnë kryesisht tematika të njohjes me kuadrin e përgjithshëm ligjor të administratës publike, dhe në përgjithësi kanë kontribuar në pajisjen e audituesve dhe stafit tjetër me aftësitë “soft skills” dhe cilësitë e nevojshme për nëpunësin civil. Trajnimet nga ITAP përbëjnë rreth 12 % të gjithë kuadrin të trajnimeve në KLSH. Këto lloj trajnimesh shërbyen për të përmbushur nevojat shtesë për trajnime të përgjithshme krahas atyre në fushën specifike të auditimit.

Megjithë arritjet e përmendura më sipër, ne jemi të ndërgjegjshëm që gjatë implementimit të Planit të Trajnimit ka pasur edhe mangësi që lidhen më së shumti me mungesën e eksperiencës nga periudhat e mëparshme në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të trajnimit

## **VI. PARTNERITETI PËR NDRYSHIM**

### **VI.1 Partnerët vendas**

Bashkëpunimi i KLSH me Kuvendin është realizuar kryesisht nëpërmjet Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, i cili ka shqyrtuar dhe i ka propozuar Kuvendit çështje që kanë të bëjnë me Buxhetin e Shtetit dhe burimet publike në tërësi. Ky Komision ka analizuar dhe dhënë opinionin e tij për veprimtarinë e vitit 2011 të kryer nga institucioni, të materializuar në Rezolutën e datës 26 Prill 2012 për Veprimtarinë e KLSH gjatë vitit 2011, të miratuar nga Kuvendi.

KLSH gjatë vitit 2012 ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për institucionalizimin e bashkëpunimit me Qeverinë, duke sinkronizuar veprimtarinë e vet në veçanti me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe



Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha. Institucioni gjatë vitit të kaluar lidhi marrëveshjet e bashkëpunimit si me poshte:

- Me Ministrinë e Financave për Auditimin e Brendshëm, nënshkruar me Ministrin Ridvan Bode në Maj 2012. Marrëveshja synon komunikimin e ndërsjelltë të planeve dhe strategjive të auditimit të të dyja institucioneve, dokumentimin e proceseve operationale dhe sistemeve të enteve të audituara, zhvillimin dhe kryerjen e procedurave të koordinuara të auditimit, si dhe investigimin e përbashkët të rasteve të dyshuara si mashtrim financiar apo korrupsion.



**Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis  
Ministrit të Financave përfaqësuar nga Ministri Dr. Ridvan Bode dhe  
KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari Dr. Bujar Leskaj  
Tiranë, 8 maj, 2012**

- Me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, nënshkruar në Qershor 2012, marrëveshje e cila u rivitalizua në Dhjetor 2012. Në bazë të kësaj marrëveshje, të dyja palët do të punojnë së bashku të evidentojnë saktë shkeljet që përbëjnë vepër penale në fushën e administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj.

- Me Autoritetin e Konkurrencës, nënshkruar në Mars 2012, me qëllim përmirësimin e kontrollit të përdorimit efektiv të fondeve publike dhe të mirëadministrimit financiar, si dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

- Me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, në Mars 2012, me synim forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korrupsionit, konfliktin e

interesave dhe parandalimin e veprimeve që çënojnë mirëfunksionimin e administratës publike.

- *Me Agjencinë e Prokurimit Publik*, nënshkruar në Dhjetor 2012, për rritjen e kapaciteteve dhe njohurive profesionale të stafit të KLSH në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe intensifikimin e shkëmbimit të informacionit të ndërsjelltë; dhe

- *Me Departamentin e Administratës Publike (DAP)*, nënshkruar në Dhjetor 2012, nëpërmjet së cilës institucioni merr përsipër të angazhojë staf për aktivitete të ndryshme me DAP, të tilla si trajnime, takime konsultative, tryeza të rrumbullakëta, seminare, etj.; aktivitete këto që synojnë rritjen e cilësisë së punës së stafit të KLSH dhe pjesëmarrjen e DAP nëpërmjet asistencës teknike për përmirësimin e funksionimit të institucioneve të administratës publike.

Rezultatet e deritanishme të bashkëpunimit me institucionet e mësipërme janë premtuese, pasi puna ka filluar të lëvizë në drejtimin e duhur, duke kërkuar më shumë bashkëpunim dhe bashkërendim për rritjen e efektivitetit të masave për luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Një vlerë të shtuar në punën tonë kemi konsideruar dhe vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me *shoqatat profesionale të auditimit dhe kontabilistëve*, si partnerë të rëndësishëm. Ky prioritet është konkretizuar në fund të muajit dhjetor 2012, ku në Konferencën e Parë shkencore të KLSH u nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me *Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)* dhe *Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit*. Synimi i nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit në fushën e auditimit të jashtëm dhe në fusha të tjera me interes të përbashkët. Në këtë kuadër theksojmë bashkëpunimin me ambientet Akadematike, me Profesoratin e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës. Marrëdhëniet janë marrëdhënie pune, por nuk janë institucionalizuar në marrëveshje për arsye burokratike.

Bashkëpunimi me *shoqërinë civile* ka filluar të institucionalizohet për herë të parë në vitin 2012, nëpërmjet nënshkrimit në Prill 2012 të marrëveshjeve të bashkëpunimit “Për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës” me OJF, ndër më aktivet në luftën kundër korrupsionit dhe konkretisht me organizatën Transparency International në Shqipëri, lëvizjen “Alternativa Civile”, Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, Institutin e Studimeve Bashkëkohore, Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Lëvizjen Evropiane Shqipëri, dhe në Dhjetor 2012 me Institutin “G&G Group”. Në këto marrëveshje partneriteti, janë specifikuar kontributi i KLSH-së dhe i OJF-ve dhe koordinimi me njëri tjetrin nëpërmjet pikave të kontaktit, nisur nga interesi i përbashkët për një luftë pa kompromis, transparente dhe në sistem kundër korrupsionit, si dhe nga ekspertiza që ekspertë të OJF-ve mund të japin në analizën e riskut dhe përzgjedhjen e auditimeve të institucionit.

## VI.2 Partnerët Ndërkombëtarë

Kemi intensifikuar marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare të auditimit si *INTOSAI* dhe *EUROSAI*, ku KLSH është anetar aktiv, si dhe me *SIGMA*; ndërsa me institucionet homologe të auditimit janë institucionalizuar marrëdhëniet me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, me Gjykatën e Llogarive të Turqisë, me Zyren Kombëtare të Auditimit (NIK) të Polonisë dhe me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Kroacisë, duke plotësuar kështu një nga prioritetet e përcaktuara në Programin e 100-ditëve të fillimvitit 2012. Më konkretisht:

- Në shkurt të vitit 2012, KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës.
- Prill 2012, me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë.
- Maj 2012, me Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës së Polonisë (ndryshe NIK Poloni).
- Nëntor 2012, me Gjykatën Turke të Llogarive dhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kroacisë.



Në zyrën e Kryetarit të KLSH-së, më 29 nëntor 2012  
Dr. Bujar Leskaj priti delegacionet e ardhura me rastin e festimeve të 100-Vjetorit të Pavarësisë.

(Në foto nga e djathta: z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Dr. Igor Šoltes, President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, Dr. Bujar Leskaj, z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Kroacisë, z. Hiqmet Cavit Erdogan, Anëtar i Lartë i Dhomës së Gjykatës së Llogarive të Turqisë.)

KLSH, me kërkesë të tij, ka intensifikuar marrëdhëniet me *SIGMA* (Programi I BE dhe OECD “Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim”), ekspertët e të cilës e kanë mbështetur institucionin me programe trajnimi, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012 dhe në fusha trajnimi me interes të lartë, si auditimi financiar, auditimi i përputhshmërisë, auditimi i performancës, auditimi i sistemeve të teknologjise së informacionit, etj.

Në marrëdhëniet me SIGMA-n, vlen të cilësohet kontributi dhe bashkëpunimi frytdhënës me ekspertin e njohur të saj z. Joop Vrolijk për përgatitjen e sesioneve trajnuese dhe të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2013-2017.

Vlen për t'u theksuar partneriteti i vendosur mes KLSH dhe DG-Budget, si dhe në tërësi me Delegacionin e BE-së në vendin tonë. DG-Budget dhe në veçanti Drejtori i Njësisë së saj, z. Robert Gielisse dha një kontribut të vyer në përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të KLSH.

*Delegacioni i BE-së në Tiranë*, dha mbështetjen e tij për fitimin e Projektit të Binjakëzimit, të propozuar nga KLSH në kuadër të fondeve IPA 2013. Projekti do të mundesoje zgjerimin dhe ngritjen cilësore të kapaciteteve audituese të institucionit, nepermjet trajnimeve dhe manualeve që parashikohet të realizojë. Ai do të kontribuojë në plotësimin e kuadrit nënligjor për zbatimin e amendimeve të ligjit të KLSH. Theksojmë ndihmën dhe koordinimin e Ministrisë së Integritimit në fitimin e këtij projekti dhe veçanërisht e mbi të gjitha të Kryeministrit Prof. Dr. Sali Berisha.

## **VII. BUXHETI VJETOR I KLSH**

Në zbatim të ligjit organik të KLSH dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të institucionit, Drejtoria Ekonomike ka për mision mbështetjen e aktivitetit kryesor të institucionit, për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin normal të punës, duke siguruar mjetet e nevojshme dhe rezervat për vazhdimësinë e punës dhe miradministrimin e pasurisë së institucionit.

Në zbatim të ligjit për MFK-në, Kryetari i KLSH-së ka nxjerrë aktet përkatëse me të cilat është miratuar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Institucionit dhe Koordinatorit të Riskut (urdhri nr. 32, date 26/3/2012), ndërkohë që është caktuar Nëpunës Autorizues Drejtori i Përgjithshëm që mbulon Drejtorinë Ekonomike dhe Nëpunësi Zbatues Përgjegjësja e Sektorit të Financës. Për vitin 2012, është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut së institucionit, e cila është e detajuar për çdo Departament dhe Drejtori, strategji e cila u është dhënë për ndjekje dhe zbatim sipas përkatësisë çdo Drejtori Departamenti dhe Drejtorie.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit për MFK-në brenda muajit shkurt 2012 është dërguar në Ministrinë e Financave të Nëpunësi i parë Autorizues Deklarata dhe Raporti Vjetor "Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në KLSH", si dhe Pyetësori "Për vetëvlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në KLSH".

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2012 është kryer në mënyrë periodike kontrolli i shpenzimeve ditore për prokurimet dhe të gjitha llojet e shpenzimeve të kryera me bankë dhe arkë.

- Çdo muaj është bërë rakordimi i situacioneve të shpenzimeve të buxhetit me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave.

- Janë hartuar në kohë evidencat statistikore sipas formularëve përkatës, po kështu, raporti i shpenzimeve faktike të KLSH sipas artikujve të buxhetit dhe raporti i monitorimit të tyre çdo 3-mujor.
  - Është ndjekur me përparësi zbatimi në kohë i detyrave për përdorimin me efektivitet të buxhetit të vitit 2012, duke respektuar kërkesat ligjore financiare. Për këtë qëllim, është bashkëpunuar rregullisht ndërmjet sektorit të financës, me specialistët e shërbimeve dhe komisionin e blerjeve me vlera të vogla, të ngritur në fillim të vitit 2012 me urdhër të brendshëm, duke siguruar me parë ofertat më të përshtatshme, si dhe duke bërë çdo muaj rakordimet e këtyre shpenzimeve dhe plotësuar evidencat përkatëse.
  - Është realizuar në afat mbyllja e bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2011. Gjithashtu, janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit për realizimin e shpenzimeve të buxhetit, si dhe janë bërë akt-rakordimet për çeljen dhe lëvizjen e fondeve buxhetore me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financës.
  - Janë dorëzuar brenda afatit pranë Drejtorisë së Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit, raportet e monitorimit të shpenzimeve faktike, sipas programeve dhe artikujve.
  - Të gjitha pagesat e punonjësve si paga, dieta, paradhënie e shërbime të tjera me arkën janë kryer brenda rregullave. Janë ushtruar kontrole sistematike në arkë dhe në asnjë rast nuk janë konstatuar diferenca.
  - Shërbimet jashtë vendit janë mbyllur brenda afatit dhe në fund të çdo muaji situacioni i shpenzimeve të valutës jo tregtare është dërguar në Drejtorinë e Thesarit pranë Ministrisë së Financës.
  - Veprimet ekonomike të kryera në KLSH, janë pasqyruar gjithmonë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.
  - Dokumentet vërtetuese si faturat, fletëhyrjet, fletëdaljet, mandat-arkëtimet, mandat-pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi, janë kryer në mënyrë kronologjike.
- Sipas afateve të parashikuara në udhëzimin e MF-ve për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013, Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe departamentet e tjerë ka përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit PBA-në e viteve 2013-2015, përkatësisht në muajin prill dhe gusht 2012. Si rrjedhojë e punës së bërë dhe ndjekjes hap pas hapi të procesit të caktimit të fondeve buxhetore të KLSH për vitin 2013, si dhe ndihmesës së Komisionit të Ekonomisë dhe Ministrisë të Financave, për këtë vit janë akorduar 296 milionë lekë, nga 260 milionë që kishim në vitin 2012, pra një rritje e konsiderueshme kryesisht në investime, paga dhe sigurime shoqërore.
- Në fillim të vitit 2012, është dërguar brenda afatit regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2011 dhe regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2012.
  - Për vitin 2012, buxheti është realizuar në masën 99.5%. Situacioni i zbatimit të buxhetit 12-mujor për KLSH, i krahasuar me planin 12-mujor (sipas strukturës së shpenzimeve të miratuar) paraqitet si më poshtë:

Në mijë/lekë

<i>Artikulli</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani vjetor</i>	<i>Realizimi 12-mujor</i>	<i>Në %</i>
600	Paga	183,802	183,415	99.8
601	Sigurime shoqërore	25,791	24,921	96.6
602	Shpenzime operative	46,853	46,849	100.0
604	Pagesë kalimtare	586	586	100.0
605	Kuote anëtarësie	200	125	62.4
606	Ndihmë sëmundje	638	638	100.0
231	Investime	5,000	4,927	98.5
	<b>TOTALI:</b>	<b>262,870</b>	<b>261,461</b>	<b>99.5</b>

Nga shqyrtimi i këtyre të dhënave të shpenzimeve, rezulton se, zëri “*Shpenzime Operative*”, “*Pagesë kalimtare*” dhe “*Ndihmë sëmundje*” janë realizuar sipas kuotave të planifikuara, gjithashtu, zëri “*Paga*” është realizuar në masën 99.8%, me një mosrealizim në shumën 387 mijë lekë, i cili ka ardhur nga mospërdorimi i fondit të pagave në 3/mujorin e parë 2012, si rrjedhojë e mosplotësimit të numrit të punonjësve të planifikuar prej 156. Kurse, zërat e tjerë rezultojnë me mosrealizime të vogla, që gjithsesi përbëjnë detyrë për të ardhmen, në planifikim edhe në ndjekjen e tyre në mënyrë më rigorozë gjatë gjithë vitit. Gjithsesi, duhet pasqyruar se kuotat e shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara gjatë vitit 2012, rezultojnë shumë më pozitive se ato të realizuar një vit më parë.

Referuar *shpenzimeve operative*, cilësojmë se detyrimet ndaj të tretëve si për blerjet dhe për shërbimet e parashikuara në planin e 12-mujorit të vitit të kaluar, janë likuiduar në kohë.

Zëri “*Shpenzime udhëtimi*”, që zë dhe peshën më të madhe në shpenzimet operative, për vitin 2012 është realizuar si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>12-mujori 2012 (në mijë/lek)</i>	<i>Realizuar në % në raport me shpenzimet operative</i>
I.	<b>Dieta gjithsej:</b>	<b>30,373</b>	<b>64.8</b>
	Nga këto:		
1.	Brenda vendit	19,465	41.5
2.	Jashtë vendit	10,908	23.3

Krahasuar me vitin 2011, shpenzimet për dieta brenda vendit rezultojnë me ulje, ndërsa shpenzimet për dietat jashtë vendit me një rritje të konsiderueshme. Rritja ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e zbatimit të detyrave të vëna nga Kryetari i KLSH-së për trajnimin e audituesve në institucionet homologe të auditimit, sidomos në Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, NIK Poloni dhe Gjykatën e Llogarive Turqi. Janë 69 auditues që janë dërguar jashtë vendit në këtë periudhë (sa shtatë vitet paraardhës të marrë së bashku). Theksojmë se dhe në total është përdorur i njëjti fond për dieta brenda dhe jashtë vendit si në vitet e shkuara.

Gjatë vitit 2012, KLSH ka botuar serinë e tij me botime informative dhe të fushës me 10 tituj, për realizimin e të cilëve janë shpenzuar 1.8 milionë lekë. Titujt e botimeve janë: “KLSH-Analiza Vjetore 2011”, “KLSH në Kuvend”, “KLSH-Analiza 6-mujore 2012”, “EUROSAI dhe SAI-t Evropiane”, “Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200”, “Historiku i KLSH 2925-2012”, tre numra të revistës shkencore “Auditimi Publik” dhe “Manuali i përditësuar i Auditimit të Performancës”, me tirazh nga 200-1000 kopje.

Në shpenzimet e kryera për energjinë elektrike, telefoninë dhe ujë është treguar kujdes dhe korrektësi dhe shpenzimet e kryera rezultojnë brenda kuotave të planifikuara dhe në nivele të pranueshme krahasuar me numrin e zyrave dhe të punonjësve. Krahasuar me totalin e shpenzimeve operative vjetore, shpenzimet faktike për ujë, energji elektrike, telefoni fikse dhe telefoni celular, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Shërbime nga të tretë</i>	<i>Viti 2012 (në mijë/lek)</i>	<i>Realizuar në % në raport me faktin e shpenzimeve operative</i>
1.	Ujë	119	0.3
2.	Energji elektrike	822	1.75
3.	Telefoni	427	0.9
4.	Celular	652	1.4
5.	Posta	564	1.2
	<b>TOTALI:</b>	<b>2,584</b>	<b>5.5</b>

Gjatë vitit 2012, është treguar kujdes për plotësimin e nevojave me artikuj të tjerë: kancelarie, për mirëmbajtjen e mjedisit, për riparimin e pajisjeve etj. Në raport me shpenzimet faktike operative në total, realizimi i këtyre zërave paraqitet si më poshtë vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Viti 2012 (në mijë/lekë)</i>	<i>Realizuar në % në raport me faktin e shpenzimeve operative</i>
1.	Materiale zyre e të përgjithshme	2,469	5.3
2.	Shërbime nga të tretët	2,197	3.3
3.	Mirëmbajtje të zakonshme	534	0.9
4.	Shpenzime të tjera operative	2,854	7.9
	<b>TOTALI:</b>	<b>8,054</b>	<b>16.3</b>

Për vitin 2012, *në fushën e transportit*, është kryer në mënyrë periodike kontrolli i shpenzimeve ditore për rastet e prokurimeve të drejtpërdrejta si dhe të gjitha llojet e shpenzimeve me bankë dhe arkë.

- Është punuar për mbajtjen në gatishmëri të mirë teknike të automjeteve, duke respektuar afatet e kryerjes së shërbimeve.

- Është bërë përgatitja e të dhënave dhe pajisja në kohë me taksa fikse plus siguracionin e të gjithë auto-veturave.

- Të gjitha shpenzimet e kryera si konsumi i karburantit, shërbimi i mirëmbajtjes së automjeteve, taksat dhe figuracionet, janë evidentuar për çdo muaj dhe për çdo mjet në veçanti.

Shpenzimet për blerje dhe shërbime në fushën e transportit, paraqiten si më poshtë:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Viti 2012 (në mijë/lekë)</i>	<i>Realizuar në % në raport me faktin e shpenzimeve operative</i>
1.	Karburant	3,754	8.0
2.	Lubrifikante	214	0.5
3.	Pjesë këmbimi	710	1.5
4.	Goma	318	0.7
5.	Siguracione dhe taksa fikse	465	1.0
6.	Shpenzime të tjera e servis	372	0.8
	<b>TOTALI:</b>	<b>5,833</b>	<b>12.5</b>

Nga krahasimi i sasisë së karburantit të tërhequr, me atë që justifikohet me fletë-udhëtimet për 12-mujorin e vitit 2012, rezulton se nuk ka diferenca.

Në kushtet kur veprimtaria ekonomiko financiare e institucionit nuk është audituar që nga viti 2002 nga një organizëm i pavarur i caktuar nga Kuvendi, ashtu siç përcaktohet në Ligjin Organik të KLSH; auditimin e llogarive të vitit 2011 dhe 2012 e kemi realizuar me njësinë tonë të auditimit të brendshëm. Kështu, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së me nr. 40 prot., datë 10.01.2013, është kryer auditimi i KLSH me objekt: *“Mbi vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe aktivitetit ekonomik-financiar të KLSH për periudhën 01.01.2012 deri 21.12.2012”*.

Në përfundim, është hartuar Raporti Final i Auditimit, qëllimi i të cilit është që t'i ofrojë Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, një përmbledhje vjetore të aktivitetit të institucionit në fushën e menaxhimit të financave publike dhe një vlerësim të funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Ky raport vjen si kërkesë e Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar e Kontrollin”. Gjithashtu në realizimin e auditimit janë mbajtur parasysh përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012”, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me udhëzimet përkatëse, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e funksionimit të institucionit të KLSH-së.

Auditimi u krye nga data 14.1.2013 deri më datën 14.2.2013, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit të sipërcituar, Projektraporti ju dha Drejtorit të Përgjithshëm me cilësinë e Nëpunësit Autorizues, për të cilin bënë vërejtjet dhe dhanë mendime punonjësit e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtori i Përgjithshëm, duke i diskutuar dhe në një takim përmblyllës dhe reflektuar në Raportin Final të Auditimit.



Pavarësisht sa më sipër, është urgjente auditimi i llogarive të KLSH nga një organizëm i pavarur. Për këtë, kemi kërkuar në mënyrë verbale dhe shkresore kryerjen e auditimit sa më parë dhe më konkretisht: - me shkresën nr. 208, datë 02/02/2012 dhe shkresën nr. 195, datë 14.02.2013 i jemi drejtuar Kryetares së Kuvendit; ndërsa me shkresën nr. 208/1, datë 03/02/2012 dhe nr. 195/1, datë 14/02/2013 i jemi drejtuar Kryetarit dhe Zv/Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvend.

Çështja e auditimit të llogarive të KLSH-së është trajtuar dhe në rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH”, më konkretisht ato të vitit 2007 dhe 2009, ku ndër objektivat e punës së Kuvendit renditet objektivi për: *“Realizimin e detyrimit ligjor për auditimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të institucionit (KLSH)”*.

Kryerja e auditimit të jashtëm të pavarur në institucionet supreme të auditimit (SAI) cilësohet dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI (ISSAI 20, Parimi 6), po kështu dhe në rekomandimet e paraqitura nga SIGMA në raportet e vlerësimit të veprimtarisë të KLSH-së për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011.

Ndërkohë që, në Rezolutën A/66/209, datë 22 dhjetor 2011, të Asamblesë së Përgjithme të Kombeve të Bashkuara, mbi Pavarësinë e Institucioneve më të Larta të Auditimit, ndër të tjera vlerësohet Deklarata e Limës e vitit 1977 dhe Deklarata e Meksikës e vitit 2007 mbi pavarësisë e SAI-ve, si dhe inkurajohen Shtetet Anëtare dhe Parlamentet e tyre t’i aplikojnë këto deklarata, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare.

Nëse Kuvendi nuk do të ketë mundësi të dërgojë Auditues të pavarur brenda muajit qershor 2013, atëherë në cilësinë e Kryetarit të KLSH-së do të kërkojë auditim nga organizata profesionale përmes një procesi transparent përzgjedhjeje ose të audituesve nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës apo të ndonjë institucioni tjetër simotra.

## **VIII. VLERËSIM PËR KLSH**

**VIII.1** Nga fjala e Presidentit të Republikës, Sh.T.Z. Bujar Nishani, në analizën vjetore 2012 të KLSH:

*“Dua të nënvizoj vlerat dhe rëndësinë që ka në piramidën e institucioneve shtetërore, institucioni juaj, vlerën e pazëvendësueshme dhe rëndësinë e madhe të kontributit që ka angazhimi personal i gjithsecilit prej jush, auditëve. Kjo do të thotë në gjykimin tim, që në radhë të parë të gjitha institucionet shtetërore, vetë shoqëria shqiptare duhet të perceptojë dhe të manifestoje një vlerësim për angazhimet dhe kontributet tuaja. Dhe nga ana tjetër, gjithsecili prej jush duhet ta vlerësojë se sa i rëndësishëm është roli që përfaqësoni, pasi shpesh herë rëndësia e rolit që ka një individ i caktuar, angazhimet dhe kontributet e çdo individi veçanërisht në pozicione të tilla, siç ju jeni, në mënyrë të padrejtë nuk vlerësohen në kontekstin edhe shoqëror, edhe institucional, por edhe individual.*”



Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Bujar Nishani,  
në analizën vjetore 2012 të KLSH:

*Secili prej jush ka një rol dhe një pozicion të veçantë në shoqëri. Kjo automatikisht do të thotë përgjegjësi shumë e madhe për secilin prej jush në raport me shoqërinë, me qytetarin, me institucionet e shtetit, në raport me vetë shtetin...*

*Vlerësoj shumë angazhimin dhe hapat konkretë që ju keni hedhur në institucionalizimin dhe konkretizimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera kushtetuese të vendit, veçanërisht me Prokurorinë e Përgjithshme. Gjej rastin për të shprehur besimin tim të plotë se ky bashkëpunim, ky përkushtim, kjo dëshirë dhe ky vizion i shprehur tashmë në sy të opinionit publik për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucionit tuaj dhe Prokurorisë së Përgjithshme, do të sjellë shembuj konkretë në sytë e opinionit publik...*

*Unë besoj fort se rezultati tregohet tek statistikat, tek treguesit matës të një pune konkrete dhe jam shumë i inkurajuar tek shoh që numri i auditimeve të kryera nga ju në muajt e fundit ka një rritje shumë të madhe. Kjo nuk është një statistikë e pavlerë, nuk është një statistikë thjesht empirike, kjo tregon dinamizëm, tregon angazhim. Padyshim që hapi i dytë mbetet për të parë eficiencën e këtij dinamizmi, të këtij angazhimi dhe kjo tregohet kur të gjitha mekanizmat, të gjitha instrumentet e shtetit ligjor mbeten në të njëjtin nivel angazhimi.*

*Dëshiroj të shpreh të gjithë falenderimin tim për bashkëpunimin që ju kanë ofruar institucionet partnere nga Kosova, Polonia dhe nga vende të tjera. Është një strategji dhe një objektiv shumë i mençur i tërë juve që përfaqësoni institucionin, në vendosjen e një bashkëpunimi të tillë, i cili nuk është aspak honorifik, aspak protokollar. Është një përzgjedhje dhe një angazhim strategjik në luftën e përbashkët ndaj shkeljes së ligjit dhe akteve të korrupsionit. Sa më e*

*sofistikuar bëhet veprimtaria, sa më antiligjore, aq më i fortë duhet të bëhet bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes partnerëve. Prandaj unë gjej rastin për t'ju inkurajuar akoma më shumë në këtë lloj bashkëpunimi, në forcimin e këtyre kontakteve, shkëmbimeve të informacionit, pse jo dhe të angazhimeve operacionale të përbashkëta në frymën e ligjit dhe Kushtetutës që ne kemi”.*

**VIII.2** Nga Rezoluta e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2011” datë 26 prill 2012:

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2011, KLSH

-Ka realizuar detyrat sasiore e cilësore të planifikuara në drejtim të veprimtarinë kontrolluese.

-Është përpjekur të zbatojë dhe të zhvillojë një metodologji bashkëkohore në kontroll, duke përgatitur, përmirësuar dhe përditësuar udhëzimet dhe metodikat përkatëse.

-Në auditimet financiare, u është dhënë përparësi sektorëve të ekonomisë apo subjekteve që janë vlerësuar me materialitet dhe risk të lartë. Auditimi i performancës duhet të zërë një vend më të gjerë në kontrollet dhe vlerësimet që bën institucioni.

-Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve.

-Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore.

-Ka përmirësuar veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe ka rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore.

-Është i nevojshëm përshtetimi më tej i ritmeve të kualifikimit të punonjësve dhe aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kuvendi vlerëson masat që po merr institucioni në lidhje me këtë çështje.

-Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike. Raporte më efektive duhet të krijohen me institucionet e hetimit.

-Ka përdorur fondet buxhetore në përputhje me kuotat e planifikuara sipas zërave të buxhetit.



Komisioni i Ekonomisë dhe Financave në mbledhjen e raportimit të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011, Mars, 2012

*sofistikuar bëhet veprimtaria, sa më antiligjore, aq më i fortë duhet të bëhet bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes partnerëve. Prandaj unë gjej rastin për t'ju inkurajuar akoma më shumë në këtë lloj bashkëpunimi, në forcimin e këtyre kontakteve, shkëmbimeve të informacionit, pse jo dhe të angazhimeve operacionale të përbashkëta në frymën e ligjit dhe Kushtetutës që ne kemi”.*

**VIII.2** Nga Rezoluta e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2011” datë 26 prill 2012:

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2011, KLSH

-Ka realizuar detyrat sasiore e cilësore të planifikuara në drejtim të veprimtarinë kontrolluese.

-Është përpjekur të zbatojë dhe të zhvillojë një metodologji bashkëkohore në kontroll, duke përgatitur, përmirësuar dhe përditësuar udhëzimet dhe metodikat përkatëse.

-Në auditimet financiare, u është dhënë përparësi sektorëve të ekonomisë apo subjekteve që janë vlerësuar me materialitet dhe risk të lartë. Auditimi i performancës duhet të zërë një vend më të gjerë në kontrollet dhe vlerësimet që bën institucioni.

-Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve.

-Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore.

-Ka përmirësuar veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe ka rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore.

-Është i nevojshëm përshtetimi më tej i ritmeve të kualifikimit të punonjësve dhe aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kuvendi vlerëson masat që po merr institucioni në lidhje me këtë çështje.

-Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike. Raporte më efektive duhet të krijohen me institucionet e hetimit.

-Ka përdorur fondet buxhetore në përputhje me kuotat e planifikuara sipas zërave të buxhetit.



Z. Bujar Leskaj duke raportuar për veprimtarinë e KLSH-së të vitit 2011 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, Mars, 2012

**VIII.3** Nga Progres Raporti 2012 i BE për Shqipërinë, faqe 66:

*“Ka pasur progres në fushën e auditimit të jashtëm. Një kryetar i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), u emërua nga Parlamenti në dhjetor 2011. Pas disa viteve në ngecje, projekt-ndryshimet në Ligjin për KLSH për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) janë përgatitur dhe janë dorëzuar në procedurë të miratimit”.*

**VIII.4** Nga Raporti faktmbledhës për Shqipërinë i Misionit të DG-BUDGET në tetor 2012, dërguar nga Delegacioni i BE në Tiranë:

*“Një projektligj për ndryshime në Ligjin për KLSH është përgatitur dhe u është kaluar jo-zyrtarisht deputetëve të Komisionit përkatës parlamentar për komente në korrik 2012.*

*Z. Leskaj ka vendosur në lidhje me ndryshimin e fokusit kryesor të operacioneve të KLSH. KLSH tani është duke u larguar nga kryerja e auditimit të tipit kryesisht inspektive dhe po ndërton kapacitete për të lëvizur në një rol në përputhje me INTOSAI.*

*KLSH ka bërë përmirësime në përfaqsimin e tij për auditimin financiar dhe ka krijuar një departament për auditimin e performancës. Përmirësimi i auditimit të performancës do të jetë një nga qëllimet kryesore të KLSH në vitet e ardhshme. KLSH është aktualisht në procesin e hartimit të një plani zhvillimi strategjik që do të udhëheqë reforma të mëtejshme.*

*Përveç kësaj, këtë vit KLSH ka raportuar mbi zbatimin e Menaxhimit Financiar (MFK) dhe Kontrollit të Brendshëm në sektorin publik. Ka sjelle gjetje të rëndësishme në lidhje me linjat e raportimit të oficerëve financiarë ekzekutues dhe përdorimin jo-sistematik të menaxhimit të riskut.*

*Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të DG-Budget, KLSH ka miratuar raportimin me dy kolona (ku vendosen edhe pretendimet e të audituarve) në Parlament. Megjithatë, efikasiteti i ndjekjeve parlamentare të rekomandimeve të KLSH mund të përmirësohet edhe më tej.*

*KLSH ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, në maj 2012. DG-Buxheti e sheh këtë si një sinjal shumë pozitiv, pasi të dyja organizatat janë të përfshira në promovimin e qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies, përfshirë praktikën për të kuptuar më mirë rolin e Kontrollit të Brendshëm, auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm. Përveç kësaj, bashkëpunimi më i mirë operacional mund të çojë në shmangien e mbivendosjes midis KLSH dhe veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe monitorimin më të mirë të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.*

*Marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar edhe me aktorët e tjerë kyç, duke përfshirë dhe Zyren e Prokurorit të Përgjithshëm. Si rezultat, KLSH ka sjellë në Prokurori raste të konsiderueshme kallëzimi më shumë se më parë.*



*KLSH ka aplikuar për te Delegacionit i BE-së për një Projekt të Binjakëzimit IPA 2013 për të rritur kapacitetin e tij në përputhje me standardet e INTOSAI.*



*Z. Robert Gielisse duke diskutuar në takimin me akademikët për amendimet e Ligjit të KLSH-së, Nëntor 2012*

### Konkluzion

*DG- Budget ka një përshtypje pozitive të përpjekjeve reformuese të vazhdueshme të KLSH. Miratimi i ndryshimeve në ligjin KLSH do të përfaqësojë një hap të rëndësishëm përpara dhe KLSH është i inkurajuar për të prodhuar një plan të ri Strategjik të Zhvillimit, për të drejtuar përpjekjet për reformat në të ardhmen. DG-Buxheti mbështet interesin entuziast të KLSH-së për të vlerësuar funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar (KBFP) në administratën publike”.*

**VIII.5** Nga përshëndetja e z. Jacek Jezierski, President i Zyrës Kombëtare të Auditimit Suprem të Polonisë (NIK) për revistën shkencore të KLSH “Auditimi Publik nr. 2”, faqe 1-3:

*“Unë ndihem shumë i nderuar që SAI Polak është partner i SAI-t Shqiptar në këtë moment tranzicioni të shpejtë të vendit tuaj. Në vitin 1990, siç jeni në dijeni, Polonia po kalonte një tranzicion politik dhe ekonomik të thellë dhe të shpejtë... Qeverisë ju desh të vepronte nën një presion të madh politik, social dhe ekonomik dhe ju desh të përballlej me pritje shumë të mëdha. Në një farë mënyre, ajo situatë ishte e ngjashme me atë që ne të gjithë po përballojmë këto ditë pothuajse në çdo vend të globit, gjatë kohës së krizës globale kur gjërat ndryshojnë pothuajse çdo ditë, ndonjëherë në mënyrë dramatike. Në kohë të tilla, qeveritë duhet të veprojnë shpejt dhe të marrin vendime të rrezikshme. Kjo pritet që ato të bëjnë. Megjithatë, situata të tilla janë si ecja mbi një shtresë akulli shumë të hollë, gjithmonë paraqitin një rrezik për gabime, neglizhencë apo*

*edhe keqpërdorim të pushtetit. Dhe kjo është arsyeja pse ne, SAI-t e pavarura, duhet të punojmë shumë dhe të vëzhgojmë nga afër qeveritë, në mënyrë që të jemi në gjendje të ofrojmë informacion të besueshëm dhe rekomandime për parlamentet tona dhe për publikun. Kështu sigurojmë një shtet më të mirë”.*



**Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis  
SAI-t të Polonisë përfaqësuar nga Presidenti z. Jacek Jezierski dhe  
KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj  
23 maj, 2012, Varshavë, Poloni**

**VIII.6** Nga korrespondenca me Prof. Asoc. Dr. Rejai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, shkresat nr. 12-482, datë 4 dhjetor 2012 dhe nr.13-2, datë 3 janar 2013, përkatësisht :

*“Shqipëria po ben përparime te medha ne çdo fushe dhe bashkëpunimi shumepalësh dhe dypalësh eshte nje kontribues i mire. Prandaj dhe e vlerësoj shume bashkëpunimin frytdhenes mes institucioneve tona...*

*Ju jap falënderimet me te perzemerta per publikimin e prezantimit tim ne revisten shkencore te institucionit tuaj te nderuar. Do te ishte nje kenaqesi te kontribuojta per zhvillimin profesional te audituesve te KLSH dhe sigurisht ju mund te publikoni artikujt tane ne revisten tuaj” .*



**Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis  
Gjykatës së Llogarive të Turqisë përfaqësuar nga Presidenti Prof.as.Dr. Recai Akyel dhe  
KLSH-së përfaqësuar nga Kryetari Dr. Bujar Leskaj  
16 nëntor 2012 Ankara, Turqi**

**VIII.7** Nga fjala e z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës, në analizën vjetore 2012 të KLSH:

*“Duke vlerësuar atë që keni bërë, kjo nuk është vetëm një gjë është e rëndësishme për ju, por është gjithashtu diçka shumë e rëndësishme për bashkëpunimin tonë rajonal dhe bilateral. Ne po përpiqemi të bëjmë pikërisht të njëjtën gjë në institucionin tonë në Kosovë... Në bashkëpunimin tonë dypalësh, kjo është diçka që vlen gjithnjë e më shumë. Sot disa nga koleget tuaj janë në Kosovë tek ne dhe unë mendoj se është absolutisht e domosdoshme që ne të kalojmë nëpër gjithë përvojën tonë dhe ta diskutojmë këtë përvojë së bashku, të shohim se çfarë ka vlerë, të nxjerrim mësimet nga njëri-tjetri, duke mos përsëritur të njëjtat gabime që ne kemi bërë në Kosovë dhe anasjelltas”.*

**VIII.8** Nga fjala e z. Joop Vrolijk, Konsulent i Lartë i SIGMA, në analizën vjetore 2012 të KLSH:





z. Joop Vrolijk, duke diskutuar në analizën vjetore 2012 të KLSH, Janar 2013

*“U impresionova nga shumë gjetje dhe mendime që dëgjova nga të gjithë ju që u shprehët... Mendoj se keni shumë gjëra të rëndësishme për të thënë, se madje dhe nga kanalet e Brukselit, nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian këtu kam dëgjuar dhe kjo është shumë e rëndësishme, lidhur me disa deklarime tuajat në shtyp për dëmet e konstatuara nga ju, sidomos në strukturat e prokurimit publik. Ky nivel transparence që keni arritur është diçka shumë pozitive. Dua thjesht t’ju përgëzoj lidhur me arritjet tuaja dhe vëmendjen që keni tërhequr nga opinioni publik dhe gjithë veprimtarët e tjerë.*

*Gjatë vitit të kaluar, lansuat një program shumë ambicioz, ku ju kishit ndërmend që të thelloheshit dhe të punonit fuqimisht me auditimin e performancës dhe realisht keni filluar ta bëni këtë në fundvitin e kaluar, kur krijuat Departamentin e ri të Performancës. Eshtë e kuptueshme që ju ende nuk mund të flisni për rezultatet përfundimtare për auditimet e para të performancës, por besoj se jeni në rrugën e duhur. Nga ana tjetër, gjatë gjithë programit ambicioz të vitit të shkuar, menduat dhe për mënyrën se si mund të reformoheshit dhe të rritej efikasiteti i të gjithë veprimtarisë audituese. Dua të përmend këtu për një masë të marrë që në fillimet e vitit të kaluar, krijimin e departamentit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit. Mendoj se në të vërtetë kjo strukturë e re do mund të sjellë ndryshim në këtë institucion.*

*Si SIGMA e filluam këtu me gjëra shumë konkrete, patëm trajnime me të gjithë ju për auditimin e performancës, për auditimin financiar, për auditimin e pajtueshmërisë dhe auditimin e teknologjisë së informacionit. Nuk mund të them se të gjitha trajnimet shkuan për mrekulli dhe ishin shumë të suksesshme, por ndjeva përfshirjen tuaj, ndjeva interesin e gjallë dhe mund të them se kemi kaluar shumë mirë në këto trajnime. Gjithashtu, kam marrë njoftime që trajnime të tilla ka patur dhe me organizatat tuaja simotra me të cilat keni marrëveshje dhe mendoj me të vërtetë se është një impuls shumë pozitiv që të merrni njohuri lidhur me këto dhe të rrisni nivelin tuaj të profesionalizmit”.*



*Analiza e veprimtarisë të KLSH-së të vitit 2012,  
Janar 2013*

## **IX. PERSPEKTIVA 2013**

Objektivat e zhvillimit për vitin 2013, të përmbajtura në Planin Strategjik të Zhvillimit 2013-2017, të përgatitur nga KLSH në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA përgjatë vitit 2012, janë si më poshtë:

### *1. Sjellja dhe mbajtja e bazës ligjore dhe rregullore të KLSH në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira europiane.*

Sikurse përmendur më lart, institucioni ka dorëzuar zyrtarisht në Kuvend në fund të muajit Nëntor 2012 amendimet e ligjit të tij organik Nr. 8270 dt. 23.12.1997, i ndryshuar. Këto amendime, të çertifikuara nga DG-Budget si tërësisht në përputhje me parimet dhe standardet INTOSAI, priten të miratohen gjatë vitit 2013. Ato përcaktojnë përgjegjësi të reja në fushën e auditimit, saktësojnë të drejtat dhe detyrimet e institucionit në bazë të standardeve INTOSAI, si dhe organizimin dhe strukturën, statusin e personelit, procesin e çertifikimit të deklaratave financiare të subjekteve të audituara, çertifikimin e vetë audituesve të KLSH, etj. Implementimi i tij gjatë kërkon nxjerrjen e nje sere aktesh nenligjore qe kane te bejne me menaxhimin e procesit te auditimit dhe te institucionit ne teresi.

Në frymën e Deklaratës së Limës, të Deklaratës së Meksikos dhe të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara të 22 dhjetorit 2011, të cilat kërkojnë pavarësinë e plotë të Institucioneve Supreme të Auditimit kundër ndikimeve të jashtme, KLSH do të forcojë pavarësinë e tij institucionale dhe funksionale, si dhe pavarësinë e audituesve të tij. Institucioni do të angazhohet të krijojë një kuader të plotë rregullator që siguron pavarësinë në gjithë procesin e veprimtarisë, duke përfshirë

amendimet e ligjit, si dhe mekanizmat e brendshëm që sigurojnë pavarësinë e audituesve në planifikim, ekzaminim dhe raportim të auditimeve.

Lidershipi i KLSH do të intensifikoje aplikimin e një stili të hapur dhe profesional, sipas përafrimit “Tone at the Top” (theksi tek lidershipi) të zbatuar nga të gjitha SAI-t moderne evropiane, ndaj të gjitha niveleve të tjera të menaxhimit dhe ekzekutimit, duke e përcjellë këtë filozofi në krejt institucionin.

## *2. Përmirësimi i kapaciteteve, cilësisë dhe produktivitetit të auditimit*

KLSH do t’i përmirësoje me 2013 kapacitetet, cilësinë dhe produktivitetin e auditimeve në kushtet e një veprimtarie me burime të kufizuara dhe të angazhimit për t’ju përmbajtur standardeve profesionale ndërkombëtare INTOSAI dhe IFAC.

Institucioni do të përfitojë nga potenciali i auditimit të performancës, duke realizuar rritjen e kontributit dhe të profilit të tij në menaxhimin e fondeve publike. Ai do të përballë me sfidën e detyrimit të ri për të dhënë një opinion të auditimit mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar të Shtetit.

KLSH do të gjejë mundësitë për ruajtjen e burimeve të auditimit, duke aplikuar një qasje moderne, duke ju larguar përfundimisht auditimeve të tipit të inspektimit dhe vendosur një sistem të orientuar drejt auditimeve të pajtueshmërisë, të cilat kanë potencialin të ushtrojnë një ndikim me të madh. KLSH do të rrisë kapacitetet audituese duke zhvilluar edhe metodologji të veçanta, si ajo e auditimit bazuar në sistem, e auditimit të mashtrimit financiar dhe auditimit të integritetit, duke përcaktuar qartë rolin dhe përgjegjësitë e audituesve në këto proces, si dhe rregullimin e marrëdhënieve që lindin me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit gjatë auditimit të mashtrimeve financiare, etj.

Nisur nga dobësitë e vërtuara gjatë viteve të mëparshme, institucioni do të zhvillojë një metodologji të veçantë në lidhje me raportimin e auditimit, duke synuar strukturimin e raporteve bazuar në mesazhet që ato duhet të përcjellin dhe në audiencën. KLSH do të përmirësojë strukturën e raporteve të auditimit, duke futur formulimin e një përmbledhjeje ekzekutive, paraqitjen sa më selektive të gjetjeve, përdorimin e metodave dhe gjuhës grafike, si dhe formulimin e rekomandimeve. Do të përmirësohet ndjeshëm forma dhe struktura e raporteve për Kuvendin e Shqipërisë, duke synuar uljen e karakterit voluminoz të informacioneve dhe fokusimin në mesazhet. I njëjti përafrim do të zgjidhet për përgatitjen e Njoftimeve për Shtyp ose raporteve që kalojnë përmes mediave, duke i kushtuar rëndësi mesazheve sa më të lehta, të thjeshta dhe të drejtperdrejta për publikun. Në media institucioni do të jetë prezent edhe përmes artikujve të ndryshëm problematike, të përgatitur nga drejtuesit ose audituesit me përvojë, për të përcjellë sa më plotë dhe qartë në publik mesazhet dhe opinionet e KLSH.

### *3. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës*

Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës përbën një nga sfidat më madhore të KLSH për 2013-ën.

Departamenti i Auditimit të Performancës filloi veprimtarinë e tij më 01.10.2012 në përputhje me filozofinë e re drejtuese të KLSH-së, si përgjigje proaktive ndaj kërkesave të kohës për një kontribut më cilësor në përmirësimin e shërbimeve për taksapaguesit dhe performancës së institucioneve dhe organizmave publike. Departamenti është angazhuar seriozisht në përballimin e sfidave që ofron realiteti shqiptar, krijimin e vlerës së shtuar për taksapaguesit, asistimin e vendim-marrjes legislative dhe asaj ekzekutive, si edhe çuarjen përpara të këtij shërbimi të ri publik në Shqipëri.

Gjate vitit 2012, institucioni realizoi katër auditime të performancës, duke matur performancën e Agjensisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), të vjeljes së Akcizave, të sanksioneve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe të mirembajtjes së mjedisit në bashkinë Lezhe. Nder gjetjet e rëndësishme nga këto auditime përmendim evazionin e lartë fiskal nga prodhimi i pijeve alkoolike prej individëve, i cili mund të evitohet nga kontrolle të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në individët prodhues.

Ndër objektivat e Departamentit të Performancës, një pjesë e të cilave janë reflektuar dhe bërë pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit renditen: rritja e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës me synim arritjen e parametrave të SAI-ve homologe lider në rajon e më gjerë, shtimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për këtë lloj auditimi, përgatitja e manualit të performancës për KLSH-në dhe asistimi në formulimin e parametrave të performancës për sektorë të administratës publike, urbanizimi i konceptit të auditimit të performancës në krejt administratën publike, por edhe më tej në mjedis akademike, media, organizma profesionale, OJF e OJQ, etj., duke krijuar dhe zhvilluar kontakte me palët e interesuara, shtimi i vlerës së fondeve publike dhe rritja e përgjegjshmërisë në menaxhimin e këtyre fondeve, sinergjizimi i punës me grupe interesi, ekspertë, konsulentë dhe kërkues shkencorë, etj.

Në program për t'u realizuar në vitin 2013 janë 10 auditime, të ideuara nga vetë anëtarët e departamentit, 2 prej të cilave, të nisura në vitin 2012, janë aktualisht në fazën e përgatitjes së projekt-raportit, 3 janë në fazën e auditimit në terren, 1 është në proces studimor për mbledhjen e të dhënave dhe pjesa e mbetur do të realizohet në gjysmën e dytë të vitit. Kriteret e përzgjedhjes së fushave për auditim kanë qenë: impakti social, materialiteti, ndjeshmëria publike, mundësia audituese, shtimi i vlerës dhe legjislacioni i BE-së.

Fushat e përzgjedhura për 2013 janë:

**1.Ndarja administrative në RSH,** aktualisht në fazën e mbledhjes së informacionit. Ky auditim synon të masë performancën e ndarjes ekzistuese

administrative në drejtim të shërbimeve publike që ofrohen për taksapaguesit, numrit të popullsisë për çdo bashki e komunë, ekonomive të shkallës në grupimin e disa shërbimeve që ofrohen ndarazi nga njësi të ndryshme administrative, delegimit të kompetencave administrative për të qenë më pranë qytetarit, etj.

**2.Censusi 2011**, aktualisht në fazën e auditimit në terren. Programi i këtij auditimi synon t'iu japë përgjigjeve pyetjeve: *a u arritën objektivat e Censurit 2011, a u menaxhuan me efikasitet burimet njerëzore, financiare dhe logjistike gjatë realizimit të Censurit, si u hartua pyetësori i këtij Censuri, a ishte efektive fushata publicitare për ndërgjegjësimin e popullatës për regjistrim dhe a i kryen detyrat e tyre organet e ngarkuara për mbarëvajtjen e Censurit?*

**3.Trajtimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Fier**, aktualisht në fazën e auditimit në terren, ku çështjet që po trajtohen janë: *a ka rezultuar efektiv menaxhimi i mbetjeve urbane nga Bashkia e Fierit, a janë zbatuar masat e kërkuara nga ministria për vënien në jetë të strategjisë kombëtare dhe mënyra e ndjekjes së tyre, si edhe a ka projekte në të ardhmen për menaxhimin e mbetjeve urbane në qytetin Fierit për zbatimin e strategjisë kombëtare në nivel lokal? Ky auditim ka orientim mjedisor dhe po realizohet në bashkëpunim me ekspertë për çështje mjedisore.*

**4.Performanca e shërbimit hekurudhor**, aktualisht në fazën e projekt-raportit ku janë bërë një sërë gjetjesh, konstatimesh dhe rekomandimesh, ndër të cilat përmendim:

- Hekurudha Shqiptare duhet të ristrukturohet për të rritur efikasitetin duke u mbështetur në legjislacionin e ri evropian. Hekurudha Shqiptare duhet të mbajë përgjegjësi për të mirëmbajtur infrastrukturën dhe për të realizuar shërbimet e udhëtarëve, për të organizuar lëvizjen e trenave në tërësi.
- Hekurudha Shqiptare SHA të ndahet organizativisht dhe financiarisht në katër ndërmarrje të veçanta, ashtu sikurse të gjitha hekurudhat evropiane;
- Tregu i brendshëm hekurudhor të jetë i hapur dhe në të operojnë ndërmarrje transportuese kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Subvencioni shtetëror për detyrimin e shërbimit publik që përcakton shërbimet e transportit të udhëtarëve duhet të caktohet në bazë të një kontrate shumë-vjeçare. Kjo kontratë duhet të nënshkruhet midis ministrive të transportit me shoqërinë e udhëtarëve/shoqërinë kryesore, duke përcaktuar llojin e shërbimeve që duhet të ofrohen, vëllimin (numrin e trenave, përbërjen e trenave) dhe treguesit e përzgjedhur të cilësisë. Kontrata e shërbimit publik duhet të përcaktojë treguesin tren-km të blerë në të gjitha rrugët. Kontrata e shërbimit publik duhet të evitojë kompensimin e tepërt. Shërbimet fitimprurëse të mallrave nuk duhet të përfitojnë nga financat shtetërore.

**5.Shërbimi ujësjellës-kanalizime në Pogradec**, aktualisht në fazën e përgatitjes së projekt-raportit. Ky auditim fokusoi çështje si: *a është bërë një menaxhim i mirë i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas nivelit të planifikuar në UK SHA. Pogradec, a e ka kryer UK SHA. Pogradec, koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit mbi prodhimin, shpërndarjen dhe trajtimin e ujit të pijshëm për*

*përfitim publik në territorin e tij administrativ, a e ka kryer sipas procedurave të përcaktuara UK SH.A. Pogradec, aktivitetin mbi trajtimin dhe derdhjen e ujërave të ndotura, me qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekosistemit natyror?*

**6.Shërbimi ushqimor spitalor**, aktualisht në fazën e auditimit në terren. Ky auditim po trajton problemet si: *a siguron sistemi aktual spitalor shërbimin ushqimor për t'iu shërbyer pacientëve me kosto sa më të ulët, pa cënuar cilësinë, në përputhje me standartet ndërkombëtare, a ka siguruar procesi i implementimit të privatizimit të QSUT përfitimin e pritshëm dhe cilat janë problemet dhe përfitimet e formës së zgjedhur të organizimit të shërbimit nga spitalet e tjera?*

1. Në plan për 6-mujorin e dytë të 2013 janë auditimet: Pajisjet spitalore, Kurrikulat universitare dhe avancimi në karrierë, Ruajtja e trashëgimisë kulturore, Përkujdesja për fëmijët në nevojë, Plani për stadiumin e ri.

Gjatë kësaj periudhe, u përgatit nga drejtuesi i këtij departamenti, manuali udhëzues i auditimit të performancës sipas standarteve INTOSAI 3000-3100. Ky manual synon t'u vijë në ndihmë të gjithë audituesve publikë, por veçanërisht atyre që synojnë të masin performancë në institucionet supreme të auditimit.

Më qëllim rritjen e cilësisë së auditimit në këtë drejtim dhe pasurimin e kapaciteteve profesionale, pjesëtarët e departamentit, që nga momenti i krijimit të tij, janë trajnuar vazhdimisht në vende me eksperiencë të pasur dhe lider në rajon e më gjerë, si Hollandë, Poloni, Slloveni, Turqi, etj.

Sfidat janë të mëdha, veçanërisht për një vend si Shqipëria, ku aktiviteti ekonomik qeveritar prodhon një pjesë të konsiderueshme të PBB-së dhe punëson një numër të madh të fuqisë punëtore, por mbështetja e drejtuesit, përkushtimi i stafit dhe asistenca e huaj janë faktorë vendimtarë për sukses.

➤ *Forcimi i rolit antikorrupsion te KLSH-se per sigurimin e mireqeverisjes*

Për shkak të pasojave të rënda që sjell korrupsioni në deformimin e tregut dhe të konkurrencës, si dhe në frenimin e investimeve të huaja, lufta kundër tij kërkon kontributin e të gjitha institucioneve. Ka një hendek në mes të pritjeve të palëve të interesuara në vend dhe mandatit të auditimit për KLSH. Tradicionalisht, institucionet supreme të auditimit kanë rënë dakord që përgjegjësia primare për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit qëndron te autoritetet administrative, të tilla si policia apo agjencitë antikorrupsion. SAI-t nuk e kanë parë mashtrimin dhe korrupsionin si qëllimin e tyre kryesor. Qasja ka qenë më tepër për të parandaluar korrupsionin, se sa në zbulimin e aktiviteteve të paligjshme. Nga ana tjetër publiku beson me shume në rolin antikorrupsion te KLSH-se. Institucioni do të vazhdojë ta respektojë këtë shtet dhe krahas veprimtarisë audituese dhe modernizimit të tij, do të vazhdojë të thellojë luftën kundër korrupsionit, duke denoncuar aktet korruptive në publik, media, Prokurori e me gjere.

KLSH gjykon se forcimi i kapaciteteve të auditimit është një strategji efektive për të mbështetur përmirësimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe

ndershmërisë në qeverisje. Raportimi i mirë financiar dhe auditimi ndihmojnë në reduktimin e veprimeve mashtruese.

Gjate vitit 2013, KLSH gjithashtu do të ndikojë dhe nxisë politikën qeveritare anti-korrupsion. Ekspozimi ndaj mashtrimit dhe korrupsionit mund të zbutet nëse qeveria ka ngritur politikë efektive antikorrupsion. Strategjia Ndersektoriale e Parandalimit, Luftes kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha ka nevojë për një përgjegjësi të shtuar të të gjitha strukturave qeveritare që ajo koordinon dhe KLSH do të realizojë sinergjizimin e politikave të tij audituese, me këtë strategji për të kontribuar në mirëqeverisjen e financave publike dhe në veçanti me goditjen e antikulturës së pandëshkueshmërisë të zyrtarëve që abuzojnë me detyrën.

➤ *Zhvillimi i komunikimit dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë brenda e jashtë vendit*

Gjate vitit 2013, KLSH do të shtojë gradualisht praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median vizive dhe të shkruar të vendit, si dhe do të mundësojë editoriale në mediat kryesore të shkruara për problematiken e auditimit publik në vend. Institucioni do të rrisë bashkëpunimin dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e vërtetimit dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike. KLSH do të realizojë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe median, publikime si fletëpalosje, buletine, broshura dhe libra për rritjen e luftës kundër korrupsionit dhe të transparencës së administrimit publik. Në veçanti, qasja e botimeve të realizuara gjatë vitit 2012 do të vijojë dhe do të thellohet me tej. Po ashtu, institucioni do të realizojë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe median tryeza pune, dëgjime publike, konferenca dhe simpoziume për rritjen e transparencës dhe shkallës së përgjegjshmërisë së administratës publike në menaxhimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Gjatë vitit 2013, KLSH parashikon të realizojë marrëveshje të reja bashkëpunimi me SAI-t moderne të Austrisë, Norvegjisë, Britanisë së Madhe dhe me SAI të rajonit, si të Malit të Zi, Maqedonisë, Greqisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, duke synuar krijimin e një rrjeti efikas bashkëpunimi në rajon.

Në vitin 2012 kemi hedhur piketat e para për një auditim të përbashkët mjedisor të bregdetit Adriatik me SAI-t e Sllovenisë, Kroacisë dhe Malit të Zi.

Në tetor 2013 KLSH organizon Konferencën e Dytë shkencore të tij, e cila do të përqendrohet në rritjen e cilësisë së shërbimit të auditimit publik, si dhe do të vazhdojë botimin çdo katër muaj të revistës profesionale të fushës “Auditimi Publik”.

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**





## **Kombet e Bashkuara**

### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Rezoluta A/66/209**

Promovimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, duke forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit.

Asambleja e Përgjithshme,

Në mbështetje të rezolutës të Këshillit Social dhe Ekonomik 2011/2, datë 26 Prill 2011,

Gjithashtu, në mbështetje të rezolutave 59/55 të datës 2 Dhjetor 2004 dhe 60/34 të datës 30 Nëntor 2005, si dhe rezolutat e mëparshme mbi administrimin dhe zhvillimin publik,

Në mbështetje të Deklaratës së Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>

Duke nënvijëzuar nevojën për përmirësimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik

Duke nënvijëzuar gjithashtu faktin se një administrim publik eficient, i përgjegjshëm, efektiv dhe transparent, ka një rol kryesor në zbatimin e qëllimeve të zhvillimit të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe objektivat e zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Duke theksuar nevojën për krijimin e kapaciteteve si një mjet për të promovuar zhvillimin dhe mirëpritjen e bashkëpunimeve ndërmjet INTOSAI-t dhe Kombeve të Bashkuara, në lidhje me këtë,

1. Njeh faktin se Institucionet Supreme të Auditimit, mund të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë eficiente dhe efektive, vetëm nëse ata janë të pavarur nga njësitë e audituara dhe janë të mbrojtur nga ndikimet e jashtme.
2. Gjithashtu njeh, rolin e rëndësishëm të këtyre institucioneve, në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, i cili i vjen në ndihmë edhe arritjes së objektivave dhe prioritetëve për

---

<sup>1</sup> Shiko rezolutën 52/2



zhvillim kombëtar, si dhe arritjes së qëllimeve të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe qëllimet e zhvillimit të Mijëvjeçarit.

3. Vlerëson punën e INTOSAI-t në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës, si dhe përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të burimeve publike, në të mirë të qytetarëve.
4. Gjithashtu, vlerëson Deklaratën e Limës, Udhëzuesit mbi rregullat e Auditimit të vitit 1977<sup>2</sup> dhe Deklaratën e Meksikos mbi pavarësinë e SAI-ve, në vitin 2007<sup>3</sup> dhe inkurajon shtetet anëtare, të aplikojnë këto deklarata, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare.
5. Inkurajon shtetet anëtare dhe institucionet e ngjashme në OKB, të vazhdojnë dhe të intensifikojnë marrëdhëniet e tyre, duke përfshirë edhe krijimin e kapaciteteve, me INTOSAI-n, për të promovuar mirë-qeverisjen eficientë, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën, duke forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit.

## **Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara aprovon Rezolutën A/66/209 mbi Pavarësinë e Institucioneve më të Larta të Auditimit**

Në 22 Dhjetor 2011 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nr. 66 aprovon rezolutën *“Duke nxitur efikasitetin, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike nëpërmjet forcimit të Institucioneve më të Larta të Auditimit”*.

Rezoluta e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara është kurorëzimi i përpjekjeve të përbashkëta të të gjitha institucioneve më të larta të auditimit për të forcuar pavarësinë e tyre dhe për njohjen e Deklaratave të Limës dhe Meksikës. Ky sukses u bë i mundur vetëm sepse të gjithë anëtarët e komunitetit të INTOSAI-t krijuan kushtet e nevojshme në fushat e tyre të kompetencës dhe dhanë në këtë mënyrë përmbajtje dhe besueshmëri motos së INTOSAI-t *“Experientia Mutua Omnibus Prodest”*.

Rezoluta e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara paraqet një moment historik në historinë gati 60-vjeçare të INTOSAI-t. Aty, Asambleja e Përgjithshme për herë të parë shprehimisht pranon se:

- SAI-t mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjekti i audituar dhe janë të mbrojtura nga ndikimet e jashtme; gjithashtu pranon;
- Rolin e rëndësishëm të SAI-ve në promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, e cila është e favorshme për arritjen e objektivave dhe prioritetëve të zhvillimit kombëtar, si dhe qëllimet e

---

<sup>2</sup> Deklarata e Limës, Udhëzime mbi Rregullat e Auditimit, miratuar në Kongresin e 9-të të INTOSAI-t, 17 – 26 Tetor 1977.

<sup>3</sup> Deklarata e Meksikos mbi INTOSAI-n, miratuar në Kongresin e 19-të të INTOSAI-t 5 – 10 Nëntor 2007

zhvillimit të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Shtetet anëtare të OKB-së vënë re me vlerësim:

- Punën e INTOSAI-t në promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit, transparencës dhe në marrjen dhe përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike për të mirën e qytetarëve;
- Deklaratat e Limës dhe Meksikës.

Asambleja e Përgjithshme e OKB inkurajon shtetet anëtarë të:

- Zbatojnë në përputhje me strukturat e tyre institucionale kombëtare, parimet e parashtruara në ato Deklaratave, dhe gjithashtu inkurajon;
- Shtetet Anëtare dhe institucionet relevante të Kombeve të Bashkuara që të vazhdojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre me INTOSAI-n, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve me qëllim nxitjen e qeverisjes së mirë, duke siguruar përgjegjshmëri, efikasitet, efektivitet dhe transparencë nëpërmjet institucioneve më të larta të auditimit të përforcuara.

Të gjitha SAI-t tani kanë në dispozicion të tyre një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, e cila u lejon atyre të kërkojnë me shumë këmbëngulje zbatimin e parimeve themelore të pavarësisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e ndërtimit të kapaciteteve nga ana e SAI-t duke qenë se pavarësia e tyre institucionale. në veçanti nga agjencitë e audituara, është njohur për herë të parë nga të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.

Inkurajimi nga Asambleja e Përgjithshme për të gjithë shtetet anëtarë të OKB-së për të zbatuar parimet e përcaktuara në Deklaratën e Limës dhe Meksikës do të rrisë vendosmërinë e të gjitha SAI-ve dhe veçanërisht atyre që janë ende duke luftuar për të arritur elementet themelore të pavarësisë së tyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



MIRATOHET

KRYETARE

Jozefina TOPALLI (ÇOBA)



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË  
TË SHTETIT PËR VITIN 2011

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Nisur nga misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për ushtrimin e kontrollit në subjektet dhe programet publike, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë informacion mbi përdorimin e fondeve buxhetore;

Duke njohur vizionin e këtij institucioni për përdorimin e burimeve me efektivitet, në drejtim të ushtrimit të kontrollit të pavarur, objektiv, të sigurt e të besueshëm;

Mbështetur në detyrimet kushtetuese e ligjore, si dhe në objektivat afatmesëm e ata vjetorë të institucionit;

**Konstaton se gjatë vitit 2011 Kontrolli i Lartë i Shtetit:**

- Ka realizuar detyrat sasiore e cilësore të planifikuara në drejtim të veprimtarinë kontrolluese.

- Është përpjekur të zbatojë dhe të zhvillojë një metodologji bashkëkohore në kontroll, duke përgatitur, përmirësuar dhe përditësuar udhëzimet dhe metodikat përkatëse.

- Në auditimet financiare, u është dhënë përparësi sektorëve të ekonomisë apo subjekteve që janë vlerësuar me materialitet dhe risk të lartë. Auditimi i performancës duhet të zërë një vend më të gjerë në kontrollet dhe vlerësimet që bën institucioni.

- Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve.

- Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore.
- Ka përmirësuar veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe ka rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore.
- Është i nevojshëm përshpejtimi më tej i ritmeve të kualifikimit të punonjësve dhe aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kuvendi vlerëson masat që po merr institucioni në lidhje me këtë çështje.
- Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike. Raporte më efektive duhet të krijohen me institucionet e hetimit.
- Ka përdorur fondet buxhetore në përputhje me kuotat e planifikuara sipas zërave të buxhetit.

**Kuvendi kërkon që, për vitin 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit të intensifikojë punën në këto drejtime:**

- Kryerjen e kontrolleve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë.
- Rritjen e efikasitetit të veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë drejt auditimit të performancës.
- Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikatat më të mira të vendeve të tjera.
- Harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese.
- Zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivelet bashkëkohore, si dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë.
